



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 5, 11, 13 MAJ DHE 6, 14 QERSHOR 2022**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 5. 11. I 13. MAJA I 6. I 14. JUNA 2022. GODINE**

**MAJ/QERSHOR - MAJ/JUN  
2022**

## **Rendi i ditës**

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Propozimi i dy (2) kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022,
7. Emërimi i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,
8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar,
9. Debat parlamentar për punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës në vitin e parë të mandatit të saj.

## **Dnevni red**

1. Deklarisnja van dnevnog reda,
2. Parlamentarna pitanja,
3. Predlaganje dva (2) kandidata za sudije u Ustavnom sudu,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-056 o zaštiti konkurencije,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-142 o izmenama i dopunama zakona kojima se utvrđuje visina beneficije u visini minimalne plate, procedure utvrđivanja minimalne zarade i poreske stope na godišnji lični prihod,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-143 o izmenama i dopunama Zakona br. 08/L-066 o budžetskim izdvajanjima za Budžet Republike Kosova za 2022. god.
7. Imenovanje Komisije za zaštitu konkurencije,
8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, iz albanske zajednice,
9. Parlamentarna rasprava o radu Vlade Republike Kosova u prvoj godini njenog mandata.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Po e fillojmë këtë seancë. Para se të fillojmë me rendin e ditës, kjo seancë po rastis me Ditën e Dëshmorëve të rënë për lirinë e kombit shqiptar, kështu që propozoj që së bashku si deputetë dhe si Kuvend i Kosovës t'i nderojmë të rënë për liri me një minutë heshtje.

*(Një minutë heshtje)*

Lavdi!

Të nderuar deputetë,

Kjo seancë është përgatitur në mbledhjen e Kryesisë, e cila është mbajtur më 29 prill, pra sipas këtij rendit të ditës, me të cilën jemi pajtuar, edhe do të procedojmë sot.

Po para kësaj e ka kërkuar fjalën kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Abelard Tahiri.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Tash e dy muaj si parti opozitare me kërkesën e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike jemi duke u munduar të themelojmë një Komision Hetimor, i cili do të hetonte të gjitha transaksionet, ngritjen e çmimit të energjisë elektrike dhe shpenzimin e mbi 125 milionë eurove gjatë këtyre tre muajve. Pra, kjo është një e drejtë e jona kushtetuese, kjo është një e drejtë e jona, e cila na garanton edhe hetim parlamentar. Hetimi parlamentar realisht është instrumenti i vetëm i opozitës, i cili ushtron kontroll ndaj mazhorancës dhe ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, sot, si iniciues i themelimit të Komisionit Hetimor Parlamentar për hetimin e krizës energjetike, ne kërkojmë edhe mbështetjen e grupeve të tjera parlamentare që të mos vazhdohet kjo seancë, edhe ashtu është ftuar pa dakordimin e opozitës, ta themelojmë Komisionin Hetimor, sepse përndryshe nuk ka kurrfarë kuptimi të vazhdohet në një normalitet parlamentar kur mohohet një e drejtë fundamentale e opozitës për ta ushtruar funksionin e saj si opozitë.

Pra, asnjëherë, e kemi ritheksuar me qindra herë, nuk ka ndodhur që mazhoranca ta bllokojë themelimin e një komisioni të tillë hetimor. Nuk ka ndodhur asnjëherë që mazhoranca të kërkojë ta korrigjojë kërkesën e opozitës për Komision Hetimor Parlamentar.

Prandaj, ne sot jemi të vendosur që ta realizojmë një të drejtë tonën kushtetuese, konstatimin e themelimit të këtij komisioni, pastaj do të vazhdojmë me një normalitet parlamentar. Ndryshe,

prezenca jonë në këtë seancë pa themelimin dhe pa realizimin e kësaj të drejte fundamentale për opozitën nuk ka kurrfarë kuptimi.

Prandaj, ne sot po kërkojmë që kjo seancë të mos vazhdojë, ta gjejnë një zgjidhje, ta themelojmë Komisionin Hetimor dhe pastaj do të vazhdojmë me pika të tjera të rendit të ditës. Edhe ashtu, siç thashë kjo seancë është ftuar pa dakordimin e opozitës, mendoj që është dashur edhe atë ditë që të pritet opozita, sidomos edhe për çështje të tjera që janë të rëndësishme si pjesë e rendit të ditës, siç janë edhe votimi për anëtarë të Gjykatës Kushtetues.

Nëse keni vullnetin të kalojmë këtë pikë dhe të mos dështojë qysh dështoi tri herë radhazi, mendoj që duhen ftuar grupet parlamentare për konsultim paraprakisht e pastaj të hyhet në rend të dite, nëse jeni të interesuar të dështojë, atëherë kjo edhe mund të hyjë e të dështojë qysh ka dështuar tri herë të tjera.

Mirëpo, sot nuk mund të ketë normalitet parlamentar, nuk mund të ketë kushte të vazhdojë seanca pa u themeluar Komisioni Hetimor, për çështje të cilat i kemi ngritur dhe shqetësimet që i kemi ngritur ne si parti opozitare.

Unë besoj që këtu duhet të deklarohen edhe shefat e grupeve dhe do të vazhdojmë pastaj më tutje me agjendën tonë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Mirë, ia japim fjalën kryetares së Grupit të Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila.

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Faleminderit, kryetar!

Në raport me atë çka tha shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, pajtohem plotësisht. Pajtohem që duhet të formohet Komisioni Hetimor Parlamentar, pajtohem që është instrumenti kryesor i opozitës për mbikëqyrje të pozitës, gjegjësisht Qeverisë dhe një instrument i mirëfilltë i demokracisë. Gjithashtu pajtohem që duhet t'i kthehet normaliteti seancave të Kuvendit, duke përfshirë këtu sjelljet, etikën dhe komunikimin e mirëfilltë parlamentar.

Çka nuk pajtohem është që, për të siguruar ose për të krijuar këtë komision në mënyrën se si herën e dytë e ka proceduar opozita, ne duhet të shkelim mbi dispozitat aktuale të Ligjit për hetim parlamentar që parashihen saktë kriteret, format e mënyrat e formimit të grupit dhe udhëheqjes me grupin.

Edhe një herë po e ritheksoj e po bëj thirrje, njëjtë sikurse edhe herën e kaluar, që të ulemi bashkë me ju, kryetar, shefat e grupeve parlamentare, të gjendet modaliteti i cili jep kah, drejtim kësaj çështjeje tepër të rëndësishme për funksionimin parlamentar. Po të mos përdoret bllokada e opozitës e të krijohet bindja që dikush këtu po do të fshehë diçka. Ne jemi 100% në shërbim të transparencës, të llogaridhënies, e natyrisht edhe të funksionimit të mirëfilltë të Kuvendit.

Tash, sa i përket seancës së sotme, unë besoj që sikur kjo seancë të ishte ftuar jashtëligjshëm ose jashtë rregullave të Kuvendit, ju edhe nuk do të ishit këtu, për arsye se e konsiderojnë se është bërë një shkelje. Kjo seancë është ftuar me mbledhje të rregullt të Kryesisë, me ftesa dhe material që janë dërguar me kohë dhe natyrisht me deklarime të përfaqësuesve jozyrtarë, jopolitikë, po të grupeve tuaja, zyrtarëve që kanë ardhur ta përcjellin mbledhjen e Kryesisë, se për shkak të angazhimeve të tjera anëtarët e Kryesisë së Kuvendit nuk kanë qenë prezentë. Kryesia ka pasur kuorum, Kryesia ka marrë vendime dhe ka miratuar një agjendë. Në funksion dhe në frymë të bashkëpunimit parlamentar dhe funksionimit të Kuvendit, ne si propozues, si grup parlamentar i pozitës, propozues i një komisioni të zgjeruar të hetimit e kemi shtyrë trajtimin e pikës tonë, në mënyrë që të kemi dakordim me opozitën.

Ne kemi mundur ta procedojmë sot që ajo të jetë pikë e rendit të ditës, i ka pasur 41 nënshkrime, po edhe publikisht e kam thënë, edhe në mbledhje të Kryesisë që pa e pasur një koordinim me opozitën, në raport me funksionimin e komisionit, këtë pikë po e shtymë kur të jeni edhe ju në mbledhje të Kryesisë dhe natyrisht që jemi kundër themelimit të dy komisioneve hetimore parlamentare, për arsye se dy komisione hetimore parlamentare për të njëjtën çështje, me angazhim të deputetëve 11 në njërin e 11 në tjetrin, me kërkesa e ftesa të anëtarëve të institucioneve, udhëheqësve për intervistim në njërin dhe në tjetrin, e bëjmë një lëmsh të madh në raport të funksionimit dhe dalim komplet qesharakë.

Po tash ne në rrethana të cilat jemi aktualisht, këtu duhet bërë një lëvizje nga pozicioni, ju po e keni ose mënyrën time ose fare nuk bëhet. Tash ju kur keni mbledhur 40 nënshkrime është dashur të mendoni pak më seriozisht dhe në përmbajtje të asaj çka parasheh ligji. Tash, ligjin s'e kemi bërë ne, ligji është ky që është. Ndryshimet konform kërkesave për komisione hetimore parlamentare kanë ndodhur në disa legjislatura, kur janë ballafaquar me të njëjtën pengesë.

Tash, nëse ju refuzoni të reflektoni ose të shikoni dhe të shihni, të dalim në zgjidhjen që e mundëson ta udhëheqë Komisionin Hetimor Parlamentar një parti opozitare, atëherë seriozisht nuk dimë çka tjetër mund të bëjmë. Ne po ofrojmë gatishmërinë maksimale për ta mundësuar themelimin e këtij komisioni, por në rrethana ku dorëzohen 40 nënshkrime të të gjitha grupeve parlamentare të opozitës, pamundësohet kryesimi i këtij komisioni dhe funksionimi i mirëfilltë i tij. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka Lidhja Demokratike, kryetari i grupit, Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit, kryetar!

Sa i përket Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, situata është delikate dhe mendoj se mënyra e sjelljes e pushtetit po e paaftëson vendimmarrjen në Kuvend.

Paaftësimi i mundësisë së vendimmarrjes në Kuvend është vështirësim i nivelit të demokracisë në vend dhe kur ke parasysh që ky paaftësim i vendimmarrjes në Kuvend po vjen si rezultat i vullnetit të jashtëzakonshëm të pushtetit që të pamundësojë mbikëqyrjen parlamentare të institucioneve shtetërore, atëherë situata bëhet edhe më e rëndë.

Pra, duke marrë parasysh rrethanat të cilën gjendemi, si rezultat i pamundësisë së formimit të Komisionit Hetimor Parlamentar për çështjen e menaxhimit të krizës energjetike në Kosovë dhe shtrenjtimin e çmimit të energjisë elektrike, ne mendojmë se Kuvendi duhet patjetër të themelojë Komision Hetimor Parlamentar të kërkuar nga 40 deputetë nënshkrues dhe nuk ka kurrfarë logjike institucionale e politike dhe as pragmatike që Kuvendi të aktrojë sikur është në normalitet, në kohën kur vendit po i cenohet demokracia.

Pra, ne mendojmë se Kuvendi nuk duhet të marrë asnjë vendim tjetër përpara se të themelohet Komisioni Hetimor Parlamentar. Pra, kërkojmë që të vazhdojë seanca ku kemi mbetur me themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar dhe pastaj të hymë në një fazë tjetër të mirëbesimit reciprok dhe të tendencës së kthimit të normalitetit, vendimmarrjes normale në Kuvend. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka Grupi Parlamentar i AAK-së, në emër të grupit, Ramush Haradinaj.

**RAMUSH HARADINAJ:** I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë,

Aleanca po ashtu mbështet kërkesën e opozitës për Komisionin Hetimor, jemi, po e quaj të mërzhitur me faktin se pozita e kundërshton Komisionin Hetimor me Komision Hetimor, diçka që s'ka ndodhur deri më sot dhe nuk e shohim të arsyeshme një sjellje të tillë të pushtetit, pra të Qeverisë. Njëkohësisht vazhdimi me tema të rendit të ditës sikurse që është sot, do të merrte kuptim me përmbylljen e një çështje të mbetur të hapur, në këtë rast të Komisionit Hetimor Parlamentar për shpenzime në energji.

Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deklaroj se do të marrim pjesë në pikën tre, votimi për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese sot.

**KRYETARI:** I dëgjuam këto qëndrimet e grupeve, por desha ta bëj vetëm një sqarim.

Kjo seancë është thirrur krejtësisht në mënyrë të rregullt, por është qëndrim tjetër pastaj pozicionimi i opozitës dhe i grupeve parlamentare opozitare sa i përket mbajtjes së kësaj seance.

Unë mendoj që ajo pika për të cilën ju e keni ngritur mocionin dhe e cila nuk pati kaluar herën e parë, por herën e dytë, u bë pjesë e seancës së kaluar parlamentare, e patëm procesin e votimit

dhe ajo mbeti për t'u shqyrtuar në një seancë tjetër, kurdo që të pajtohemi që të caktojmë për të vazhduar.

Nuk e di arsyen pse të gjitha grupet opozitare nuk morën pjesë në mbledhjen e kaluar të Kryesisë, por ne nuk vendosëm për vazhdim të seancës, po vendosëm për seancë të re pikërisht pse ju nuk ishit aty, domethënë kjo ka qenë arsyeja kryesore.

Po të kishit qenë ju aty për t'i mbrojtur qëndrimet tuaja në mbledhje të Kryesisë, natyrisht që do ta hidhnim në diskutim nëse jeni për të caktuar seancë të re apo nëse jeni për të vazhduar aty ku mbetëm.

Kështu që ne e caktuam seancën e re, asnjë shkelje ligjore nuk ka në caktimin e kësaj seance të re. Është tjetër pastaj se si pozicionoheni ju si opozitë, a do të merrni pjesë apo nuk do të merrni pjesë në këtë seancë.

Mirëpo, tash sa i përket kësaj, ne i kemi dy mundësi: të vazhdojmë me këtë seancë apo që të ndërpritet kjo seancë. Mua po më duket e paarsyeshme që të ndërpritet kjo seancë. Është caktuar, deputetët janë këtu. Kjo seancë unë konsideroj që mund të dështojë vetëm nëse nuk ka kuorum, se përndryshe nëse ju jeni këtu, deputetët janë këtu, e kemi kuorumin e nevojshëm, mund të vazhdojë ajo.

Tash, në anën tjetër, po ashtu është shumë problematike nëse tentojmë të bëjmë mocion dhe ta kapim vetëm një pikë të rendit të ditës të seancës së kaluar e ta bartim në këtë seancë ku jemi tash. Konsideroj që ligjërisht është e pamundshme edhe s'kemi pasur kurrë në Kuvendin e Kosovës një praktikë të tillë, që ta marrim prej seancës së kaluar, ta keni parasysh, pika për Komisionin Hetimor Parlamentar nuk është rrëzuar prej mazhorancës. Unë ju tregova atë ditë, i patëm vetëm 3 abstenime, nuk është votuar fare, domethënë ka mbetur pa kuorum.

Megjithatë unë insistoј që Komisioni Hetimor Parlamentar nuk mund të kalojë pa vendim të seancës. Nuk mund të themi vetëm po ia fillojmë punës, Komisioni Hetimor Parlamentar është shumë përtej Rregullores dhe përtej Ligjit për hetim parlamentar.

Prandaj, nuk është e rastit pse tetë komisione deri tash hetimore ishin krijuar në Kuvend të Kosovës dhe të tetat janë krijuar me vendim të seancës, nuk është pahiri kjo punë, nuk është gabim, ka qenë mirë. Gjithmonë është themeluar me vendim të seancës. Urdhëro!

*(Reagime nga salla)*

Jo, jo unë po e them deri në fund, e kam thënë edhe atë ditë në seancë. Unë e kam thënë qëndrimin tim sa i përket formulimit tuaj të çështjes, po kjo nuk e prek atë argumentin, të cilin po e zhvilloj, që prapë duhet vendim i seancës.

Vazhdojmë me deklaratimet jashtë rendit të ditës tash. Ose po jua jap edhe një herë fjalën shëfave të grupeve si mendoj të procedojnë.

Kryetari i Grupit të PDK-së.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Kryetar, me këtë seancë ne kërkojmë që të mos procedohet më tutje, të takohemi si Kryesi, ta caktojmë, të dakordohemi për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, fakti që të gjitha komisionet parlamentare në të kaluarën janë votuar në këtë seancë është për fatin që asnjëherë pushteti, edhe pse i ka pasur numrat, ta bllokojë në mënyrën qysh po e bllokoni ju, nuk e ka bllokuar, gjithmonë ka pasur vullnet nga mazhoranca për të pranuar një kërkesë nga opozita, ashtu siç ka ardhur, jo të korrektohet, siç po pretendoni ju.

Prandaj, sot vazhdimi i një seance të re kinse s'ka ndodhur asgjë, duke na e mohuar një të drejtë tonë kushtetuese, duke minuar demokracinë pikërisht në Kuvendin e Kosovës, është një dëm jashtëzakonisht i madh, është një traditë shumë e rëndë, një goditje shumë e rëndë që i bëhet demokracisë në këtë vend.

Prandaj, ne nuk e kontestojmë në asnjë rrethanë thirrjen e kësaj seance, tash do të duhej të kishte vullnet politik dhe do të duhej konsultuar opozitën paraprakisht për rendin e ditës, të cilin e keni ftuar, në rregull, në mënyrë ligjore e keni bërë një gjë të tillë, nuk e kontestojmë. Mirëpo, ne kërkojmë të realizojmë një të drejtë tonë kushtetuese si opozitë, instrumentin tonë të vetëm parlamentar për hetim dhe kontroll ndaj pushtetit.

Kjo është çështja që ne po duam ta realizojmë, nuk ka kurrfarë kuptimi seanca e re, duke lënë në heshtje, që dy muaj jemi duke u përpjekur ta themelojmë këtë Komision Hetimor. Pra, asnjëherë në të kaluarën nuk ka ndodhur që të marrë dy muaj kohë themelimi i një Komisioni të tillë Hetimor, ka qenë çështje një jave, çështje dy jave, është proceduar kërkesa, ka ardhur në Kuvend, është miratuar nga mazhoranca dhe asnjëherë nuk është bërë temë.

Prandaj, tash që dy muaj po flasim për çështje të tillë dhe në fund kur arritëm në fund, jemi bllokuar pikërisht me mosvullnetin tuaj.

Kushtetuta është shumë e qartë, neni 77 është shumë i qartë: 1/3 e deputetëve janë kategori kushtetuese dhe e caktojnë komisionin, nuk e propozojnë, e caktojnë. Prandaj, këtu do të duhej të veprojmë, ne i dërgojmë emrat si grupe parlamentare te ju si kryetar i Kuvendit dhe ju e nënshkruani vendimin konform kërkesës së grupeve parlamentare opozitare, kjo është çështja të



cilën ne e kërkojmë. Po të ishte me gjashtë nënshkrime, normalisht që duhet votuar në Kuvend dhe ne e kemi promovuar edhe atë çështje, s'ka vazhduar, na e keni rrëzuar komisionin me votë dhe e kemi caktuar me 40 nënshkrime, ashtu siç e kërkon Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligji në fuqi.

Pra, nuk ka kurrfarë kuptimi të vazhdojë seancë e re parlamentare pa e përmbyllur këtë çështje. I kemi theksuar për tetë a nëntë orë debat abuzime të cilat ne pretendojmë që kanë ndodhur, i kemi dhënë argumentet tona të bazuara edhe në numra, në shifra, jo me argumente politike, me shifra, pse duhet të themelohet ky Komision Hetimor Parlamentar.

Prandaj, po ju lus që të gjeni kurajon, vullnetin politik, mos vazhdoni më tutje me këtë seancë, ta themelojmë Komisionin Hetimor Parlamentar dhe pastaj vazhdojmë krejt normalisht me pikat e reja të rendit të ditës.

Prandaj, kjo është një çështje fundamentale për demokracinë në vend. Pra, mohimi i një të drejte të opozitës ta ushtrojë konform Kushtetutës është minim i demokracisë, po s'ka ndodhur asnjëherë në këtë vend, nuk ka ndodhur asnjëherë në këtë vend t'i kërkohej opozitës ta korrigjojë kërkesën qysh po na boni dhe po insistoni prapë edhe në këtë seancë të thoni 'nuk ka nevojë për dy komisione hetimore parlamentare por duhet bërë një'. Jo, ne mendojmë që ka nevojë edhe për pesë të tjera, do të vijmë edhe me pesë të tjera, ka nevojë për çështje të tjera, jo për energjinë, normalisht, po ka nevojë jashtëzakonisht shumë.

Prandaj ne, prapë po kërkoj të mos vazhdojmë më tutje, ta themelojmë Komisionin Hetimor Parlamentar, t'i japim emrat të gjitha grupet parlamentare opozitare, pastaj vazhdojmë me agjentin ashtu siç jemi dakorduar. Faleminderit!

**KRYETARI:** Mimoza Kusari-Lila.

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Sinqerisht unë kam bindjen thuajse po flasim në dy gjuhë të ndryshme, pa përkthyes në mes, për arsye se atë çfarë po e flet shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, ne po pajtohemi me të gjitha kriteret, por s'po pajtohemi me faktin se si po transmetohet kjo, 's'ka ndodhur kurrë në këtë Kuvend'. Thuajse në Kosovë mënyrën qysh ju po e prezantoni demokracia është në rrezik, janë përkeqësuar të gjitha parametrat e demokracisë, a realisht në matjen ndërkombëtare po ndodh e kundërta. Ne jemi duke ofruar zgjidhje, ne jemi në një situatë ku kompozicionin e forcave politike në Kuvend nuk e kemi bërë individualisht, e ka bërë dikush tjetër që na ka deleguar këtu dhe këta janë deputetët dhe këto janë përfaqësime të grupeve parlamentare.

Tash, fakti që ju e keni sjellë një kërkesë me 40 nënshkrime pa lënë mundësi të një grupi parlamentar të udhëheqë komisionin, nuk është gabim yni, gabimet e mëhershme e kanë sjellë këtë rrethanë në Kuvend, po mos t'i përsërisim ne gabimet që po thonë po shkelim një dispozitë

ligjore për arsye se ju po doni ta minoni demokracinë. Jo, jo. Ne jemi për transparencë 100%, e kemi ofruar një mundësi, e cila ka qenë mundësi reale, objektiv dhe e logjikshme: të zgjerohet hetimi parlamentar në kohë, për faktin se të analizohet vetëm një tremujorësh, në një sektor në të cilin bëhen investime me vite të tëra ose situata është si pasojë e vendimeve të viteve të tëra, është e palogjikshme qysh është strukturuar, po sido qoftë, edhe në atë mënyrë qysh e keni sjellë, edhe në atë mënyrë se si ju e keni prezantuar, ju kemi tregu e ju kemi dëshmuar disa herë që në rrethana të njëjta, në kërkesa të njëjta, kur janë ezauruar nënshkrimet e grupeve parlamentare të opozitës, duke e pamundësuar kryesimin e komisionit, propozuesi gjithmonë ka tërhequr nënshkrimet e një grupi parlamentar për të ofruar mundësinë që një grup parlamentar të ketë kryesimin e Komisionit Hetimor.

Tash, ndërlidhja ose deklarimi se këtu është vendosur ose është në agjendë votimi për gjykatës të Gjykatës Kushtetuese, edhe kjo është absolutisht e padrejtë të thuhet se është vendosur pa konsultë ose nuk janë konsultuar grupet parlamentare në Kuvend. Përderisa procesi prej shpalljes, testimi, intervistimit ka qenë gjithëpërfshirës, ka qenë transparent, e ka pasur rezultatin e publikuar dhe kandidatët e përzgjedhur prej momentit kur janë kryer intervistat, çka tjetër duhet pasur në mes të procesit kur kryhen të gjitha procedurat për përzgjedhje të kandidatëve për Gjykatë Kushtetuese, deri në momentin kur vinë në votim dhe sot janë ata në votim në agjendë, në pikë të rregullt të rendit të ditës.

Prandaj, është e domosdoshme që si proces të përmbyllet, shpresojmë suksesshëm sot, në mënyrë që edhe në një institucion të rëndësishëm të lartë të kemi kompletim ashtu siç kërkohet dhe ashtu siç sigurojmë mbarëvajtje dhe funksionim të institucionit.

Tash, në kërkesën tuaj për një çështje, e cila po ka ngërçe e po ka probleme në raport me dispozitat ligjore, ju po doni t'i minoni të gjitha të tjerat që pasojnë, mirë prapë është zgjidhje juaj, ne nuk mund të sjellim vendime për ju. Ne po mundohemi të jemi pjesë e zgjidhjeve.

Por ju lutem, konsideroni edhe vlerësoni drejt të gjitha rrethanat që na kanë sjellë këtu, për arsye se po jeni jokorrektë ndaj qasjes që po mundoheni ta prezantoni kinse ne po mundohemi të minojmë diçka ose të fshehim diçka ose të dëmtojmë demokracinë, ku çdo vlerësim tjetër po e thotë të kundërtën. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia japim fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit!

Po më duket se po sillemi në rreth vicioz dhe po i përsëritim gjërat pa nevojë.

Tentimi i pushtetit, pra i Lëvizjes Vetëvendosje që të interpretojë se çka quhet grup parlamentar në mënyrë arbitrare, është i papranueshëm. Grupi Parlamentar i LDK-së nuk është nismëtar i

formimit të këtij komisioni, kush jeni ju të caktoni a është grupi parlamentar a s'është, kur grupi parlamentar zyrtarisht deklaron që nuk është, çka është kjo sjellje arbitrare kështu. Qysh interpretoni ju që Grupi Parlamentar i LDK-së është nismëtar, kur zyrtarisht kryetari i grupit deklaron me mikrofon që nuk jemi nismëtarë të krijimit të këtij komisioni, kush jeni ju të caktoni tash që ne jemi, ku po e bazoni këtë interpretim tuajin, është e palogjikshme kjo çka po bëni, është e papranueshme. Thoni që LDK-ja qenka nismëtar, ky është problemi i parë.

Problemi i dytë, vazhdoni të insistoni të ndryshoni objektin e hetimit, gabim e keni, nuk ndodh kjo.

Dhe, çështja e tretë, po përsëriteni kot në këtë punë. Ne po deklarojmë që nuk jemi nismëtarë, ju po deklaroni që ne jemi nismëtarë për neve, ju po deklaroni vullnetin tonë politik, ku keni parë që pushteti të deklarojë vullnetin politik të një partie politike opozitare. Qysh e deklaroni ju këtë punë? Ku po e bazoni? Ligji thotë: "Grupi nismëtar", jo "Grupi Parlamentar nismëtar". Grupi Parlamentar nismëtar është PDK-ja, deputetët nënshkruar janë deputetë individualë, prandaj sa po shoh unë, ju po doni të shtyni me zor diçka, ne nuk po duam të pranojmë çka po doni të shtyni ju. Të shohim ku po shkon kjo punë. Nuk ka logjikë çfarë jeni duke bërë ju. Është e papranueshme, e patolerueshme, për demokracinë. Është kufi, të cilin ne nuk pranojmë të kapërcehet. Nuk pranojmë? Tash, forca juaj le të shihet në Kuvend, bëni çfarë të doni, por për ne është e papranueshme dhe e patejkalueshme kjo sjellje.

Vetë i përmende që janë formuar tetë komisione hetimore parlamentare, kryetar. Asnjërit prej këtyre tetë komisioneve hetimore parlamentare pas pavarësisë, pa i përmendur ato që janë formuar para pavarësisë, kurrë nuk i është ndryshuar objekti i hetimit, kurrë nuk është ndryshuar formula e përfaqësimit, kurrë hiç. Kurrë pushteti s'ka ndërhyrë, thjesht e ka votuar dhe u krye muhabeti. Sepse, prapë pushteti e ka shumicën në komision. Pushteti është ai që vendos në fund t'ia rekomandojë seancës raportin, të votohet ose të mos votohet.

Dhe, në fund, prapë është pushteti që e ka shumicën në seancë dhe vendos a kalon, apo s'kalon, raporti dhe të gjeturat e komisionit. Nuk ka kurrfarë logjike kjo që jeni duke bërë, përveç dëshirës për të fshehur, e dëshira për të fshehur, është dëshirë kriminele. Dëshirat kriminele për ta fshehur të vërtetën çfarë ka ndodhur në sektorin e energjisë në fundin e vitit 2021 dhe në fillimin e vitit 2022, për ne është e patolerueshme. Ne nuk tolerojmë, në fuqinë që e kemi nga populli i Kosovës në këtë Parlament. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia japim sërish fjalën kryetarit të Grupit të AAK-së, e ka kërkuar fjalën, Ramush Haradinaj.

**RAMUSH HARADINAJ:** Në Parlament ka pasur në vazhdimësi diskutime për zhvillimet në energji. Për shembull, unë personalisht kam hedhur akuza mbi Vetëvendosjen, mbi kryeministrin

Kurti, mbi ju, për një politikë armiqësore energjetike ndaj Kosovës. Armiqësore. Ju në vazhdimësi i keni penguar investimet në energji, të gjitha investimet, edhe Kosovën C, ose Kosovën e Re, e së fundmi edhe “Gazin”.

T’jua them të drejtën, kjo ideja e një komisioni në kohëzgjatje më të madhe më pëlqen, po jo për çështjen që po e kërkon, po për faktin se çfarë fshihet prapa refuzimit të investimeve në energji nga Lëvizja Vetëvendosje, e këtë mund ta bëjmë një herë tjetër, pra një komision që të diskutojmë dhe të hetohet. Pra, Parlamenti të hetojë pse Lëvizja Vetëvendosje ka vazhduar një politikë kundër investimeve në energji, në burime të qëndrueshme të energjisë.

Ndërsa, mënyra juaj për ta luftuar formimin e një komisioni me kohëzgjatje, ju e keni pasur këtë të drejtë ndër vite, keni mundur ta bëni këtë që dhjetë vjet, që nga 2008-a. Shihet qartë, qytetari i Kosovës e sheh shumë qartë se jeni të frikësuar, se jeni kah fshihni, se po mundoheni përmes kohëzgjatjes të fshihet ajo që ka ndodhur vitin e fundit në energji.

Është fakt i njohur që janë ndarë para nga ky Parlament për blerje dhe subvencionim në energji dhe është fakt i njohur që ky Parlament nuk ka marrë mbrapa një llogari, ku janë shpenzuar ato para, si janë shpenzuar, çfarë ka ndodhur?

Tani së fundmi, i keni transaksionet e ambasadorit të Republikës së Kosovës me kompani që tregtojnë energji, pa një motivacion të qartë pse janë ato para atje? E keni faktin që ambasadori s’ka deklaruar këtë kompani fare në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Ju siguroj se jeni duke i bërë dëm vetes. Duhet të dilni nga kjo situatë, ku keni hyrë vetë. Ju kam thënë edhe në seancën më herët, nuk keni shpëtim. Ju vetëm sa po ia rëndoni vetes faktin dhe fajësinë, duke u fshehur, duke u munduar ta luftoni një komision të kërkuar prej opozitës me një komision tjetër. Dhe, është qesharake.

Lejoni të krijohet komisioni siç është kërkuar. Në periudhën kohore pas gjashtë muajve, kur kryen objektin e vet ky komision, kërkon një komision të ri, për çfarëdo teme tjetër, por nuk ka logjikë sjellja juaj kështu.

E përsëris edhe një herë, ju lutem, nuk mund të fshiheni me kundërkomision. Nuk mund t’i ikni dhënies llogari për atë që ka ndodhur në Kosovë. Së fundmi, ju thashë edhe më herët. Si Aleancë, ne jemi bashkë me opozitën në kundërshtim të refuzimit, ose të luftimit të krijimit të këtij komisioni përmes një komisioni tjetër, por nuk jemi kundër Kosovës. Kur ka ligje që janë për FSK-në, për Ushtrinë, për sigurinë, do të vijmë në seancë dhe në pikat e rëndësishme për jetën e vendit tonë do të vijmë në seancë. Me këtë nuk nënkupton që ne po heqim dorë nga kërkesa e drejtë për një Komision Hetimor Parlamentar, sikurse është i kërkuar nga njëri grup parlamentar opozitar e i përkrahur nga ne të tjerët. Faleminderit!

KRYETARI: I dëgjova me vëmendje të gjitha grupet parlamentare dhe konstatimi im është ky që unë konsideroj krejtësisht me këto qëndrime që i dëgjova, të pafrytshme, ndërprerjen e seancës. Domethënë, krejt çfarë mund të bëj unë është t'i thërras kryetarët e grupeve parlamentare dhe ta dëgjoj në reprizë edhe një herë këtë pozicionim tuajin, por jo kësaj radhe në seancë plenare, po në Zyrën e Kryetarit të Kuvendit, që pak bën dallim sa i përket zhbllokimit të pozicioneve.

Kështu që, me këto qëndrime mazhoranca është e bllokuar në qëndrimin e vet që patjetër duhet ta riformulojë çështjen. Kurse, grupet opozitare s që ka fare nevojë ta formulojnë çështjen në mënyrë të ndryshme, në kuptimin procedural të fjalës. Nuk po shoh mënyrë, se si të vazhdohet tutje, përveçse ndoshta ta thërrasim në të ardhmen shumë të afërt një takim mes grupeve parlamentare, ku të kërkohet njëfarë zotimi për kompromis nga cilado qoftë palë për të vazhduar tutje.

Sa i përket ditës së sotme, krejt çfarë mund të bëjmë është ta ndërpresim seancën dhe të shkojmë, të mos merremi vesh, po të ndërpritet seanca për të mos u marrë vesh, nuk më duket fare e arsyeshme para qytetarëve të Kosovës.

Kështu që, krejt çfarë mund të bëjmë është të vazhdojmë me deklaratimet jashtë rendit të ditës dhe ta trajtojmë po ashtu edhe çështjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Konsideroj që është shumë çështje e rëndësishme për Republikën e Kosovës. Kemi dështuar dy herë me zgjedhjen e këtyre dy gjyqtarëve. Po bëhen disa muaj që Gjykatës Kushtetuese i mungojnë ata. Nuk po them se mund t'i zgjedhim ata, sepse pa pjesëmarrjen e opozitës nuk mund t'i zgjedhim, mirëpo nëse nuk mund t'i zgjedhim, aty ndërpritet seanca e mbase ajo do të ishte ndoshta, njëfarë lloj momentumit që palët të ulen e të mendojnë edhe një herë seriozisht për kompromise, që ta zhbllokojnë punën e Kuvendit të Kosovës.

Urdhëro, zoti Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Sa i përket çështjes së Gjykatës Kushtetuese, mendoj se duhet konsultim mes grupeve parlamentare dhe nuk duhet të jetë në rend dite sot. Faleminderit!

KRYETARI: Problemi është që herën e kaluar e kemi pasur një konsensus, për të cilin të gjithë jemi pajtuar, grupet parlamentare, dhe nuk është zgjedhur. Do të thotë, që kjo nuk është kurrfarë garancie se do të zgjidhen gjyqtarët, mirëpo ne do t'i krijojmë ato kushte.

Sidoqoftë, unë po konsideroj që kjo seancë mund të vazhdojë deri në një moment dhe si kriter unë do ta vendos nëse ka apo nuk ka kuorum, që pastaj të mblidhemi e të vazhdojmë. Ndërsa, nëse keni nevojë, kur të vijmë te çështja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, unë po pajtohem që mund të mblidhemi edhe një herë sa i përket së paku përpjekjes së arritjes të një konsensusi këtu në Kuvend të Kosovës për zgjedhjen e gjyqtarëve.

A jeni të pajtimit që ndoshta të mos i trajtojmë fare deklarinimet jashtë rendit të ditës e të shkojmë drejt në konsultim sa u përket gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe po e fusim në të njëjtën kohë edhe zgjedhjen për Komisionin Hetimor Parlamentar, të dyja. Urdhëro!

ABELARD TAHIRI: Kryetar, faleminderit!

Ne kërkojmë që t'i jepet drejtim Komisionit Hetimor Parlamentar që ta themelojmë, pastaj të vazhdojmë në një normalitet në Kuvendin e Kosovës.

Çështja e Gjykatës Kushtetuese, pajtohem plotësisht me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar, zotit Gashi. Nëse duam që t'i dërgojmë dy gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, ajo pikë duhet të largohet sot nga rendi i ditës, sepse herën e kaluar pikërisht takimi që e kemi pasur ne brenda një periudhe shumë të shkurtër dhe kemi hyrë në votim, ka rezultuar i pasuksesshëm. Dhe unë mendoj, që edhe ju, edhe grupet tjera parlamentare opozitare, duhet t'i bindim deputetët tanë me atë çfarë dakordojmë. Herën e kaluar s'kemi mundur t'i bindim deputetët tanë, apo më mirë të themi s'keni mundur t'i bindni ju, sepse ne kemi qenë dakord me marrëveshjen e dakorduar në zyrën tuaj.

Prandaj, në qoftë se duam t'i dërgojmë dy gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, kjo pikë sot duhet të largohet nga rendi i ditës, ashtu siç e propozoi kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Arben Gashi. Faleminderit!

KRYETARI: Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Kryetar,

Ne mund të vazhdojmë të diskutojmë në tema të ndryshme, por një pikë është dhe ajo pikë është që sot vazhdojmë me seancë, ashtu siç është paraparë në mbledhje të Kryesisë. Gjithë këtë debat, të cilin po e trajtojmë në raport me Komisionin Hetimor Parlamentar e kemi kryer me shumë orë të tëra këtu në seancë.

Gjithashtu, qëndrimet i kemi prezantuar të gjithë dhe tash prapë po insistohet që një pikë e rëndësishme tepër të lartë, ajo e zgjedhjes së gjykatësve për Gjykatën Kushtetuese, të bëhet peng i një procesi tjetër, e pas kësaj do të vijnë edhe të tjera. Para kësaj i kemi pasur katër marrëveshje ndërkombëtare, tash edhe kjo dhe pastaj këtu po krijohet një përshtypje se me qëllim po duam ta bllokojmë institucionin, ose institucionet, të cilat presin vendimmarrje nga Kuvendi.

Ajo është një temë, në të cilën opozita po insiston që ta ketë në formatin e vet. Mirë, në rregull. Në formatin e vet në përputhshmëri me ligjin. Nëse nuk e kanë në përputhshmëri me ligjin, nuk e kanë si të na kërkojnë neve që të shkohet në përputhje me kërkesën e tyre kur ka ndeshje. Njëjtë e keni pasur në kërkesën për hetim parlamentar për hidrocentralet. E keni ndryshuar, e keni zgjeruar objektin e hetimit me vite të tëra. Njëjtë ka qenë edhe për privatizimin, është ndërruar.

Gjithmonë kanë qenë kërkesa për të dyja të Grupit Parlamentar të PDK-së. Dhe tash, ka pasur raste ku është dashur edhe Lëvizja Vetëvendosje të tërhiqet nga nënshkrimet. Pse gjithë ky problem të ketë një grup parlamentar që të tërhiqet nga nënshkrimet për ta mundësuar kryesimin e grupit.

Mënde, po dalim në temën tjetër, jo, votimi për kandidatë të Gjykatës Kushtetuese është sot në agjendë. Është vendosur, ka qenë agjenda publike. Kemi obligime institucionale e kushtetuese në raport me detyrat që i mbajmë. Nëse ju doni të jeni në kundërshtim me obligimet dhe detyrat që i keni marrë, ajo është zgjidhje juaja, por ne nuk mund të jemi pjesë në atë proces.

Ne kërkojmë që seanca të vazhdojë ashtu siç është paraparë. Pika e parë e rendit të ditës janë deklaratimet jashtë rendit të ditës. Ne kështu-ashtu po deklarohe mi, por po deklarohe mi vetëm për një çështje. Të deklarohe mi për çështje që kanë minutazhë të caktuar dhe përgatitje paraprake. Faleminderit!

KRYETARI: Po, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Me sa po kuptoj unë, nga sjellja verbale e dhunshme e kryetares së pushtetit... *(Të qeshura në sallë)*, ...qeshni, qeshni, se qesheni më vonë.

Ju nuk keni dëshirë as të ketë Gjykatë Kushtetuese e as Kuvend. Po e çoni Kuvendit drejt paaftësisë vendimmarrëse. Mbajeni mend, po e çoni Kuvendin me veprimet tuaja drejt paaftësisë vendimmarrëse dhe po e rrezikoni kushtetutshmërinë në këtë vend duke shkelur demokracinë dhe duke shkuar ende më tej, duke paaftësuar edhe Gjykatën Kushtetuese. Kjo është e papranueshme. Kjo sjellje është e papranueshme dhe po e shtini Kuvendin dhe vendin në një situatë të një konflikti të brendshëm politik, për të cilin nuk di se si doni ta zgjidhni.

Ju si shumicë e keni për detyrë të gjeni kompromisin, jo ta paaftësoni kompromisin. Ju e keni pushtetin. Mimoza po ankohet që ne po i shajmë. Mimozë, dalim të lavdërojmë, veç bëni punë të mira. Ju e keni për detyrë të gjeni kompromisin, ndërkohë që po e bëni të kundërtën, po e kultivoni dhunën verbale në këtë Kuvend.

Çfarë logjike ka pushteti të kultivojë dhunën, kur i duhen votat e opozitës. I keni krejt mekanizmat e shtetit në dispozicion dhe vazhdoni të kultivoni dhunën verbale ndaj opozitës. Atëherë, kjo e bën të pamundshëm bashkëpunimin. Qysh të bashkëpunohet me ju? Qysh të merremi vesh për të votuar për Gjykatën Kushtetuese? Qysh të merremi vesh të lejojmë me vullnetin tonë të ketë normalitet Kuvendi, kur ju nuk jeni në gjendje për një të drejtë kushtetuese të opozitës të lejoni të realizohet, ku vetë e keni shumicën? Vetë e keni shumicën, edhe në komision, edhe në seancë. Cila është logjika e bllokimit? Çka doni të mbërrini me këtë punë?

Apo thjesht, të mos hetoheni. Eh, thjesht të mos hetoheni, kjo s'bën, kjo s'mund të ndodhë. Jo, me vullnetin tonë, se prapë forca bën gjithçka, po vullneti ynë nuk është që ju të pamundësoni një të drejtë kushtetuese për opozitën.

Opozita veç këtë të drejtë kushtetuese e ka, krejt mekanizmat dhe të drejtat e tjera i keni ju, se e keni shumicën dhe i kryeni punët. Dhe po kërkoni që ne të heqim dorë prej një të drejte kushtetuese, sepse ju po ndjeheni të kritikuar dhe të kërcënuar nga drejtësia dhe e vërteta. Eh, këtë s'mund ta bëni. Më vjen keq, po këtë s'mund ta bëni. Jo me vullnet, të paktën. Jo me vullnet dhe me vetëdije.

Prandaj, po ju deklaroj se jeni duke e çuar Kuvendin në një rrugë pa krye. Faleminderit!

**KRYETARI:** Për mendimin tim, ky Komision Hetimor duhet të themelohet kurdoherë, e kur nuk e dimë. Duhet ta gjejmë mënyrën të dy palët që të themelohet ky komision.

Artan Abrashi, për çka e ke kërkuar fjalën?

*(Goditje tavolinash, zhurmë dhe fishkëllima në sallë)*

Artan Abrashi në emër të Grupit Parlamentar.

**ARTAN ABRASHI:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në këto kushte, ku opozita e Kosovës nuk di të bëjë as opozitë, në fakt, po i pengojnë sukseset e Republikës sonë, të cilët ne do t'i themi, pavarësisht tendencës për ta bllokuar punën e institucionit më të lartë të shtetit.

Më 3 maj u shënuar Dita Ndërkombëtare e Lirisë së Shtypit, me ç'rast organizata Reporterët pa Kufi publikoi indeksin botëror për lirinë e shtypit për vitin 2022.

Si asnjëherë më parë, Kosova këtë vit ka shënuar përparim sa i përket lirisë së mediave. Vendi ynë është ngritur për plot 17 pozita më lart, nga pozita e 78-të, sa ishte në vitin 2021, në pozitën 61 për këtë vit. Sigurisht, jemi të vetëdijshëm që raporti i lirisë së shtypit ka paraqitur edhe vështirësitë me të cilat përballen gazetarët në kryerjen e punës së tyre, por në shumicën e rasteve kjo nuk ka të bëjë me qeverisjen aktuale.



Ndërsa, edhe në rastet kur ka pasur cenim në kryerjen e detyrës, siç ishte rasti i arrestimit të një kameramani nga policia gjatë kryerjes së detyrës së tij, reagimi i institucioneve përgjegjëse ka qenë i menjëhershëm, duke marrë masa disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Ndërsa ne, si Kuvend i Kosovës, në shkurt të këtij viti kemi miratuar ndryshimin për ndihmën juridike falas, duke i vendosur gazetarët, fotoreporterët, kameramanët, redaktorët, si kategori përfituese të ndihmës juridike falas.

Po ashtu, Kuvendi i Kosovës ka bërë zgjedhjen dhe plotësimin e institucioneve të pavarura dhe publike në proces transparent dhe kredibil për:

1. Bordin e Pavarur për Media, pra Komisionit të Pavarur për Media.
2. Bordin e ARKEP-it,
3. Bordin e RTK-së.

Për ata që mund të kenë harruar, ky nuk është suksesi i vetëm i Kosovës sa i përket zhvillimit të demokracisë në Kosovën e pas 14 shkurtit të vitit 2021. Sipas raportit të Transparency International, në indeksin për perceptimin e korrupsionit për vitin 2021 Kosova ka shënuar përmirësim, duke u ngritur 17 vende më lart në krahasim me vitin 2020, ku është ngritur për 3 pikë pra nga pozita që ka qenë më herët.

Shumë të nderuar deputetë,

Gjithashtu në raportin e Freedom House për vitin 2022, në aspektin e qeverisjes Kosova u përmirësua nga 2,50 në 3,0. Pavarësia e gjyqësorit u përmirësua nga 2,50 në 2,75 dhe demokracia u përmirësua nga 3,14 në 3,25.

E di që nuk po ju pëlqejnë këto shifra, por janë matës e tregues të progresit dhe të zhvillimit të vendit tonë. Këto, sa i përket matjeve të institucioneve ndërkombëtare, të cilat rangojnë shtetet sipas përparimit në fushat e lartcekura. Përderisa, me matjet e brendshme tash, këto janë të brendshme, në anketën e pulsit publik, për vitin 2021 të organizuar nga UNDP dhe USAID-i, përveç kënaqshmërisë së lartë për presidenten e Republikës së Kosovës, për kryeministrin e Republikës së Kosovës dhe të nderuarin, kryetarin e Kuvendit, anketa ka regjistruar rritjet më të larta ndonjëherë në indeksin e demokratizimit dhe të besueshmërisë ekonomike.

Po ashtu, rritje për 6% në kënaqshmëri me drejtimin politik të vendit tonë, pra nga 24,7% në 30,7%, që paraqet nivelin më të lartë të kënaqshmërisë të regjistruar ndonjëherë nga anketat e pulsit publik.

*(Vazhdojnë goditje tavolinash, zhurmë dhe fishkëllima në sallë)*

KRYETARI: Unë mund të them “qetësi”, nëse doni. A të përfundoi koha, a? Pesë minuta i ke pasur, Artan. Faleminderit! Shtoja edhe një minutë, pra.

ARTAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Pra, ndërsa për herë të parë, prej kur bëhen matje të tilla, korrupsioni është larguar nga top tre problemet kryesore të shoqërisë sonë, duke pësuar ulje nga 9,3 në 4,5, sukses ky i jashtëzakonshëm i Qeverisë Kurti.

Të dashur qytetarë të Republikës,

Të vetëdijshëm deri në fund për secilin premtim tonin dhe pritjen tuaj nga pozita e sotme, këto vlerësime dhe këto rangime të përmirësuara për vendin tonë, na japin forcë, na japin vullnet neve për të vazhduar punën për ju dhe me ju. Ndërsa, për ju duhet të jetë tregues se besimi juaj ndaj nesh po kthehet në rezultate për vendin. Këto shifra, këto fakte po i pengojnë opozitës, e vërteta po i mungon opozitës. Ne do të vazhdojmë me përkushtimin më të madh për realizimin e zotimeve tona karshi qytetarëve të Republikës së Kosovës, për ta bërë këtë vend ashtu si duhet të jetë për t’ia plotësuar...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Zonja Lila, a e ke kërkuar fjalën? Fatmire Kollçaku e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Shpresoj që opozita nuk do të lodhet me përkrahjen e fjalimeve tona, sepse ne nuk lodhemi kurrë. Prandaj, jemi këtu ku jemi.

Sot këtë vit, Një Maji - Dita ndërkombëtare e të drejtave të punëtorëve korrespondon, edhe kjo fjalë e rastit korrespondon edhe me shënimin e Ditës ndërkombëtare të mamive, gjë që do t’ua dedikoj këtë ditë, mirëpo paraprakisht do t’i përmend vetëm disa të arritura, të cilat i ka bërë Qeveria Kurti për punëtorët brenda këtij viti qeverisës.

E filluam me sigurimin e kushteve të punës, që mundësojnë dhe lehtësojnë krijimin e vendeve të reja të punës e që përafrojnë tregun e punës me arsimimin profesional. Pas 11 vjetësh i hapëm rrugë ngritjes së pagës minimale. Punësimin e mbështetëm edhe me pakon e ringjalljes ekonomike dhe mbi një mijë punëtorë u rikthyen në punë pas humbjes së vendit të punës gjatë pandemisë. Mbi katër mijë punëtorë, burra e gra, përfituan nga mbështetja e punëtorëve të formalizuar e mbi katër mijë gra përfituan nga masa e mbështetjes për punësimin e grave. Mbështetje shtesë për punëtorët e sektorit publik me shumën e menjëhershme me nga 100 euro, për të mos lënë askënd prapa, e për mundësi të barabarta në vitin 2022 e kemi shpallur vit të personave me aftësi të kufizuar, gjë që kjo kategori e shoqërisë të aftësohet për punë kemi marrë masën e përkrahjes me 170 euro për të trajnuarit e tyre dhe me 100 euro biznesin ku mbahet trajnimi.

Në rastet kur nga trajnimi pason punësimi, do të subvencionohen paga e të punësuarve me 270 euro. Formalizimi i vendeve të punës që ishte premtimi ynë, për trajtim të dinjitetshëm të punëtorëve jemi duke punuar në kompletimin e legjislacionit nga kjo fushë.

Do t'i rikthehem shënimit të Ditës ndërkombëtare të mamive, që për herë të parë u festua më 5 maj të vitit 1991 dhe që nga ajo kohë për të shënuar këtë ditë trajtohen tema të ndryshme vetëdijesuese në mbështetje të mamive, të cilat kujdesen për shëndetin e nënave dhe të të sapolindurve të tyre. Profesionit i mamisë mbi shëndetin e nënës nënkupton shëndetin e gruas dhe mirëqenies. Shërbimi i mamisë është unik në mënyrën se si ndikon në shëndetin e brezave të ardhshëm, shëndetin riprodhues, nëpërmjet këshillimeve për prindërit e rinj nga planifikimi familjar, para shtatzënësisë, shtatzënësisë, lindja, paslindja dhe javët e hershme të jetës. Sipas ekspertëve vdekshmëria e nënës dhe foshnjës në mbarë botën ka rënë vazhdimisht që nga viti 1990, megjithatë qindra-mijëra gra dhe të sapolindur ende vdesin çdo vit gjatë shtatzënësisë dhe lindjes. Shumica dërrmuese e këtyre vdekjeve janë për shkak të komplikimeve e sëmundjeve që mund të ishin parandaluar nga kujdesi i duhur para lindjes dhe kujdesi obstetrik...

**KRYETARI:** Një minutë, urdhëro!

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Jemi duke bërë ndryshimin e nevojshëm për kuadrin ligjor që do t'u mundësojë mamive të sigurojë kujdes me respekt, duke pasur parasysh se mamia luan rol thelbësor në shëndetin seksual dhe riprodhues, shëndetin e nënës dhe të neonatit dhe shëndetin e adoleshentëve.

Po ashtu programet tona do të bazohen në investime të drejtpërdrejta në maternitete, ku ka nevojë për mbështetje në pajisje dhe ndërhyrje në infrastrukturë si dhe në trajnimin e stafit të mjekëve, infermierëve dhe mamive. Pra, do të mbështesim të gjitha maternitetet dhe të krijojmë aty ku janë mbyllur apo nuk kanë ekzistuar fare. Ju falënderoj shumë, si dhe opozitën për gjithë këtë mbështetje të madhe.

**KRYETARI:** Enver Dugolli, a e ke kërkuar fjalën?

**ENVER DUGOLLI:** Faleminderit, kryetar!

Sot është Dita e Dëshmorëve, prandaj kolegë të nderuar, ju lutem për qetësi, se dëshmorët kërkojnë nderim. Dëshmorët janë e kaluara jonë, dëshmorët janë e ardhmja jonë. Të paktën, ndërprejini këto zhurma, sepse dëshmorët nuk duan zhurma.

Historia jonë është e lavdishme, sepse kemi dëshmorë. Historia jonë është e madhe sepse kemi dëshmorë. Historia jonë nuk do të harrohet, nuk do të shlyhet, sepse kemi dëshmorë dhe të gjitha që kemi arritur dhe po arrijmë falë gjakut të tyre anekënd atdheut, prandaj të paktën kolegë nga opozita, të paktën dy minuta, një minutë heshtni, ngase po i trazoni edhe dëshmorët. Është Dita e

Dëshmorëve, ju lutem! Dita e Dëshmorëve nuk përkujtohet me zhurma e me krisma. Krismat dëshmorët i patën dëgjuar në momentin e fundit të rënies së tyre, krismat nga pushkët e armikut, por jo edhe krismat me shishe e grushte në tavolinë.

Lavdi dëshmorëve të kombit!

Respekt të gjithë atyre që me gjakun e tyre na sollën këtu ku jemi anakënd atdheut. Faleminderit!

KRYETARI: Kalojmë tash te pyetjet parlamentare. Gazmend Gjyshinca e ka fjalën.

GAZMEND GJYSHINCA: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit për fjalën. Meqenëse sot po flasim për punën e Qeverisë, punën e mirë, të jashtëzakonshme të Qeverisë Kurti, më lejoni që t'i them dy-tri fjalë në lidhje me politikën e jashtme.

Në përputhje edhe me programin e Qeverisë së Kosovës, puna e mirë që është bërë deri më tani nga Qeveria Kurti ka pasur për synim parësor forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Me mision të posaçëm, arritjen e njohjeve të reja, anëtarësimin e plotë në organizatat ndërkombëtare rajonale dhe sjelljen e investimeve të huaja direkte në vendin tonë.

Në këtë kontekst, në mënyrë specifike, rëndësi të veçantë i është dhënë forcimit të vazhdueshëm të partneritetit strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtimit të numrit të njohjeve, me fokus të pesë vendeve të Bashkimit Evropian, të cilat ende nuk e kanë bërë këtë. Integrimi në strukturat euroatlantike, promovimin e interesave ekonomike të Republikës sonë. Pra, në shërbim të kësaj që u tha, Qeveria Kurti ka hedhur hapat e parë përmbajtjesorë në drejtim të ndërtimit të një shërbimi të fortë diplomatik, që i shërben pra agjendës ndërkombëtare të Republikës sonë.

Këta hapa ndërtohen mbi integritet, dije dhe etikë të lartë të punës. Brenda vetëm një viti, kjo Qeveri ka filluar reformimin e shërbimit tonë diplomatik, i cili ishte i mbushur me militantë e familjarë të atyre të cilët sot po e pamundësojnë punën e Kuvendit të Kosovës.

I gjithë ky proces i reformimit është arritur në tri faza. Është arritur fillimisht duke e bërë reformimin e brendshëm, kthimin e ligjshmërisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës dhe nën tre, forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës dhe mirënjohje për të cilën punë po vijnë nga partnerët tanë ndërkombëtarë, e jo më larg se dje nga kancelari i Gjermanisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Gjermanisë si ndër partnerët kryesorë të republikës sonë.

Më lejoni që shkurtimisht ta përmend me fakte e numra punën e mirë që Qeveria jonë ka bërë në sektorin e punëve të jashtme. Janë shkarkuar 13 ambasadorë dhe katër konsuj. Pra, nuk është e

rastësishme kjo zhurmë dhe zhurma që po ndihet sot është jashtëzakonisht në sinkron me ato vendime të cilat janë marrë. Janë emëruar gjashtë ambasadorë politikë dhe nëntë të karrierës. Nga 31 ambasada në total, gjashtë ambasadorë janë politikë, 19 të karrierës dhe gjashtë janë pozitë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Shtoja edhe një minutë!

**GAZMEND GJYSHINCA:** Pra, shërbimi ynë diplomatik për herë të parë po ndërtohet me njerëz të cilët janë diplomatë të karrierës, me etikë të lartë të punës dhe me integritet profesional.

Për ta përmbyllur, jo më larg se ditë më parë, presidenti i Serbisë i ka quajtur akuzat e Perëndimit ndaj Rusisë si të çmendura dhe të turpshme, gjë që tregon më qartë se asnjëherë më parë orientimin që ky shtet ka marrë. Mirëpo, ajo çfarë ne do të duhej ta bënim sot, është unifikimi. Është që ne të rreshtohemi përreth interesave të Republikës sonë dhe ashtu të ecim përpara. Por, ajo çfarë kjo opozitë sot po manifeston dhe po dëshmon, është e kundërta e interesit tonë. Kështu që ne do të vazhdojmë të jemi konsistentë në qëndrimet tona. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kalojmë te pika:

## **2. Pyetje parlamentare**

Ferat Shala ka pyetje për Rozeta Hajdarin. Deputet, a dëshiron ta bësh pyetjen? Jo! Time Kadria nuk është këtu. Deputeti Enver Dugolli.

**ENVER DUGOLLI:** Faleminderit, kryetar!

Meqë ministri nuk qenka këtu, unë po e bëj pyetjen, po e shfrytëzoj pyetjen, për shkak se do të marrë me siguri përgjigje me shkrim, por ju lutem Abelard, pa zhurmë, ose ngjitja shurdhuesit, për shkak se pyetjen e kam për shurdhuesit, dhe ngjitja shurdhuesit zhurmës, mos të bëhet zhurmë.

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka disa javë që opinionimi publik është në njëfarë terri informativ sa i përket një lajmi ku raportohet se kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së gjatë kohës sa ishte shef i kabinetit të Kryeministrit Thaçi bashkë me stafin politik është pajisur me armë të personalizuar dhe shurdhues. Shurdhuesit apo ngufatësit e tytave të armëve janë të ndaluara sipas Kodit Penal dhe nuk e di ndonjë rast kut mund të përdoren në mënyrë të ligjshme. Shto këtu që armët me

shurdhues nuk përdoren për vetëmbrojtje. Dihet se për blerjen e armëve dhe pajisjeve për mbrojtje të afërt dhe vetëmbrojtje, ekziston departamenti i veçantë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës, të cilët janë përgjegjës dhe të obliguar të planifikojnë blerjen e armëve dhe pajisje, duke u bazuar në Ligjin për armë dhe municione.

Një çështje tjetër që doli tash së voni është se shefi i kabinetit Thaçi, tani kryetar i Grupit Parlamentar, në kundërshtim me rregulla dhe procedurat ligjore, e kishte mbajtur këtë armë për katër vjet, për shtatë vjet pas mandatit. Pyetja është kjo?

Së pari, ju lutem, a mund të na tregoni si qëndron e vërteta në lidhje me këtë lajm, dhe nëse është e vërtetë, a është ndërmarrë ndonjë veprim apo procedurë hetimore për këtë çështje. Dhe së dyti, a jeni të informuar?

**KRYETARI:** Deputeti Luan Aliu, pyetjen e ka për ministrin Hekuran Murati.

**LUAN ALIU:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju lutem deputetë të opozitës, dëgjojeni se është pyetja me rëndësi, sidomos Ganimete Musliu. Më 1 mars, kryeministri Kurti ka autorizuar Ministrinë e Financave, Punë dhe Transfere për hapjen e llogarisë dedikuar për fondin e sigurisë, përmes të cilit mërgatës dhe gjithë qytetarëve u është mundësuar që të kontribuojnë në mbështetjen e Qeverisë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Siç dihet, ky fond ka pasur mbështetje të madhe si nga brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Por, për shkak të procedurave rreth transfereve bankare, dhe krijimit të lehtësirave të mërgatës për të kontribuar, ka kërkesa që të hapet llogaria bankare edhe jashtë vendit.

I nderuar ministër,

Pyetja është: a është duke punuar Ministria e Financave, Punë dhe Transfere në hapjen e llogarisë bankare edhe jashtë vendit, në mënyrë që mërgatës t'i krijohet mundësia më e lehtë për të kontribuar në fondin për siguri. Faleminderit!

**HEKURAN MURATI:** Faleminderit për pyetjen, i nderuar deputet!

Ne si Ministri kemi filluar tashmë punët për hapjen e një llogarie në mërgatë, në mënyrë që të mundësohet kontributi edhe i tyre. Po ashtu, jemi duke shqyrtuar edhe mundësinë që të bëhet edhe 'payment...' në mënyrë që të ketë mundësi të bëhen pagesa edhe me këste, apo pagesa periodike, pra që dikush të ketë mundësi të kontribuojë në vazhdimësi. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Aliu!

LUAN ALIU: Faleminderit ministër për përgjigjen dhe kërkoj ndjesë për këtë zhurmë. Një zhurmë për asgjë.

KRYETARI: Time Kadriaj, pyetje për ministrin Rifat Latifi. Nuk dëshiron deputetja ta bëjë pyetjen, kështu që u krye edhe me pyetjet parlamentare.

Kalojmë në pikën tjetër:

### **3. Propozimi i dy kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese**

Të nderuar deputetë,

Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për emërimin në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës... dhe Kuvendit ia ka paraqitur për votim listën e ngushtë me katër kandidatë për dy pozita.

Raporti i komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Deputetin Enis Kervan nuk e paskemi këtu si zëvendëskryesues i dytë i komisionit që në emër të këtij komisioni ta paraqesë dhe arsyetojë raportin.

Grupet parlamentare nëse e duan fjalën për përzgjedhjen e dy kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Nuk e do fjalën askush. Po i sqaroj vetëm disa procedura sa i përket këtij procesi.

Komisioni i posaçëm të nderuar deputetë, ka rekomanduar që propozimi i dy gjyqtarëve të bëhet me votim të fshehtë. Procedura e votimi në seancë për propozimin e dy kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, në bazë të nenit 6, paragrafi 10 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lista e ngushtë përmban më shumë kandidatë sesa numri i gjyqtarëve të cilët do të zgjidhen, por jo më tepër se pesë kandidatë për një pozitë të lirë. Me ligj nuk është e rregulluar mënyra e votimit në seancë plenare. Pra, nuk është saktësuar votimi që të jetë i hapur apo i fshehtë për propozimin e kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese.

Prandaj, para se të zhvillohet procedura e votimit për propozimin e kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, duhet të miratohet procedura e votimit si në vijim. Votimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës bëhet me votim të fshehtë.

Principi i dytë që deputeti i Kuvendit, prej katër kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të rekomanduar nga komisioni i posaçëm i voton dy kandidatë për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.

Principi i tretë që nëse në votimin e parë me katër kandidatë për dy pozita, asnjëri kandidat nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, kandidati që ka marrë më së paku vota hiqet nga lista dhe votimi përsëritet me tre kandidat për dy pozita.

Principi i katërt që nëse në votimin e dytë me tre kandidatë për dy pozita, asnjëri kandidat nuk e merr numrin e nevojshëm të votave, përsëritet konkursi.

Principi i pestë që votimet vijuese zhvillohen nëse vetëm një kandidat e merr numrin e nevojshëm të votave, si dhe principi i gjashtë pra, nëse kandidatët marrin numër të njëjtë të votave, votimi përsëritet përderisa njëri prej kandidatëve fiton numrin më të madh të votave.

Kjo është pra procedura. Tash na kërkohet numri i saktë i deputetëve sa marrin pjesë në votim.

82 deputetë jemi të pranishëm në sallë.

Deputetë të nderuar,

Do të votojmë tash për procedurat e votimit për ato gjashtë parimet të cilat i thashë.

E kemi kuorumin e mjaftueshëm për të votuar. Deputetë, po ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për procedurat e votimit për kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Nuk ka pasur kuorum për të votuar për këtë procedurë, kështu që shkojmë në pauzë deri në orën 12.30.

\* \* \*



*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca*

KRYETARI: Ju lutem, uluni nëpër vendet tuaja. Nuk patëm kuorum për të vendosur për procedurat e votimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Në proces jemi.

Të nderuar deputetë, meqenëse e kemi kuorumin, a votojmë për procedurat që i lexova lidhur me Gjykatën Kushtetuese.

Përgatituni për votim. Gjashtë principe janë, i kam shpjeguar më herët.

*(Goditje tavolinash, zhurmë dhe fishkëllima në sallë)*

Të nderuar deputetë, kush është për procedurat e votimit për Gjykatën Kushtetuese?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Atëherë konstatoj që me 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, është miratuar procedura për zgjedhjen e dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

*(Goditje tavolinash, zhurmë dhe fishkëllima në sallë)*

Bazuar në nenin 114 të Kushtetutës propozimi i kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese bëhet me 2/3-at e votave të deputetëve që marrin pjesë në votim. Për zbatimin e procedurës së fshehtë kërkohet formimi i një komisioni votues në përbërje nga deputetët prej secilit grup parlamentar. Ia japim fjalën kryetares së Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila, kë e propozon Vetëvendosja në Komisionin e votimit?

MIMOZA KUSARI-LILA: Po, kryetar, faleminderit!

Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje propozojmë deputetin Sali Zyba.

KRYETARI: Salih Zyba. PDK-ja nuk e merr fjalën, me siguri. LDK-ja? Aleanca, kë e propozon në Komisionin e votimit?

Albana Bytyqi propozohet. Mirë. Grupi Multietnik kë e propozon?

ENIS KERVAN: Kryetar, deputetja Samra Iljazi.

KRYETARI: Samra Iljaz, mirë. Lista serbe? Nuk e ka kërkuar fjalën Lista serbe.

Atëherë, të nderuar deputetë, ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për Komisionin e votimit.

Kush është për këtë Komision të votimit? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatoj që me 65 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e themeloi Komisionin e votimit në atë përbërje, të cilën e dëgjuat.

I lus deputetët që t'i zënë vendet e tyre, ata që u zgjodhën në Komisionin e votimit, për të cilin votoi seanca.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Deputetë të nderuar,

*(Goditje tavolinash, zhurmë dhe fishkëllima në sallë)*

Uluni nëpër vendet tuaja, deputetë! Ju lutem, zgjedhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është shumë me rëndësi dhe ju lutem që ta lejoni këtë proces.

Nuk është qëllimi aty. Ju lutem, vetëm kthehuni në vendet tuaja. Vazhdon ky proces, në rregull jemi. Po, vazhdon, nuk bën të ndalet procesi me dhunë.

Zoti Beqaj, a mund të ktheheni në vendin tuaj?

*(Ndërprerje e incizimit)*

Atëherë, i ftoj nënkryetarët dhe kryetarët e grupeve parlamentare që të ngjitemi dhe ta mbajmë një mbledhje lidhur me procedimin e mëtutjeshëm të seancës dhe pastaj takohemi në orën katërmëdhjetë.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

**KRYETARI:** Të nderuar deputetë, zini vendet tuaja!

Pas një konsultimi në Kryesinë e Kuvendit, po edhe me kryetarët e grupeve dhe me nënkryetarët, u arrit një formë e kompromisit që të vazhdojmë përpara. Pra, që të procedojmë me një mocion, të cilin do ta ngre unë si kryetar i Kuvendit, edhe në emër të grupeve parlamentare, një mocion i cili faktikisht ka qenë kërkesë e Partisë Demokratike dhe një mocion tjetër i cili ka qenë kërkesë e Lëvizjes Vetëvendosje.

Pra, po e bëjmë në dy pika mocionin:

1. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ashtu siç është kërkuar më 28 prill. Kjo pikë ka qenë pjesë e rendit të ditës së seancës së kaluar. Po e zhvendosim dhe po e trajtojmë në seancën e sotme.

Ne faktikisht vetëm patëm hyrë në procedimin e kësaj pike, sepse disa prej grupeve parlamentare i kanë dhënë emrat e tyre. Ka mbetur vetëm që edhe mazhoranca dhe Grupi Multietnik t'i japin emrat.

Kurse pika e dytë e mocionit të jetë:

2. Krijimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, i propozuar nga deputetja Mimoza Kusari-Lila, i mbështetur edhe nga 40 deputetë të tjerë për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë në periudhën 2006-2022, në të gjitha nivelet. Në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në atë të ndërmarrjes publike.

Pra, këto dy Komisione Hetimore Parlamentare që t'i themelojë Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të kemi mocion. A pajtoheni me këtë mocion që këto dy pika të hyjnë në rendin e ditës?

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Kanë votuar 82 deputetë. Të gjithë e kanë dhënë votën e tyre për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kështu që, konstatoj që kaloi mocioni 2 pikësh i ngritur e që e prezantova më herët.

Tash kalojmë në trajtimin e pikës së parë, që është:

*1. Votimi për caktimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës*

I kemi tejkalluar të gjitha procedurat lidhur me këtë çështje. Grupi Parlamentar i PDK-së e ka propozuar Ferat Shalën si zëvendëskryesues dhe Eliza Hoxhën si anëtare.

Grupi Parlamentar i LDK-së e pati propozuar Driton Selmanajn si kryesues dhe Besian Mustafën si anëtar. Pal Lekaj, po ashtu është propozuar nga Grupi Parlamentar i AAK-së.

E ftoj kryetaren e Grupit të Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila që t'i propozojë emrat për Komisionin Hetimor.

MIMOZA KUSARI-LILA: Më fal, kryetar! A është kjo për periudhën e shkurtër kohore, tash?

KRYETARI: Po. E vendosëm këtë të parën, sepse kjo është kërkuar së pari prej grupeve parlamentare.

MIMOZA KUSARI-LILA: I propozoj Artan Abrashin, Enver Halitin, Jeta Statovcin dhe Mimoza Kusari-Lilën.

KRYETARI: I dëgjuat katër propozimet e Vetëvendosjes. Lista serbe, kë e propozon?

IGOR SIMIĆ: Hvala, predsedniče!

U ime Srpske liste predlažemo gospodina Adema Hodžu.

KRYETARI: Grupi Parlamentar Multietnik, kë e propozon? Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Deputeti Fridon Lala.

KRYETARI: Fridon Lala nga Grupi Multietnik.

Të nderuar deputetë,

I dëgjuat edhe propozimet se si të komponohet ky Komision Hetimor Parlamentar. Andaj, ju lus që me ngritje të dorës të përcaktoheni me votën tuaj për themelimin e këtij komisioni, sepse seanca formalisht duhet t'ia japë një legjitimitet punës së këtij komisioni. Propozimet i dëgjuat, votojmë tash.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Kanë votuar 93 deputetë dhe të gjithë e kanë dhënë votën për, themelimin e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar. Kështu që komisioni u themelua dhe mund ta vazhdojë punën e vet.

Tash dalim te pika tjetër:

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se kryetarja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, e mbështetur edhe nga 40 deputetë të tjerë, në bazë të nenit 77 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 71 të Rregullores së Kuvendit, si dhe nenit 4 të Ligjit për hetim parlamentar, ka propozuar formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë gjatë periudhës 2006-2022, në nivelin e legjislativit, ekzekutivit, rregullatorit dhe ndërmarrjes publike.

Meqenëse nuk i kemi kaluar këto procedurat të cilat i kemi kaluar te komisioni tjetër, po ia jap fjalën Mimoza Kusari-Lilës që prezantojë propozimin e themelimit të Komisionit Hetimor.

**MIMOZA KUSARI-LILA: Po, kryetar!**

Siç e dini ky propozim i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje ka ardhur si propozim për të zgjidhur ngërçin në të cilin kishim hyrë në raport me kërkesën fillestare të partive opozitare, në të cilën e kemi vlerësuar dhe ende qëndrojmë prapa atij vlerësimi që analiza e rrethanave në sektorin e energjisë nuk mund të bëhet në periudha afatshkurtra, por duhet shkuar prapa në kohë dhe analizuar procesin e vendimmarrjes. Gjegjesisht, çfarë dhe si erdhëm në situatën në të cilën mungesa e investimeve në sektorin e energjisë dhe procesi i vendimmarrjes deri tash, e ka sjell Kosovën të ballafaqohet me një krizë energjetike nga jashtë, por me kufizime të mëdha nga brenda.

Andaj, kërkesa jonë përveç disa pikave dhe objektivave kryesore që ka synuar t'i zbardhë dhe natyrisht t'i trajtojë me seriozitet në Komisionin Hetimor Parlamentar, gjithashtu ka të përfshira edhe pika të cilat i kishte të propozuar opozita. Rrjedhimisht, afati i kohor i këtij Komisioni Hetimor Parlamentar të jetë prej vitit 2006, kur kanë filluar vendimet përmbajtjesore për sektorin e energjisë në Kosovës, siç është shthurja e KEK-ut dhe ndarja e KOSTT-it dhe përfshirja e Kosovës në Sekretariatit e Energjisë, shto këtu pastaj që janë një mori vendimesh të tjera deri në janar, gjegjesisht në prill të vitit 2022.

Kjo kërkesë tashmë pas diskutimit që e kishim së bashku me juve kryetar, me anëtarët e Kryesisë së Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare, u dakordua që të procedohet paralelisht, edhe pse uroj që të mos ballafaqohemi me situatën kur do të ketë, qoftë ndeshje të agjendave apo edhe probleme të tjera që mund të shkaktohen në raport me trajtimin e temës.

Sidoqoftë, jemi të përkushtuar që deri në fund, me angazhim, transparencë dhe përkushtim të plotë, të prezantojmë një raport para kësaj legjislature dhe analiza jonë në Komisionin Hetimor Parlamentar të tregojë mirëfilli kush dhe pse janë shkaktarë të vërtetë të krizës aktuale në Kosovë.

Njëkohësisht, po besoj mbështetjen ashtu siç edhe e deklaruan brenda, do ta kenë edhe grupet e tjera parlamentare bashkë me edhe kryesimin e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar.

KRYETARI: Meqenëse ishte marrëveshje, të shkojmë drejtpërdrejt që t'i japin emrat grupet. Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes kë e propozon në këtë komisionin?

MIMOZA KUSARI-LILA: Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje në komision marrin pjesë: deputeti Armend Muja, deputeti Haki Abazi, deputeti Arbër Rexhaj dhe deputeti Halil Thaçi.

KRYETARI: Cili prej tyre do të jetë zëvendëskryesuesi? Duhet të na e thoni këtë.

MIMOZA KUSARI-LILA: Armend Muja është zëvendëskryesues.

KRYETARI: Armend Muja. Grupi Parlamentar i PDK-së kë e propozon? Kryesuesi i takon PDK-së.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike prej që është në Kuvend, nuk ka ndodhë asnjëherë që të votojë kundër themelimit të ndonjë Komisioni Hetimor. Edhe sot, ashtu siç u dakurduam, po edhe pa dakordim fare, ne do të votonim për, këtij Komisioni Hetimor, sepse mendoj që çdo hedhje dritë mbi çfarëdo procesi i kontribuon vetëm transparencës dhe proceseve të rëndësishme, sidomos në çështje të energjisë për të cilat kemi diskutuar tash e dy muaj radhazi.

Prandaj, në këtë Komision Hetimor, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike propozon për kryesues deputetin Hajdar Beqa dhe anëtar, deputetin Rashit Çalaj.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i LDK-së, kë e propozon për anëtar të këtij komisioni?

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Siç e kemi deklaruar edhe në seanca të tjera, Grupi Parlamentar i LDK-së është që të hetohet në aspektin historik ngjarjet që kanë ndodhur në sistemin energjetik të Kosovës.

Unë veç e pata një pyetje për kryetaren e Grupit të Vetëvendosjes se sapo na erdhi materiali, dhe pika që po e shoh këtu është: si dhe shqyrtimi i çështjeve të mëposhtme, referuar kërkesës së deputetëve të PDK-së, LDK-së, AAK-së e të tjerëve. A mbetet kjo apo hiqet? Si sqarim! Veç të deklarohet. Logjikisht, do duhej të hiqej, po është çështje...

KRYETARI: Na e thotë këtë përmes një deklaratë shëfja e grupit dhe atë e llogarisim si qëndrim të grupit parlamentar.

MIMOZA KUSARI-LILA: Kryetar!

Në fakt, unë e përmenda në fillim që ka ardhur atëherë kur kemi propozuar që të kemi një Komision Hetimor Parlamentar. Në situatën kur krijohen dy Komisione Hetimore Parlamentare, specifikat që ju i keni vendosur nuk mbesin në këtë komision, por mbesin çështjet e përgjithshme me afatet e njëjta kohore. Kjo, për arsye se kërkesa e opozitës është e specifikuar në situatën dhe në muajt, ndërsa e jona ka një spektër më të gjerë të hetimit.

KRYETARI: Po. Të dyja çështjet janë të ndara. Emrat, a na i thatë? Jo. Urdhëro!

ARBEN GASHI: Grupi Parlamentar i LDK-së e propozon deputetin Armend Zemaj për anëtar dhe deputeten Rrezarta Krasniqi për anëtare.

KRYETARI: Grupi i AAK-së, kë e propozon?

PAL LEKAJ: Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozon si anëtare të komisionit, Time Kadrijaj.

KRYETARI: Lista serbe, kë e propozon?

IGOR SIMIĆ: Srpska lista predlaže gospodina Ljubinka Karadžića.

KRYETARI: Edhe Grupi Multietnik kë e propozon? Kush prej jush i propozon emrat?

FRIDON LALA: Grupi Multietnik e propozon për anëtare deputeten Duda Balja.

KRYETARI: Duda Balje. Pra, i dëgjuat propozimet. Kjo do të jetë përbërja e komisionit nëse votohet.

Të nderuar deputetë,

Tash hyjmë në proces të votimit dhe ju lus që të votoni me ngritje të dorës për themelimin e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon? Kanë votuar 95 deputetë kanë votuar për këtë komision. Të gjitha votat kanë qenë për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Kështu që, konstatoj që Kuvendi e themeloi edhe këtë Komision Hetimor Parlamentar.

Përfundoi ky mocion të cilin e ngrita.

Tash vazhdojmë me çështje të cilat na mbeten prej seancës të cilën e kemi filluar paradite dhe kjo ishte çështja e votimit të 2 gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese.

### *3. Propozimi i dy (2) kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese*

Po i kthehemi edhe njëherë procedurës meqenëse... Bile-bile do të thosha që më e arsyeshme është që të kthehemi pikërisht në pikën e komisioni të votimit, aty ku e kemi lënë, sepse do t'i ftoja edhe grupet e tjera parlamentare që të bëhen pjesë e këtij komisioni të votimit për 2 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Fjalën e ka PDK-ja. Zoti Tahiri, kë e propozoni në komisionin e votimit?

ABELARD TAHIRI: Për kryetar të komisionit e propozoj deputetin Hajdar Beqa.

KRYETARI: Hajdari, veç kryetar a po?! Në rregull! Lidhja Demokratike kë e propozon?

ARBEN GASHI: Lidhja Demokratike e Kosovës për anëtar të Komisionit për Përzgjedhjen e 2 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, propozon deputeten Vlora Dumoshi. Faleminderit!

KRYETARI: Lista serbe, kë e propozon?

IGOR SIMIĆ: Predlažemo gospodina Zorana Mojsilović.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i AAK-së e ka bërë propozimin, Albana Bytyqi, më duket ishte. Grupi Multietnik e propozon deputeten Samra Iljaz.

Votojmë edhe njëherë për themelimin e këtij komisioni të votimit për 2 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Ky komision i ka marrë 95 vota për, komisioni i votimit, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Kështu që konstatoj që u themelua ky komision i votimit.

Prandaj, ftoj anëtarët e tij që t'i zënë vendet e tyre, sepse do të fillojmë shumë shpejt me procedurat e votimit të 2 gjyqtarëve.

Ju lutem që t'i zini vendet tuaja të nderuar anëtarë të komisioni të votimit!

Kurdo që jeni të gatshëm, të nderuar anëtarë të komisionit votues mund të fillojmë. Gjithçka është e gatshme. Faleminderit, të nderuar anëtarë këtij komisioni.



Atëherë, fillojmë: Kujtim Shala, Abelard Tahiri, Adelina Grainca, Adem Hoxha, Adnan Rrustemi, Adriana Matoshi, Agim Veliu, Agon Batusha, Alban Bajrami, Albana Bytyqi, Albena Reshitaj, Anton Quni, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Ardian Gola, Ardian Kastrati, Ariana Musliu-Shoshi, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza, Armend Muja, Armend Zemaj, Arta Bajralija, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Avni Dehari, Bahrim Shabani, Begjet Pacolli, Bekë Berisha, Bekim Arifi.

Bekim Haxhiu, Besian Mustafa, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Branislav Nikoliq, Burim Meta, Dimal Basha, Doarsa Kica-Xhelili, Dragan Antonijeviq, Drita Millaku, Driton Hyseni, Driton Selmanaj, Duda Balje, Ekrem Mustafa, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Eman Rrahmani, Enis Kervan, Enver Dugolli, Enver Haliti, Enver Hoxhaj, Erxhan Galushi, Fadil Gashi, Fatmir Humolli, Fatmire Kollçaku, Ferat Shala, Fidan Jilta, Fitim Haziri, Fitim Uka, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani, Floretë Zejnullahu, Fridon Lala, Gani Krasniqi, Ganimete Musliu, Gazmend Gjyshinca, Gramoz Agusholli, Hajdar Beqa, Haki Abazi, Halil Thaçi, Haxhi Avdyli, Hisen Berisha, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Isak Shabani,

Jahja Kokaj, Jasmina Dediq, Jeta Statovci, Jetmire Vrenezi, Kujtim Shala.

Kujtim Shala ka votuar faktikisht.

Labinotë Demi-Murtezi, Lubinko Karaxhiq, Luan Aliu, Lumir Abdixhiku, Marigona Geci, Mefail Bajqinovci, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Milazim Salihaj, Milijana Nikoliq, Milosh Peroviq, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Mirsad Shkreta, Njazi Isaku, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Rashit Qalaj, Rrezarta Krasniqi, Salih Zyba, Samra Iljaz, Saranda Bogujevci, Shemsedin Dreshaj, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Slavko Simiq, Time Kadrijaj, Tinka Kurti, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Vafije Blair, Vendenis Lahu, Verica Çeraniq, Visar Korenica, Vlora Dumoshi, Xhavit Haliti, Yllza Hoti dhe Zoran Mojsiloviq.

Thirrja e fundit për të gjithë ata që nuk kanë votuar që ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, sepse tash po e shpallim për pak mbylljen e procesit të votimit për dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Mbyllet procesi i votimit. E ftoj komisionin e votimit që të na i prezantojë rezultatet.

Ia japim fjalën deputetes Albana Bytyqi, në emër të komisionit të votimit për dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Të na e prezantojnë rezultatin e komisionit, ju lutem.

ALBANA BYTYQI: Vazhdojmë me rezultatin:

E pavlefshme,

Etrur Maloku, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Albertë Avdiu,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Aukagjin Avdyli, Albertë Avdiu,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Dukagjin Avdyli, Bardh Bokshi,  
Dukagjin Avdyli, Albertë Avdiu,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Etrur Maloku, Albertë Avdiu,

Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Dukagjin Avdyli, Albertë Avdiu,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Dukagjin Avdyli, Albertë Avdiu,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
E pavlefshme,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Etrur Maloku, Albertë Avdiu,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Dukagjin Avdyli, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
E pavlefshme,  
Etrur Maloku, Albertë Avdiu,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Dukagjin Avdyli, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,

Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku,  
Dukagjin Avdyli, Bardh Bokshi,  
Dukagjin Avdyli, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Dukagjin Avdyli, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi.

KRYETARI: Regjia, ju lutem, mos ia ndalni fjalën deputetes në foltore.

ALBANA BYTYQI:

Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
Etrur Maloku, Dukagjin Avdyli,  
E pavlefshme.

KRYETARI: Po, ia japim fjalën komisionit të votimit, sepse e kanë raportin përfundimtar.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për propozimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur sot konstaton që në votim kanë marrë pjesë 102 deputetë.

Të pavlefshme kanë qenë katër vota.

Kurse votat e fituara për kandidatët e propozuar janë:

1. Etrur Maloku ka fituar 47 vota,
2. Dukagjin Avdyli ka fituar 46,

3. Albert Avdiu ka fituar 49 dhe

4. Bardh Bokshi 49.

D.m.th. asnjëri nga kandidatët nuk i ka marrë votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të asaj që prezantoi kryetari, pra përsëritet votimi. Kandidati që ka më së paku vota nga katër kandidatët hiqet nga gara dhe vazhdojmë me rundin e dytë, në këtë rast z. Dukagjin Avdyli hiqet nga gara. Faleminderit!

**KRYETARI:** Përderisa materiali është duke ardhur për rundin tjerë, sepse në rundin e parë nuk arritëm që ta zgjedhim asnjërin prej gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por njëkohësisht konstatoam që kandidati Dukagjin Avdyli, i cili ka marrë më së paku vota largohet për rundin tjetër.

Tre të tjerët, tre kandidatët e tjerë të mbetur, të cilët kanë marrë më së shumti vota vazhdojnë. Dy prej tyre mund t'i zgjedhim prapë përmes votimit gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, materialet kanë ardhur.

E ftoj komisionin e votimit sërish që të kthehen te vendet e tyre, sepse tash po fillojmë me rundin e dytë:

Abelard Tahiri, Adelina Grainca, Adem Hoxha, Adnan Rrustemi, Adriana Matoshi, Agim Veliu, Kujtim Shala, Agon Batusha, Alban Bajrami, Albana Bytyqi, Albena Reshitaj, Anton Quni, Arben Gashi.

Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Ardian Gola.

Ardian Kastrati, Ariana Musliu-Shoshi, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza, Armend Muja, Armend Zemaj, Arta Bajralija, Artan Abrashi, Avdullah Hoti, Avni Dehari, Bahrim Shabani, Begjet Pacolli, Bekë Berisha, Bekim Arifi, Bekim Haxhiu, Besian Mustafa, Besim Muzaqi, Besnik Tahiri, Blerta Deliu-Kodra, Branislav Nikoliq, Burim Meta, Dimal Basha, Doarsa Kica-Xhelili, Dragan Antonijeviq, Drita Millaku, Driton Hyseni, Driton Selmanaj, Duda Balje, Ekrem Mustafa, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Eman Rrahmani, Enis Kervan, Enver Dugolli, Enver Haliti, Enver Hoxhaj, Erxhan Galushi, Fadil Gashi, Fatmir Humolli, Fatmire Kollçaku, Ferat Shala, Fidan Jilta, Fitim Haziri, Fitim Uka, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani.

Floretë Zejnullahu, Fridon Lala, Gani Krasniqi, Ganimete Musliu, Gazmend Gjyshinca, Gramoz Agusholli, Hajdar Beqa, Haki Abazi, Halil Thaçi, Haxhi Avdyli, Hisen Berisha, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Isak Shabani.

Jahja Kokaj, Jasmina Dediq, Jeta Statovci, Jetmire Vrenezi, Kujtim Shala, Labinotë Demi-Murtezi, Lubinko Karaxhiq, Luan Aliu, Lumir Abdixhiku, Marigona Geci, Mefail Bajqinovci, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Milazim Salihaj, Milijana Nikoliq, Milosh Peroviq, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Mirsad Shkreta, Njazi Isaku, Pal Lekaj, Ramush Haradinaj, Rashit Qalaj, Rrezarta Krasniqi, Salih Zyba, Samra Ijaz, Saranda Bogujevci, Shemsedin Dreshaj, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Slavko Simiq, Time Kadrijaj, Tinka Kurti, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Vasfije Blair, Vendenis Lahu, Verica Çeraniq, Visar Korenica, Vlora Dumoshi, Xhavit Haliti, Yllza Hoti dhe Zoran Mojsiloviq. Dhe, Glauk Konjufca.

Ua bëj me dije se kanë edhe pak kohë dhe po e shpallim të mbyllur procesin e votimit për këtë rund të dytë.

E shpallim të mbyllur procesin e votimit. E ftojmë komisionin e votimit që të na e paraqesë raportin me rezultate.

Ia japim fjalën Salih Zybës që të na i prezantojë rezultatet, të cilat i ka gjetur komisioni i votimit.

**SALIH ZYBA:** Po vazhdojmë me numërimin e votave. Kërkohej qetësia në nivel të jetë:

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Etrur Maloku,

Albertë Avdiu,

Albertë Avdiu,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Etrur Maloku,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Etrur Maloku,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu,

Etrur Maloku,

Etrur Maloku,

Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Bardh Bokshi, Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
E pavlefshme,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
E pavlefshme,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,

Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Albertë Avdiu, Bardh Bokshi,  
Etrur Maloku,  
Etrur Maloku,  
E fundit: Albertë Avdiu, Bardh Bokshi.



KRYETARI: Tash i llogaritim të gjitha votat dhe na e sjell raportin përfundimtar komisioni. Shohim nëse ndonjëri prej kandidatëve ka arritur që ta kalojë votimin dhe t'i prezantohet Presidentes, t'i propozohet si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

Ia japim fjalën deputetit Beqa që të na e prezantojë rezultatin e votimit të rundit të dytë.

HAJDAR BEQA: Faleminderit kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni votues pas procedurës së votimit të rundit të dytë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për propozimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese konstaton që në votim kanë marrë pjesë gjithsej 97 deputetë. Të pavlefshme kanë qenë dy vota, kurse votat e fituara për kandidatët janë, nëse më kishit lejuar Kryetar, se nuk është i kompletuar raporti. I di përmendësh, po veç t'i konfirmoj në bazë të letrës.

KRYETARI: Po lirisht konsultohuni me njëri-tjetrin.

HAJDAR BEQA: Na falni, por nuk ka qenë rezultati në raport.

Gjithsej kanë marrë pjesë 97 deputetë. Dy vota kanë qenë të pavlefshme.

1. Albert Avdiu ka marrë gjithsej 60 vota,
2. Bardh Bokshi ka marrë 52 vota dhe
3. Etrur Maloku 39 vota.

D.m.th. Komisioni konstaton që asnjëri nga kandidatët nuk i ka marrë votat e mjaftueshme për t'u zgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Përsëritet konkursi, po këtë e thotë edhe kryetari tashmë. Faleminderit!

KRYETARI: Pra, nevojiteshin 65 vota kësaj radhe, kurse kandidati më së shumti që mori ishte 60 vota, kështu që nuk zgjidhet asnjëri.

Në bazë të raportit të komisionit të votimit, pra konstatoj që asnjëri kandidat nuk i mori votat e nevojshme për t'u propozuar për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese, andaj përsëritet konkursi.

Kërkohet nga komisioni përkatës që t'i marrë veprimet e nevojshme për publikimin e thirrjes, ftesës pra, për propozimin e dy kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në pajtim me kushtet e parapara sipas ligjit.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

#### **4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës**

Ju lutem deputetë, vetëm edhe dy-tri pika po i kryejmë edhe po e përfundojmë seancën.

Së paku, ju lutem, ta trajtojmë edhe pagën minimale se është shumë e rëndësishme. Po nesër nuk ka pajtueshmëri, nuk ka konsensus për seancë. Ju lutem, 97 deputetë vetëm sapo votuan, ju lutem vetëm edhe 30 minuta. Qeveria i ka punët e veta, ju tuajat. Shumë e do ti ministrin e Financave, nuk po mundesh pa të hiç.

Të nderuar deputetë,

Komisioni FunkSIONAL për Ekonomi e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij bashkë me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar që amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Legjislacion ka vlerësuar që amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet nuk i cenojnë parimet bazë të legjislacionit të BE-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë dhe nuk i shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

E ftoj Komisionin funksional për Ekonomi, pra kryetarin e këtij komisioni, Ferat Shala që ta paraqesë raportin. Kryetarin e komisionit nuk e kemi këtu. Kush e prezanton? Jeta Statovci e prezanton raportin e komisionit, nënkryetarja. Fjala është e juaja znj. Statovci.

**JETA STATOVCI:** Ju faleminderit i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pra qëllimi i Projektligjit nr. 08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës është arritja e përputhshmërisë më të lartë në standardet dhe praktikatat e Bashkimit Evropian.

Ky projektligj kontribuon në përmbushjen e prioriteteve të reformave ekonomike dhe institucionale që burojnë nga dokumentet strategjike të vendit. Në mënyrë indirekte, projektligji ndihmon edhe në përmbushjen e veprimeve që ndërlidhen me sundimin e ligjit, zhvillimin e

afarizmit, luftën kundër informalitetit dhe mbrojtjen e tregut të lirë. Po ashtu miratimi i këtij Projektligji rrit efikasitetin e mbikëqyrjes së tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Komisionit e shqyrtoi këtë projektligj sipas procedurës, ku miratoi gjithsej 47 amendamente, andaj në bazë të raportit të vet amendamentues, i datës 26. 4. 2022, vendosi t'ia paraqesë Kuvendit këtë:

#### Rekomandim

Pra, i rekomandohet Kuvendit miratimi i Projektligjit nr. 08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës. Faleminderit!

KRYETARI: E dëgjuat pra nënkryetaren Statovci.

Tash i kemi 47 amendamente të këtij projektligji, mirëpo i kemi vetëm 57 deputetë në sallë. I bini ziles, ju lutem, të shohim a ka deputetë të mjaftueshëm dhe a ka kuorum.

PDK-ja dhe LDK-ja e lëshuan sallën më herët. Tash e lëshoi sallën edhe AAK-ja dhe Lista Serbe po më duket që është duke e lëshuar, kështu që nuk kemi konsideroj kuorum të mjaftueshëm. Vazhdojmë javën e ardhshme. Do ta caktoj një vazhdim të seancave me pikat të cilat na kanë mbetur pa u votuar, kështu që deri atëherë ju njoftojmë me kohë.

Mirupafshim!

\* \* \*

*E mërkurë, më 11 maj 2022*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 maj 2022*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kalojmë në pjesën e fundit të seancës. Në këtë pjesë e kemi:

#### **4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës**

Të nderua deputetë,

Ju njoftoj që diskutimet kanë përfunduar për këtë projektligj, por i kemi 47 amendamente.

Po i shqyrtojmë amendamentet, një nga një.

Amendamenti nr.1, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 2, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 3, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 4, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 5, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr.6, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 7, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 8, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 9, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 10, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 11, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 12, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 13, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti nr. 14, kundër s'ka, abstenim s'ka...

Bashkë me ata deputetët të cilët po qëndrojnë në fund të sallës, të cilët janë në këmbë. Vetëm 58 deputetë i kemi për momentin në sallë. I ftojme deputetët që të kthehen në sallë.

Ky është një projektligj për konkurrencën, kështu që është me rëndësi. Të gjitha këto i keni bërë së bashku si deputetë, propozime prej Komisionit FunkSIONAL, kështu që...

Atëherë, nuk po vijnë deputetët, nuk ka kuorum për të vazhduar kjo seancë. Shihemi të premten, në orën 11:00!

\* \* \*

*E premte, më 13 maj 2022*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 maj 2022*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Nëse ka mundësi të më tregoni se sa deputetë janë të pranishëm? 58 deputetë jemi, tash 59, 60...

Kemi mbetur te Projektligji për mbrojtjen e konkurrencës, më saktësisht kemi mbetur te amendamenti 14.

Këto amendamente me konsensus janë të propozuara prej vetë komisionit, aty pra ka pasur pajtueshmëri mes partive politike.

*(Ndërprerje incizimi)*

Mund të vazhdojmë me pikat, të cilat na kanë mbetur në gjysmë.

Kemi mbetur te Ligji për mbrojtjen e konkurrencës dhe amendamentet të cilat janë propozuar që të miratohen për këtë projektligj.

Kemi mbetur te amendamenti 14, këtu janë të gjitha të propozuara prej Komisionit Funkcional.

Amendamenti 14, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 15, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 16, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 17, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 18, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 19, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 20, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 21, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 22, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 23, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 24, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 25, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 26, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 27, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 28, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 29, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 30, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 31, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 32, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 33, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 34, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 35, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 36, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 37, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 38, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 39, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 40, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 41, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 42, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 43, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 44, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 45, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 46, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 47, kundër s'ka, abstenim s'ka, miratohet.

Sa u përket amendamenteve i konsideroj të miratuara përmes kësaj procedure.

Kurse tash do ta hedh në votim projektligjin, bashkë me këto amendamente të integruara.

Në seancë po marrin pjesë 68 deputetë.

Deputetë të nderuar,

Po ju lus që me ngritje të dorës të deklaroheni për projektligjin bashkë me amendamente, për Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Kush është për këtë projektligj?

Kush është kundër?

Kush abstenon?

Konstatoj që me 60 vota për, 2 vota kundër dhe asnjë abstenim, ka kaluar Projektligji për mbrojtjen e konkurrencës.

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funksional për Buxhet e ka shqyrtuar ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që e përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftojme ministrin e Financave, Hekuran Murati, që ta prezantojë këtë projektligj.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Para jush sot prezantojmë projektligjin, i cili parasheh të ndryshojë dhe të plotësojë disa prej ligjeve ekzistuese në mënyrë që të hapet rrugë që më në fund pas 11 vjetëve të ngritët paga minimale.

Projektligji në fjalë ka për qëllim që fillimisht të krijojë qartësi juridike për sa i përket shumës së beneficioneve apo kompensimeve, të cilat ndërlidhen me pagën minimale, pra parasheh eliminimin e çfarëdo ambiguiteti apo dykuptimësie, në mënyrë që të kemi siguri juridike të lëvizim tutje me pagën minimale.

Së dyti, projektligji parasheh edhe lirim nga tatimi për pjesën e pagës minimale deri në nivelin prej 250 euro parashihet që të rritet pragu tatimor me zero për qind pra që nuk tatohet.

Dhe së treti, ky projektligj e ndryshon dhe e plotëson procedurën se si vjen deri te paga minimale, në rastet kur mund të ketë edhe ngërçin në Këshillin Ekonomik Social, siç e kemi rastin tani, pra kur anëtarët e Këshillit Ekonomik Social nuk mund të dakordohen dhe të arrijnë konsensus, Ligji ose ndryshim-plotësimi i ligjit parasheh që kjo të mund të bëhet edhe me propozimin e ministrit të Financave, në mënyrë që të mos kemi raste kur paga minimale apo rritja e pagës minimale bllokohet nga ndonjëri prej parterëve socialë, kur në fakt nevoja është paga të rritet.

Pra, këto janë ndryshimet që parashihen me këtë projektligj dhe me miratimin e këtij projektligji hapet edhe rruga për ndryshimin e pagës minimale, siç e thashë në fillim.

Duke e konsideruar si një gjë shumë të rëndësishme për shumë prej atyre punëtorëve që punojnë në nivelin e kësaj page minimale, pra niveli aktual që është 130 euro për personat nën 35 vjeç dhe 170 euro për ata mbi 35 vjeç, tashmë është i tejkaluar dhe i vonuar dhe si Qeveri, pra të gjitha qeveritë e kaluara nuk është se kanë lëvizur tutje që nga viti 2011, ky është momenti i duhur, konsiderojmë, marrë parasysh edhe gjendjen e vështirësuar ekonomike të qytetarëve, edhe çmimet e rritura është më se e udhës që të votohet, të ecet para me këtë projektligj, në mënyrë që të hapet rruga për rritjen e pagës minimale.

Andaj, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji dhe rëndësinë e rritjes së pagës minimale për dhjetëra-mijëra familje që varen nga kjo page, ju ftoj që ta mbështesni. Faleminderit!

KRYETARI: E dëgjuat propozimin e Qeverisë.

Tash ia japim fjalën kryetarit të Komisionit për Buxhet, deputetit Armend Muja.



ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka trajtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale dhe të njëjtin, pasi e ka trajtuar me shumicë votash, ka vendosur që këtij Kuvendi t'i rekomandojë ta miratojnë.

I nderuar kryetar, a mund të vazhdoj edhe në emër të grupit parlamentar?

KRYETARI: Po, lirisht!

ARMEND MUJA: Lëvizja Vetëvendosje e mbështet edhe i rekomandon deputetët që ta miratojnë këtë ligj, për arsye sepse ky ligj i ka disa objektiva parësore që heq ngërçin tek procedura e vendosjes së pagës minimale.

Ky projektligj do të shërbejë për të rritur për një punëtor dhe me pagë të ulët në një nivel adekuat.

Projektligji synon eliminimin e mëdyshjeve ligjore rreth pagës minimale në nivel kombëtar, specifikisht lidhshmërinë e pagës minimale me nivelin e beneficioneve të tjera sociale. Ne mendojmë që paga minimale është instrument i tregut të punës dhe ai duhet të jetë në atë mënyrë.

Propozimi për përcaktimin e pagës minimale mbështetur në rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, rekomandimi 135 për kriteret e përcaktimit të pagës minimale.

Dhe pasi është ezauruar procesi konsultativ me partnerët socialë dhe mbështetet në këto kritere:

Paga minimale duhet të reflektojë nevojat bazë të punëtorëve.

Dy, niveli i përgjithshëm i pagave në vend.

Tre, kostoja e jetesës në vend.

Katër, standardi jetësor i grupeve shoqërore, dhe

Pesë, faktorët ekonomikë, përfshirë ndërlidhja e saj me përmirësimin e produktivitetit.

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Paga minimale në Kosovë nuk është ndryshuar që nga viti 2011, ajo ka mbetur kryesisht në nivelin e përcaktuar në vitin 2011 që unë besoj është 130 euro. Kjo edhe pse vendet e tjera në rajon kanë reflektuar dhe i kanë përditësuar ato vit pas viti.

Lëvizja Vetëvendosje e ka pasur premtim programor rritjen e pagës minimale dhe e njëjta po realizohet.

Rritja e pagës minimale dhe formalizimi i tregut të punës po ashtu trajtohen në kuadër të ligjit. Paga mesatare në sektorin privat vlerësohet të jetë 342 euro në vitin 2020 apo 34 euro më shumë se sa viti 2011.

Pra, pagat në sektorin privat për një dekadë janë rritë mesatarisht vetëm 34 euro. Rritja e pagës mesatare nuk përkon as me rritjen e produktivitetit dhe shkallës së inflacionit në dekadën e fundit.

Nga ky ligj ose rritja e pagës minimale i synon rreth 120 mijë përfitues të drejtpërdrejtë, apo rreth 32% të punëtorëve të regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës. Këto grupe shoqërore që përfitojnë më së shumti gjenden në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë 32 mijë përfitues, në industrinë përpunuese 18 mijë përfitues, në gastronomi 13 mijë përfitues, në ndërtimtari 10 mijë përfitues dhe në aktivitetet e sigurimit fizik 12 mijë përfitues. Shumica e tyre janë të moshë së re 16-24 vjeç dhe në kuadër të kësaj moshe kryesisht femra.

Po ashtu përfitues janë edhe shtresat e tjera përtej moshës, po që përfitojnë më pak ose shuma joadekuate.

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Studimet krahasimtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës tregojnë se në shumicë e vendeve të zhvilluara rroga minimale është rreth 60% e rrogës mediale, ky është edhe rekomandim i Komisionit Evropian.

Paga minimale prej 264 euro është sa rreth 66% e rrogës mediale në Kosovë dhe mendoj që përkon po ashtu edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian. Pra, duhet të jetë një moment kur të sigurohet një baraspeshë e shëndetshme ndërmjet rritjes së adekuatshmërisë dhe parandalimit të efekteve negative në tregun e punës.

Kjo rritje e pagës minimale po ashtu vjen në një kohë kur globi dhe Kosova po afektohen nga rritja e çmimeve. Gjithashtu kjo rritje do të mundësojë edhe zvogëlimin e mëtejshëm të varfërisë si tek shtresa drejtpërdrejt që fitojnë, po ashtu edhe tek anëtarët e tjerë të familjes që varen nga këta punëtorë.

I nderuar kryetar,

Për ta përmbyllur, Lëvizja Vetëvendosje i rekomandon fuqishëm këtij Kuvendi që për hir të këtyre punëtorëve të drejtpërdrejtë, po, për hir edhe të ngërçit 10-vjeçar, për shkak të eliminimit të barrierave në procedure, të miratohet ky ligj, në mënyrë që edhe punëtorëve të sektorit privat t'u sigurohet një afatshmëri dhe një proces i qartë i përcaktimit të rrogës minimale në Kosovë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti Muja!

Tash e kanë radhën grupet parlamentare. Ia japim fjalën Grupit Parlamentar në radhë PDK-së, është Mërgim Lushtaku në emër të grupit.

**MËRGIM LUSHTAKU:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar, dy ministra që prezantojnë sot këtu,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore.

Ne këtë projektligj nuk do ta votojmë për shkak se shkel rregullat e përcaktimit të pagës minimale dhe bën ndryshimet me një numër të ligjesh, përmes të cilave goditin pjesën më të ndjeshme të shoqërisë tone, personat me aftësi të kufizuar dhe veteranët e luftës.

Ndryshohet Ligji i punës për interesat e Qeverisë si dhe ndryshohet Ligji për tatimin e pagës pa u analizuar mirë një projektligj i tillë për politikën tatimore.

Gjithsesi ju si Vetëvendosje dhe Qeveria Kurti e dimë shumë mirë që kanë harruar shumë me marrjen e karriges së pushtetit dhe një ndër çështjet që kanë harruar po shihet qartë që e kanë harruar dialogun social. Fatkeqësisht edhe në këtë pjesë të projektligjit që synon rritjen e pagës minimale, që në esencë e mbështesim rritjen e pagës minimale, por atë duke bërë me një dialog social, siç është përcaktuar edhe me Ligjin e pagave.

E dimë shumë mirë që me Ligjin e punës, me nenin 57 përcaktohet se duhet të konsultohet dhe të përcaktohet me Këshillin Ekonomiko Social që partner në atë këshill është edhe vetë Qeveria, por janë edhe sindikatat e odat ekonomike.

Një gjë që po mundohet të bëjë Lëvizja Vetëvendosje është që të synojë rritjen sado të vogël të pagës minimale dhe të arrijë një target para elektoratit të vet që gjoja paska rritur një pagë minimale qysh është prezantuar më herët në publikimet e tyre në medime publike.

Edhe në këtë drejtim nuk e arrin dot që të ketë një konsultim të mjaftueshëm dhe të arrijë që me të vërtetë ajo pagë minimale të jetë konform rritjes së lartë të çmimeve çdo ditë, rritjes enorme të çmimeve esenciale dhe e dimë shumë mirë që fatkeqësisht Qeveria po mundohet të tejkalojë çdo dialog social me këtë ligj që po e mbërrin me një arrogancë të madhe të numrave që i ka në këtë Parlament.

Gjithsesi, siç e thashë edhe më herët, e dimë shumë mirë që kryeministri Kurti ka premtuar që paga minimale të jetë jo më e vogël se 350 euro në fushatën e 2019-së dhe ne e kemi parë që në këtë propozim që do të vijë pas miratimit të këtij projektligji, do të jetë paga 250 euro, që është një shkelje tjetër e premtimit të tij si lider i Vetëvendosjes.

Po gjithashtu po mundohen që ato kategori që janë më të ndjeshme të shoqërisë tonë që kanë kontribut të veçantë në shtetndërtimin e Kosovës, por që kanë edhe vështirësi të njëjtën kohë për t'i përballuar sfidat e jetës, sidomos në rritjen e lartë të çmimeve, po shkelen dhe po degradohen duke i larguar ata me këtë ligj edhe në rritjen e pagës apo të hyrave të tyre, siç është rasti me veteranët e luftës, me të verbëritë, me tetrapelegjikët dhe paraplegjikët. Ne si parti politike, Partia Demokratike e Kosovës, e shohim që po u bëhet një dëm shumë i madh këtyre familjeve, sigurisht që në këtë pjesë ne si parti nuk do të votojmë dhe do të jemi kundër. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash radha e LDK-së, qëndrimin e paraqet deputeti Avdullah Hoti.

**AVDULLAH HOTI:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Vlerësoj, një koment i përgjithshëm, ndoshta ky është ndër ligjet më komplekse, po për mënyrën se si është shkruar, si është prezantuar ndoshta është ndër ligjet më të pakuptimta, më absurde, në fakt, sepse nenet si janë shkruar dhe qëllimin që tentojnë të arrijnë këto nene është kundër vetë parimit bazë të vendosjes së pagës minimale dhe do të mundohem të argumentoj pse e vlerësoj kështu.

Paga minimale vendoset për të ruajtur standardin minimal të jetës të një kategorie të qytetarëve, kush janë ata? Janë të punësuarit në sektorin publik dhe privat që marrin pagë të ulët, pra pagë të vogël ose nën pagën minimale dhe janë kategoritë e ndryshme sociale, pensionale, kategori të caktuara të shoqërisë që i lidh me pagën minimale, pra të ardhurat e tyre, pensione të ndryshme, ndihma sociale, mbështetje të caktuar lidhen me pagën minimale, kjo është praktikë ndërkombëtare për të ruajtur standardin e jetës të disa kategorive të qytetarëve. Dhe ju, në fakt, mënyrën se si e keni shkruar këtë ligj, ju nuk e arrini atë qëllim, ju targetoni vetëm një pjesë të vogël të shoqërisë që ndikohen nga ky ligj që janë të punësuarit

në sektorin privat që mund të marrin pagë më të ulët se sa 250 euro. Pra, nuk arrihet qëllimi përmes këtij ligji, qëllimi i barazisë sociale.

E para, ky ligj nuk siguron që hiqet diskrecioni politik në përcaktimin e pagës minimale, sepse ka një arsye madhore pse është e nevojshme që të, jo vetëm të konsumohet diskutimi publik me partnerët socialë për pagën minimale dhe për çështje të tilla, po të arrihet një dakordim, të arrihet gjuha e përbashkët, të zhvillohen negociatat, ndoshta kjo ka qenë arsye që me vite të tëra janë zhvilluar negociata, por nuk ka pasur dakordim në Këshillin Ekonomik Social për të përcaktuar pagën e re sociale. A ka qenë gabim, sigurisht që ka qenë gabim që s'është mbërritur deri në atë pikë. Po ne nuk mund të themi asnjëherë që i kemi konsumuar diskutimet e tilla dhe si rezultat po lëvizim përpara pa Këshillin Ekonomik Social.

Nuk mundemi ne nëse, po mendoj Qeveria nëse nuk ka dakordim me partnerët socialë të lëvizë përpara me pagë minimale. Nuk mundet Qeveria të lëvizë përpara me legjislacion tjetër që prekin bizneset, ta zëmë, pa një konsultim, pa një dakordim parimor me komunitetin e biznesit. Nuk mundet, ta zëmë, në fushën e mediave nëse nuk ka gjuhë të përbashkët nëpërkëmben e të fyhen mediat, këta janë partnerë socialë, shoqërorë, me të cilët Qeveria domosdo do të komunikojë dhe do t'i bëjë pjesë të aranzhimeve ligjore dhe vendimmarrjes së saj. Në fund, vendimi është i Qeverisë dhe është i këtij Kuvendi, po në një sistem demokratik kërkohet jo vetëm zhvillimi, konsultimi sa për të thënë që i zhvilluam, por arritja e dakordimit, jo betonim në pozicionet e caktuara, thuhet që e kemi konsumuar këtë proces.

E dyta, tek neni 2, pika 3.1, hiqet lidhja e pagës minimale me përfitimet që i marrin veteranët e luftës. Ka pasur, siç e thashë më herët, ka pasur një arsye madhore pse janë lidhur këto të dyja, sepse ligji ka thënë që një veteran i luftës nëse merr pensionin e veteranit të luftës, nuk mund të punojë, nuk mund të krijojë të ardhura. Pensioni i veteranit të luftës është burim i të ardhurave, nuk është si shpërblim për sakrificën që ata njerëz kanë bërë në luftë, po i kemi definuar me ligj si burim i të ardhurave dhe rrjedhimisht është lidhur me pagën minimale, prandaj nuk mund të shkëputet kjo çështje. Nuk mund të thuash unë e rriti pagën minimale, po ju mbeteni aty ku keni qenë me 170 euro, sepse ata janë e njëjta kategori, sikur një i punësuar në sektorin privat që merr 170 euro, tash po do t'ia bësh 250 së paku, është e njëjta gjë për të, është burim i të ardhurave për veteranin e luftës, është burim i të ardhurave për një person që punon në sektorin privat.

E njëjta logjikë edhe në nenin 3, kur shkëputet lidhja tash e pagës minimale me kompensimet për personat e verbër ose për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Besoni që nuk ka asnjë kuptim, ndoshta do të kishte pasur kuptim sikur ju më herët të kishit lëvizur me pensionet e veteranëve, me pensionet e personave paraplegjikë e tetraplegjikë, e me pensionet e personave të verbër, të kishit lëvizur nja 200-300 euro, do të kishte pasur logjikë tash të themi të heqim

këtë lidhje, po në bazament arsyeja kryesore ka qenë që t'i lidhim këto pensione me pagën minimale në mënyrë që të sigurojmë atë standardin minimal të jetesës së kësaj kategorie.

Tek neni 6, te shkalla e tatimit. Unë kam pasur diskutime të gjëra me ministrin e Financave edhe në diskutimin e këtij projektligji në Komisionin për Buxhet, drejt të them, unë e njoh këtë ministër, sepse e kam pasur bashkëpunëtor në Ministrinë e Financave dhe unë e di që ky di më mirë se sa kaq, di më mirë se sa kaq t'i ndërrojë normat tatimore, cilat norma? Ishin 6, tash krejt çka u ndihmojmë të punësuarve është 6,8 euro më pak tatim në muaj. Kaq! Krejt këto politika fiskale, me këto ndryshime të normave tatimore, ky është ndikimi: 6,8 euro në muaj i ndihmojmë këta persona dhe pastaj, sikur ata që e kanë pagën 250 euro, sikur ata që e kanë pagën 1000 euro, i lirojmë me 6,8 euro në muaj, njësoj i trajtojmë, pra. Ky ndryshim i shkallëve të tatimit nuk është signifikant, nuk prodhon asnjë efekt nesër. Absolutisht, është aq i vogël, saqë nuk ka ndikim fare në standardin e jetës dhe në efektin që po dëshiron të arrihet me këtë ligj.

Çështja më kryesore është te paga minimale, në nenin 6, pra ndryshohet neni 57 i Ligjit të punës. Këtu është besoj problemi kryesor, sepse tash me këtë plotësim-ndryshim Qeveria ka diskrecion të plotë në ndryshimin e pagës minimale. Çka nënkupton kjo? Kjo nënkupton që më nuk kemi nevojë për Këshillin Ekonomik Social, sepse atëherë diskutimin me Këshillin Ekonomik Social janë vetëm proforma, nuk kemi çka të merremi me ta. E për ta kamufluar këtë çështje, në memorandumun shpjegues të këtij ligji citohen konventat e ILO-s, edhe pse ne nuk jemi anëtar, po citohen gabim. Konventa e vitit 1970, nr. C-131, e bën të qartë në nenin 4, thotë: "Full consultation", domethënë konsultime të plota me përfaqësuesit e organizatave që përfaqësojnë punëdhënësit dhe punëtorët. Nuk mund të tejkalohet.

E mandej, këta e devijojnë pak këtë çështje dhe i referohen një lloj rekomandimi tash, jo konventë, një lloj rekomandimi dhe kjo rekomandim i vitit 1970, nr. 135, ku tentojnë që ta interpretojnë ndryshe kush është autoriteti kompetent për pagën minimale. Autoritet kompetent për pagën minimale është Këshilli Ekonomik Social, pikë. Dhe, mandej Qeveria e bart më tutje, e formalizon atë vendim, por nuk mundet Qeveria të ketë diskrecion të plotë në këtë çështje, sepse pavarësisht këtyre konventave dhe rekomandimeve të ILO-s, Ligji i punës që është në fuqi, në nenin 3 e bën të qartë mënyrën se si përcaktohet, çka është paga minimale dhe si përcaktohet paga minimale. Këtu askund nuk thuhet që Qeveria ka diskrecion në përcaktimin e pagës minimale përtej dakordimit që bëhet me Këshillin Ekonomik Social.

Mendoj që është gabim të shkojë ky ligj kështu përpara. Ligji, ose duhet të tërhiqet, ose të ulemi me shumë seriozitet në Komisionin për Buxhet, në mënyrë që të bëjmë amendamente, për të mos prishur një strukturë funksionale, sado e vjetruar që është, një strukturë funksionale e funksionimit të përgjithshëm të rrjetit të mbrojtjes sociale në Kosovë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kush e do fjalën në emër të AAK-së? Deputeti Bekë Berisha.

BEKË BERISHA: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Unë do të ndaj një pjesë nga ky propozim që do të flas sot. Do të thotë, është neni 18, lartësia e shumës së pensioneve, ku thotë: "... e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë". Ligji aktual për trajtimin e temës së pagës minimale e ka specifikuar se pensioni i veteranëve të luftës së UÇK-së duhet të jetë i barasvlefshëm me pagën minimale. Pastaj, e kemi propozimin këtu, ku ndër të tjera thotë "deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranëve, e të tjera...". Do të thotë, veç veteranët i ndan, e pensionet e tjera rriten.

Projektligji që e keni sjellë ju parasheh që të largojë veteranët nga rritja e pensionit të tyre. Do të thotë, "përveç veteranëve...", s'ka "përveç veteranëve...", domethënë ata më së pari. Veteranët, siç u tha edhe këtu, pensionin nuk e kanë si shpërblim, ashtu siç e kanë vendet e tjera, por e kanë burim të ekzistencës dhe në qoftë se e marrin këtë pension, nuk mund të punojnë diku tjetër, që edhe kjo është diskriminim. Është dashur që bile të kenë të drejtë ta marrin pagën, pensionin, po edhe të marrin qysh e marrin këta të tjerët, domethënë i barasvlefshëm me pagën minimale.

Ne e shohim këtë qasje si diskriminuese ndaj kësaj kategorie, të nderuar të vendit, të cilët dhanë edhe gjymtyrët për lirinë e vendit. Andaj, kërkojmë që ky nen diskriminues i propozuar nga ju të largohet, në mënyrë që pensionet e tyre të jenë në vijë me pagën minimale, ashtu siç është e paraparë me ligj.

Në rast se ka ndonjë çështje kundër tyre, atëherë janë gjykatat, le të vazhdojnë sa herë të duan le t'i hetojnë ato. Këtu në Kuvend kjo kategori duhet të respektohet dhe të trajtohen me dinjitet, të mos i diskriminojmë. Përndryshe, ne jemi kundër këtij projektligji, do të thotë nuk do ta votojmë derisa të ndryshohet. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë! Këto ishin qëndrimet e grupeve parlamentare, vazhdojmë sipas radhës me të cilën janë paraqitur deputetët. Prej Lëvizjes Vetëvendosje fjalën e ka Armend Muja.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar, disa sqarime.

E para është, shpeshherë në këtë ndërlidhjen e pagës minimale me Ligjin e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka disa paqartësi. Unë e kam vërejtur, edhe në komision, po edhe në Kuvend, si duket është harruar një plotësim-ndryshim i datës 30.12.2016, neni 18, ku është shkoqitur lidhja ndërmjet pagës minimale dhe kompensimit të veteranëve dhe kjo ka ndodhur natën e Vitit të Ri të vitit 2016, ku me sa unë e kujtoj ministër i Financave ka qenë pikërisht zoti Hoti dhe e ka marrë përkrahjen e shumicës së votave të deputetëve të PDK-së. Pra, kjo ka ndodhur në vitin 2016. Është mirë t'u sqarohet.

E dyta, aty parashihet, në plotësim-ndryshim, parashihet që veteranët të fitojnë edhe nga 120 euro, jo 170, po nga 120 euro. E vërtetë është, që një pjesë parashihet që të fitojnë më shumë, por

një pjesë e konsiderueshme është paraparë edhe zvogëlim i pagesave të tyre. Kjo ka qenë në nenin 16.

E treta, në bazë të atij plotësim-ndryshimi është vendosur në nenin 6, që shuma e shpenzimeve të tërësishme për veteranët duhet të jetë 0,7% e bruto prodhimit vendor dhe në rast se tejkalohet kjo, ato duhet të reduktohen, pagesat për veteranët duhet të reduktohen në mënyrë proporcionale, pra 50 milionë euro ka qenë tavani, në ndërkohë që ne aktualisht shpenzojmë shumë më shumë se atë.

Tjetra, sa i përket pagës minimale. Unë e pashë, në vitin 2019 ka pasur një debat dhe ky Kuvend e ka pas thirrur një interpelancë, në atë kohë ka qenë AAK-ja në Qeveri, kryeministër zoti Haradinaj, po në qeverisje kanë qenë po ashtu edhe PDK-ja. Paga minimale është paraparë të rritej 239 euro, mirëpo nuk është rritur asnjëherë. Nuk është rritur asnjëherë. Qëndrimi real i LDK-së në atë kohë shfaqet përmes deputetes Bajrami, që thotë se nuk bën të rritet, për arsye sepse ka implikime buxhetore të veteranëve. Krejt çfarë po dëgjoj sot unë këtu, është një kundërtënie, është një ngërç dhjetëvjeçar. Në emër të pagesave të veteranëve, nuk është rritur as paga minimale.

Tjetra është, të gjitha partitë politike, në rast se vërtet kanë menduar për veteranët, i kanë pasur dhjetë vjet kohë kur kanë qeverisur për këtë çështje. Po, më lejo, zoti kryetar i Kuvendit, ta përkujtoj që është një rast i Gjykatës Kushtetuese, të cilin rast, sa unë e kujtoj, në bazë të Gjykatës Kushtetuese keni qenë ju që e keni deponuar, kundër plotësim-ndryshimit të nenit 18, në vitin 2016. Mjerisht, Gjykata Kushtetuese e ka shpallur që kjo shkoqitje nuk ka qenë, siç e dini nuk ka qenë në ndeshje me ligjin, megjithatë duhet bërë kategorizimi i veteranëve.

Ne e kuptojmë që shpenzimet për veteranë edhe për shumë shtresa shoqërore nuk janë të mjaftueshme. E dimë këtë dhe jemi të vetëdijshëm. Çdo ditë është duke u punuar që ata të kenë një standard më të madh, por e rëndësishme është që të sqarohen disa gjëra, pra çka po tentohet të sqarohet këtu, ose arsyeja pse nuk po jepet mbështetja, është diçka që të gjithë e kanë bërë paraprakisht dhe i kanë pasur njëqind mundësi që ta ndryshojnë, nuk e kanë bërë.

Andaj, duhet ta rrisim pagën minimale. Paga minimale është thjesht instrument i tregut të punës. Ka edhe pagesa të tjera sociale, si pensionet, të cilat asnjëherë nuk kanë qenë të lidhura me pagën minimale. Pra, paga minimale mbetet një instrument i tregut të punës, kurse vlerësime të veçanta për nevojat të grupeve shoqërore bëhen në kuadër të asistencës sociale.

**KRYETARI:** Nga radhët e PDK-së ia japim fjalën Mërgim Lushtakut.

**MËRGIM LUSHTAKU:** Një replikë e shkurtër, i nderuar kryetar!

Këtë debat e kemi pasur edhe me Armendin, e kemi pasur edhe në komision.



Sigurisht, që në atë kohë unë nuk e kam pasur informatën dhe jam pajisur edhe me informata më bazike.

Është e vërtetë që në Ligjin për veteranë të UÇK-së parashihet edhe pjesa e kategorizimit, që është e vërtetë. Por, derisa nuk është bërë kategorizimi i veteranëve, atëherë ligji bazik është në fuqi, që është Ligji për paga minimale. Në këtë drejtim ne e kemi mbështetur dhe ne jemi për ndryshimin e ligjit, nëse rritet edhe paga minimale edhe e veteranëve, edhe e të gjithë atyre kategorive që janë të ndjeshme sociale, por sigurisht që kur të bëhet kategorizimi i të gjithë veteranëve të luftës, atëherë mund të largohet ndërlidhja me Ligjin e pagës minimale.

Po mundohet të krijojë një komoditet, që gjoja ne kemi qenë për largimin e kësaj page minimale dhe largimin e veteranëve të UÇK-së në këtë drejtim, por është e kundërta. Ne kemi dashur që ta bëjmë kategorizimin e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe derisa të bëhet ajo gjë, ne sigurisht se kemi siguruar që të zbatohet Ligji i pagës minimale për veteranë, derisa të përfundojë ky proces dhe jo e kundërta.

**KRYETARI:** Tash vazhdojmë me Lidhjen Demokratike, deputeti Driton Selmanaj.

**DRITON SELMANAJ:** Faleminderit, kryetar!

Shumë të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, unë e kam kundërshtuar disa herë edhe në të kaluarën praktikën që me një ligj të ndryshohen shumë ligje. Me shpresë që iniciativa të tilla të mbeteshin të izoluara si raste, tash po e shoh që kjo është dukuri e kësaj Qeverie. Domethënë, këta nuk e kanë në plan të ndalen me këtë formë të deformuar të ligjbërjes.

Mendoj se kjo vështirëson seriozisht qasjen në ligjet që i bëjmë ne dhe nuk i bëjmë për vete këto ligje, po i bëjmë për njerëzit që jetojnë në Kosovë. Duhet ta thjeshtojmë sa më shumë dhe sa më lehtë, që njerëzit kur kanë interes të kuptojnë një të drejtë të tyre, ta lexojnë në ligjin përkatës, jo në ligje të shpërndara, kështu siç, për fat të keq, është bërë dukuri e kësaj Qeverie.

Ju lus edhe një herë, që ta ndalni këtë praktikë, sepse me këtë ligj ndërrohen pesë ligje sot. Kanë mundur të sillen ligje të veçanta, të bëhen amendamente, të ndryshohen, dhe... Por, jo kështu me një ligj të vetëm të ndryshohen 5-6 ligje, ose 15 ligje. E di që nuk je i kësaj fushe dhe nuk e kupton, ministër, por po të sugjeroj.

Tani, çështja tjetër që dua të ngre është kjo. Secila shoqëri, i nderuar kryetar, ndërtohet mbi disa vlera të saj. Vlera më sublime e një shoqërie është, se si të vlerësojë ata që kanë kontribuar më së shumti për vendin e tyre dhe këta janë veteranët. Në secilën shoqëri, kur të përmenden veteranët, të gjithë çohen në këmbë, madje-madje ftohen në secilën situatë të rëndësishme shtetërore, me respektin maksimal për sakrificën që kanë bërë për vendin.

Dhe, çka ndodh tash tek ne? Kjo është e vërtetë, që procesi i selektimit të veteranëve nuk ka shkuar siç duhet. Dikush duhet të marrë përgjegjësi për këtë dhe duhet adresuar kjo si problematikë, por asnjëherë nuk guxon të vlejë parimi, ose të them fjalën e urtë popullore që, “afër drurit të thatë nuk guxon të digjet edhe i njomi”, sepse kjo kategori meriton respektin maksimal të shoqërisë sonë.

Dhe, çfarë bën kjo qeveri? Veteranët e luftës i heq nga rritja e pensionit të tyre, si rezultat i rritjes së pagës minimale. Pati një tendencë për të mashtruar opinionin, për të thënë se kjo ka ndodhur në ndryshimin e fundit të ligjit, por jo, jo, në ndryshimet e fundit. Referohen në ligjin bazik derisa të përfundojë kategorizimi. 3.1-shi, neni 16, 3.1 thotë decidivisht, sepse kam përshtypjen që duhet ta lexoj, “deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranit luftëtarë të UÇK-së skema pensionale zbatohet si është paraparë në ligjin bazik”. E në ligjin bazik pensioni i veteranit lidhet me pagën minimale domosdoshmërisht.

Unë kam bindjen që edhe kur e kemi bërë atëherë ka qenë një gabim, se ne e kemi mohuar të drejtën që ata të punojnë. Kam bindjen që ata këtë pension duhet ta marrin si shpërblim nga shteti për kontributin që kanë dhënë për lirinë e Kosovës, por jo ta kenë mjet ekzistencë, jo ta kenë burim kryesor të të ardhurave. Ndërkohë, ne ua kemi pamundësuar që ata të punojnë. Ne duhet t’i vlerësojmë ata dhe si vlerësim duhet ta bëjmë pensionin e tyre. Në vend se ta avancojmë tashmë e të shohim mundësinë, se si t’ua lejojmë atyre, edhe të punojnë, edhe ta marrin këtë pensionin suplementar, ne çfarë po u themi: “Jo, jo, as me rritjen e pagës minimale juve s’u lejojmë!”

Po them, për shkak të abuzimit eventual që është bërë me ato lista dhe që duhet proces i veçantë të jetë për t’i pastruar ato lista, të mos e fyejmë këtë kategori për të cilën ne, duhet ta dimë të gjithë, duhet të përulemi para tyre në çdo situatë. Po flas për veteranët e vërtetë që kanë bërë për këtë vend.

Dhe, nga ana tjetër, ne po i lëmë veteranët të diskriminuar, e tani po merremi edhe me dy kategori të tjera, që janë shumë të ndjeshme në shoqëri: të verbrit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët. Edhe këta pensionet e tyre i kanë pasur, jo drejtpërdrejt, por në mënyrë indirekte të lidhur me pagën minimale dhe këta tash po i përjashtojmë. Atëherë, cili është efekti i rritjes së pagës minimale në Kosovë, nëse veteranëve nuk ua lejojmë të rriten pensionet, të verbërve jo, paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve jo, atëherë çfarë rritje po bëni? A po e bëni për t’ia plotësuar narracionit fiktiv për të mashtruar njerëzit, siç keni bërë për shumë tema, apo vërtet doni ta përmirësoni jetën e njerëzve në Kosovë?

Ne s’mund të jemi pjesë e një narracioni fiktiv mashtrues, po s’mundemi! Nëse vërtet doni ta rrisni pagën minimale dhe vërtet qëllimi i rritjes së pagës minimale është rritja e mirëqenies së kategorive të ndjeshme në shoqëri, na keni për. Madje, jo 250, ne kemi thënë edhe më shumë,

por OK vlerësimi është që kapacitetet financiare të shtetit nuk janë më shumë. Por, cili është efekti nëse ne të verbrit, paraplegjikët, tetraplegjikët dhe veteranët, si kategori shumë e rëndësishme për shoqërinë, ua mohojmë të drejtën për t'ua rritur pensionet, atëherë çfarë page minimale ke rritur.

Kjo nuk mund të kuptohet ndryshe, përpos përpjekje për mashtrim. Ne jemi dhe do ta votojmë këtë projektligj, nëse këto kategori nuk përjashtohen. Nëse këto kategori mbeten siç kanë qenë dhe referenca e pensionit të tyre do të jetë me pagën minimale, atëherë e keni votën tonë.

Po ju them edhe një herë, si shoqëri i kemi humbur shumë vlera dhe mos harroni edhe një gjë. Për herë të parë në historinë e shqiptarëve të Kosovës po flasim për veteranë. Kurrë kategorinë e veteranëve Kosova s'e ka pasur. Kanë flijuar jetë njerëzit, kanë flijuar organizime të caktuara për Liri, me shekuj e shekuj, kurrë kjo shoqëri nuk ka qenë në gjendje të ulet e të thonë "Hajde të bisedojmë për kategorinë e veteranëve, eventualisht nëse mund të meritojnë një respekt". Për herë të parë në historinë e Kosovës kemi shansin që njerëzit që kanë bërë për këtë vend t'i vlerësojmë dhe ne në momentin kur kemi mundësi, i fyejmë, e deformatojmë, i shantazhojmë, nuk i vlerësojmë.

Po them edhe një herë, ta trajtojmë seriozisht jo vetëm këtë kategori, jo vetëm veteranët e luftës, të cilët meritojnë respekt dhe po them, shoqëritë e tjera çohen në këmbë për ta dhe ne, për shkak se dikush ka abuzuar me këtë listë, tani po dëshirojmë që edhe veteranin e vërtetë të mos e lejojmë të vlerësohet. Kjo është e papranueshme. Absolutisht, e papranueshme!

Ju ftojme, ministër, që këtë projektligj ta tërhiqni. Këto kategori të mos i përjashtoni, por t'i lidhni me pensionin dhe me pagën minimale dhe pensionet e tyre të jenë të dinjitetshme dhe duke menduar madje edhe për lehtësi të tjera, për veteranët sidomos, që ata edhe të punojnë. Sepse, edhe nëse ua bëjmë 250 euro pensionin, për ta është e pamjaftueshme, nëse vazhdon ritmi, ose rregulli, që ata të mos punojnë, 250 euro në Kosovë një veteran nuk mund të jetojë e lëre më me 170, çfarë e ka sot. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash është radha e AAK-së, deputetja Time Kadrijaj.

**TIME KADRIJAJ:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit.

Ne si Aleancë kemi këmbëngulur dhe kemi kërkuar që paga minimale të rritet dhe një ndryshim i tillë të silllet në Kuvendin e Kosovës, sepse me rritjen e çmimeve, rritjen e çmimit të energjisë elektrike, rritjen e derivateve me pagë minimale aktuale është zor të mbijetojnë të gjitha kategoritë në Kosovë.

Ne kemi menduar që do të jetë dhe do të përfshihen të gjitha kategoritë, mirëpo po shohim që po vazhdoni të bëni diskriminim për kategoritë që janë më të vlefshmet të shoqërisë sonë.

Mospërfshirja e veteranëve në rritjen e pagës minimale, mospërfshirja e kategorisë së të verbërve, mospërfshirja e kategorive të tetraplegjikëve dhe paraplegjikëve, është një diskriminim total dhe unë nuk mund ta kuptoj qasjen e kësaj Qeverie. Si mund të eliminohen këto kategori. Edhe ata janë njerëz, edhe shporta e tyre dhe konsumimi i tyre, ato që i blejnë edhe ata po i paguajnë në këtë shtrenjtim që ka ndodhur në Kosovë. Unë nuk e kuptoj se cila është kjo qasje dhe pse është kjo qasje.

E kuptoj që po thoni “derisa të rregullohen listat e pagave, ose të verifikohen”. Ky rast është në gjykatë dhe ne po presim. Në ligjin paraparak ka qenë një paragraf, se kush dyshon që dikush është i përfshirë në listën e veteranëve e që nuk ka qenë, ka qenë e drejtë e secilit qytetar të Kosovës që ta lajmërojë atë person. Me sa po shohim ne, askush nuk e ka bërë një veprim të tillë, por gjithmonë po e shfrytëzoni këtë rast që të sulmohen veteranët.

Ne duhet ta marrim shembullin më të mirë të trajtimit të veteranëve në mënyrë të dinjitetshme dhe ashtu siç e meritojnë. E kemi rastin e Kroacisë. Ministër, vizitoje Kroacinë dhe shihe se si i trajtojnë veteranët e luftës kroatët. Ky është shembulli më i mirë se si edhe ne si Kosovë duhet t’i trajtojmë.

Po thirreni në disa ligje dhe në paragrafë paraparakë. Meqenëse, ky është një plotësim-ndryshim i ligjit, atëherë nëse keni dashur ta hiqni diskriminimin në raport me këtë, ju keni mundur t’i përfshini edhe veteranët dhe këto kategori. Por, ju po thoni që këto kategori nuk mund të përfshihen për shkak të mundësive buxhetore. Ose duhet të gjendet mundësi buxhetore, që në mënyrë të barabartë të trajtohen krejt qytetarët e Kosovës, ose një ligj i tillë nuk është dashur të silllet fare në Kuvend, se vërtet mua po më vjen turp, që po duhet aq shpesh në këtë Kuvend të debatohet për veteranët e luftës. Është turp, more, me i diskriminua! Është turp të përulen njerëzit që kanë sakrifikuar aq shumë!

Dijeni, unë po shoh që tash po jepni merita luftës që po ndodh në Ukrainë dhe në Rusi, po dimë të japim lëvdime për luftëtarët dhe qëndresën heroike të Ukrainës, po jo shumë larg ka ndodhur edhe në Kosovë kjo. Jo shumë larg, këta luftëtarë që ju sot po dëshironi t’i diskriminoni dhe t’i përulni, kanë qenë në fronte të luftës, njësoj sikurse Ukraina. Tash ne po dimë t’i lëvdojmë ukrainasit që po e mbrojnë vendin e tyre, por nuk po dimë t’i mbrojmë dhe t’i vlerësojmë kategoritë tona.

Është paraparë dhe thuhet se për rritjen e pagës minimale vendos Këshilli Ekonomik Social. A jeni konsultuar me Këshillin Ekonomik Social për rritjen e pagës minimale për të gjitha kategoritë, se unë mendoj që Këshilli Ekonomiko Social nuk ju ka propozuar, ministër, që në rritjen e pagës minimale të mos përfshihen veteranët e luftës, të mos përfshihen të verbrit, të mos përfshihet kategoria e tetraplegjikëve dhe paraplegjikëve. Andaj, edhe pse kemi kërkuar dhe kemi menduar që do ta sillni një plotësim-ndryshim siç i ka hije dhe jo me një plotësim-ndryshim

të ndryshojmë disa ligje. Tërhiqeni pra këtë projektligj, këtë plotësim-ndryshim, përfshini këto kategoritë në pagën minimale dhe do ta keni votën tonë. Përndryshe, ne nuk do ta votojmë.

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Arbër Rexhaj.

**ARBËR REXHAJ:** Në fakt, mua po më pengon kjo çështja e supremacisë për të folur në emër të veteranëve. Ne mund të flasim në emër të qytetarëve, mirëpo kur flasim tash në emër të veteranëve, i bie që po flasim për një kategori shoqërore shumë të gjerë dhe e cila, dorën në zemër, normalisht edhe i ka kërkesat e veta. Mirëpo, kur deputetët flasin në rolin, ta themi, të supremacisë duke thënë “ju po e injoroni këtë kategori”, “ju po e sulmoni veteranin”, mendoj se është e padrejtë, sepse edhe ngritja e paraleles që po bëhet realisht, duke thënë “po e çmoni shumë luftën në Ukrainë, ndërsa po harroni që këtu ka pasur një luftë”, edhe kjo është e paqëndrueshme. Sepse, të gjithë këtu, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës kanë dëshmorë, kanë martirë në shtëpitë e tyre, madje në Kosovë pothuajse çdo lagje dhe çdo fshat ka dëshmorë e ka martirë.

Mendoj që humbja e qytetarëve tanë në luftë, por edhe e ushtarëve e dëshmorëve, është humbje kolektive, nuk është individuale. Dhe, askush nuk ka të drejtë, për shembull, ta mbrojë një veteran më shumë sesa një deputet tjetër. Ata janë tanët, janë të të gjithëve dhe sigurisht se secili prej nesh ua dimë kontributin e tyre në luftë. Normalisht, sot në agresionin rus në Ukrainë sot ka telefon dhe atje po është më lehtë të incizohet lufta dhe të kihet lajmi në kohë. Në luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ne s’kemi pasur telefona, kemi pasur ca kamera e ca gazetarë që kanë hyrë në fronte të luftës, mirëpo unë nuk po kuptoj përse Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, pse pikërisht Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës në njëfarë forme del të jetë ai mbrojtësi i hekurt, pra “gjaku i kaltër” i veteranëve.

Unë e kam një përgjigje për këtë. Mendoj që pikërisht është Aleanca ajo që këtë kategori e ka shumëfishuar, sepse duhet thënë në këtë, duhet thënë një të vërtetë këtu në Kuvendin e Kosovës, e ajo është që realisht nga ata që kanë deklaruar, nuk po e marr deklaratën e një komandanti të UÇK-së, po të plot komandantëve të UÇK-së, numri që është sot i veteranëve të Republikës së Kosovës, është i shumëfishuar, pra nuk është i vërtetë. Dhe, ne të gjithë këtu e dimë këtë gjë dhe sigurisht, se këtë që po e them unë ka kosto. Por, kjo është e vërtetë.

Unë e di që duke e thënë këtë, kjo do të ketë kosto, në kuptimin e asaj që ka tash me mijëra veteranë, e disa të cilët nuk kanë qenë pjesëmarrës në luftë, realisht do të ma shohin për të madhe, sepse edhe ata janë qytetarë, ndoshta i kanë kushtet e rënda ekonomike-sociale, mirëpo nuk janë, bre! Dhe, meqenëse nuk janë, realisht në njëfarë forme, në mënyrë jo të drejtë, duke përdorur litodë në këtë diskursin tim, pra paguhen nga buxheti i shtetit. Dhe, ajo që ka ndërmarrë Lëvizja Vetëvendosje, pra edhe kryeministri Kurti, e ka thënë një të vërtetë. Duhet parë dhe rishikuar dhe natyrisht, meqenëse lënda është në gjykim, mendojmë se duhet thënë fjalën

drejtësia dhe më pastaj, mendoj që duhet pasur një ristrukturim. Sepse, institucionet tona, Republika jonë, duhet kthyer kah e mbara dhe në këtë vend duhet të vendoset drejtësi një herë e përgjithmonë. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë ka kërkuar Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Unë nuk kërkoj leje prej Arbrit për ta marrë fjalën dhe të flas, se jam deputete e Kuvendit të Kosovës dhe kam të drejtat e mia të flas për cilën kategori që dëshiroj. Sidomos jam e thirrur të flas edhe për kategorinë e luftës.

Unë mendoj, thashë dhe po e përsëris, në një amendament të ligjit bazë të vlerave të luftës është që kush e njeh dikë që nuk ka qenë në luftë dhe është në listë le ta lajmërojë. Arbëri po i ditka. Arbëri pse s' shkon t'i lajmërojë në prokurori që ata të hiqen. Dhe tash mos të aludojë një parti dhe një parti tjetër që po i mbrojmë. Po i mbroj parimisht, se është padrejtësi që po u bëhet këtyre kategorive. Dhe jo veç kategorive të veteranëve, po edhe të verbërve, edhe tetraplegjikëve dhe paraplegjikëve.

Edhe një herë ministër, vizitoje Kroacinë dhe merre modelin sesi trajtohen veteranët e luftës. Atë model duhet ta kemi edhe ne. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë, Arbër Rexhaj, gjashtëdhjetë sekonda!

ARBËR REXHAJ: Nuk po i mbron parimisht fatkeqësisht, por po i mbron elektoralisht. Kjo është e vërtetë.

Tjetra, në emër të veteranëve flasin shoqatat, po në emër flasim në emër të qytetarëve. Dhe meqenëse qytetarët janë veteranë nuk po them që s'ke të drejtë të flasësh, as s'ke nevojë të marrësh leje prej meje as prej askujt hiç. Mirëpo, unë po e përsëris edhe një gjë. Kur flet në emër të veteranëve, fol parimisht dhe jo elektoralisht.

KRYETARI: Fjalën tash ia japim deputetit Hisen Berisha.

HISEN BERISHA: I nderuar kryetar!

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Media,

Të dashur qytetarë,

Në veçanti ju veteranë,

Që jeni sprovë më e madhe që i bëheni institucioneve të Kosovës dhe të shoqërisë në përgjithësi, duke i kthyer në personat që në çdo miratim buxheti, çdo rishikim buxheti, çdo miratim të ndonjë ligji që prek në financat e shtetit, t'ju kenë ju nëpër gojë, jo pse ju shpenzoni aq shumë, por vetëm për faktin dhe arsyen të cilën do ta them në vazhdim. Çdo përballje e kësaj Qeverie me vendimet të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit politik të këtij vendi, integritetit territorial të këtij vendi, identitetit moral dhe ligjor e kushtetues të këtij vendi, identitetit moral të shoqërisë kosovare, i është vënë në sprovë dhe e keni lëshuar nga një bajrak nga të gjitha ato bajraqe që i keni ngritur gjatë fushatave elektorale dhe kauzave të rrejshme dhe propagandës që keni zhvilluar për të ardhur deri te pushteti.

Nuk po jua numëroj të gjitha, po vetëm te Ligji i pagës e dini mirë se kur e keni marrë pushtetin ka qenë një Ligj i pagave të cilin e keni çuar në Kushtetuese dhe Kushtetuesja ka thënë se ju nuk keni buxhet për këtë ligj për ta implementuar. pra, nuk e ka goditur ligjin, sepse kushdo që ta ndërtojë sot, nesër apo dje, parimet e ndërtimit të një sistemi page brenda Kosovës mund të ndryshojnë vetëm sa i përket zhvillimit ekonomik dhe sa ai e determinon fuqinë, përndryshe mbeten të njëjta, se ato standarde s'e kemi shpikur ne ujin e nxehtë, po i kemi marrë si eksperiencë të shumëkujt.

Por, ju kur erdhët e revokuat atë, edhe pse e patët buxhetin më të madh, edhe është e vërtetë se që më i madhi ndër këto vite qeverisjeje. Pastaj, premtimi kryesor dhe bajraku që e lëshuat gjatë fushatës elektorale ka qenë pikërisht rritja e pagës minimale në vlerën e premtuar 350 euro, jo vetëm ju. Po, po, mos ma bë me gisht ti, po edhe Partia Demokratike këndeje, edhe subjektet e tjera nuk i mbaj në mend me saktësi, se nëse vijnë në pushtet do ta kenë 350 euro. Për atëherë ky propozim ka qenë brenda logjikës së ekzistencës dhe ruajtjes së standardit të mbijetesës së qytetarëve tanë, sepse edhe shkalla e inflacionit, edhe fuqia blerëse, edhe çmimet e kostoja e jetesës kanë qenë më të ulëta.

Sot, edhe po ta propozoni 500 euro është e pamjaftueshme. Dhe, ju jo vetëm që s'e mbajtet premtimin, por e lëshuat bajrakun. Sot, më duket propozoni një pagë neto minimale prej 250 eurove. E lëshuat këtë bajrak dhe i mashtruat prapë qytetarët, duke dhënë një milion arsye dhe duke u munduar që me gjuhën e atyre subjekteve të Orwellit, që po më bie shpesh ta përmend, t'i bindni qytetarët se kategori të caktuara do të përfitojnë duke u dhënë shifra që fare s'kanë të bëjnë me realitetin.

Ky projektligj që e keni sjellë sot po shpërfaq mashtrimin tuaj elektoral dhe po e shpërfaq edhe faktin se ju jo vetëm që brenda tij s'keni respektuar nevojat bazë të punëtorëve, por nuk e keni ruajtur as atë kriterin më esencial, që është respektimi i standardit social të kategorive të caktuara të shoqërisë. Këtu, ju po i përjashtoni jashtëligjshëm kategoritë e caktuara, ku theksin prapë e keni vënë te veteranët, luftën prapë e keni ndaj atyre që me sakrificën e tyre kanë sjellë lirinë dhe

kemi sot Kuvend, dhe ju jeni bërë deputetë, edhe unë bashkë me ju. Keni përjashtuar po ashtu edhe kategoritë që lëngojnë nga sëmundjet kronike, që i kanë paaftësuar për të jetuar.

Unë kam dy mesazhe luftëtarësh që e ka pensionin e veteranit dhe tash është i sëmur nga sëmundja e rëndë kanceroze, madje edhe i kanë rekomanduar, i kanë dhënë statusin e invalidit shëndetësor dhe nuk i lejohet ta marrë atë shumë, sepse e ka statusin e veteranit. Ju jeni koshient dhe e dini mirë se Ligji i veteranëve nr. 23 prill 2014 nr. 04-L/261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, neni 18 thotë: varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave, me vendim të veçantë mund të vendosë për lartësinë e shumës së pensionit të veteranit luftëtar të UÇK-së, e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë.

Por, nuk jemi duke folur me ato pretendimet siç i ngritën parafolësit këtu për të folur në emër të veteranëve apo si veteranë, por jemi duke folur në emër të qytetarëve, një kategorie shumë specifike, kategorie që do të jetë më e nderuar brenda kombit dhe shtetit tonë sikur këtu të kishte sistem vlerash, sikur këto vendime të mos i merrnin njerëzit që qëndrojnë poshtë vlerave nacionale që duhet t'i ndërtojmë si shtet dhe t'i mbrojmë me ligj, duke përfshirë këtu edhe nderin, edhe detyrën, edhe lojalitetin, edhe integritetin e përgjithshëm.

Prandaj, këto ditë ka pasur shumë shpërfaqje dhe tendenca për të mohuar vlerat e luftës së invalidëve dhe veteranëve në veçanti. Ka edhe tendenca kolektive. Kjo kategori, ku takoni edhe shumë, po më vjen keq se po shoh bashkëluftëtarë edhe në radhët e Lëvizjes Vetëvendosje që ka marrë vendimin, edhe luftëtarë të mëdhenj të periudhave të ndryshme që s'kemi qenë në një vijë fronti, por kam bashkëluftëtarë edhe të vijave të frontit në dy krahët e kësaj salle. Nëse keni komplekse nga fakti se s'keni qenë në periudhën e duhur, pjesë e madhështisë së luftës për liri, që të jep qenia luftëtar i luftës për liri, veteran i kësaj lufte, invalid apo familje dëshmori, nuk është e denjë, nuk është e ndershme t'i luftoni këto vlera. Këto vlera meritojnë të përkrahen dhe të ngriten në nivelin më të lartë, në pedestalin më të lartë të nderit dhe lavdisë së këtij vendi. Këtë duhet ta bëjmë me përkujdesin ndaj tyre.

Sot kontingjenti, kategoria më e diskriminuar në shoqërinë tonë janë veteranët, sepse i keni dhënë një pagë sociale, pension social prej 170 euro dhe i pamundësohet të punojë as askund tjetër. Pra, e keni shndërruar në një person të varfër dhe pa dinjitet, kë, njeriun më dinjitoz, që meriton të jetë më i respektuar në shoqërinë tonë, sepse djersa dhe gjaku i tij është në themelet e kësaj lirie. Ju mund të cicëroni këtu se e kanë bërë në të kaluarën, është filan ligji. Keq është bërë atëherë, keq është sot. Lëreni frazeologjinë autike të përsëritjes jo njëzet vjet e kështu. Keni ardhur me premtimin për ndryshim, urdhëroni bëjeni ndryshimin për mirë. urdhëroni, respektojeni këtë kategori, e mos u mundoni ta mbuloni me atë frazeologji se jeni bërë bajat tashmë se është bërë njëzet vjet. Se s'është e vërtetë që është bërë, se kur është caktuar atëherë



ajo bazë, fuqia blerëse e saj ka qenë shumë më e lartë sesa është sot, se sot s'e blen as një litër vaj me ato para. Prandaj, reflektoni dhe urdhëroni ashtu siç ju kam ftuar edhe për kategorinë e familjeve të dëshmorëve, atë kategorizimin fyes që kryetari me të drejtë e tha se s'bën të quhen, po ashtu ka qenë kryetar.

Ashtu siç keni bërë me invalidë. Ferat Ademi sot s'ka këmbë. Protezat i janë prishur, askush nuk ia rregullon. Prandaj, këto janë kategori morale, këto s'janë partiake. Këto s'janë fushata elektorale, as premtime, por janë kategoria më e nderuar e kombit. Zoti s'vret veç individë, por edhe popujt kur nuk e çmojnë gjakun e vet.

Reflektoni, kthejeni këtë ligj, trajtojeni si duhet. Zbatojeni ligjin, s'jam duke thënë dilni prej ligjit, se ligji thotë që duhet të mos e kenë pagën më të vogël se paga minimale në këtë vend. Reflektoni se është nder. Nëse vuani nga kompleksi se s'keni qenë në atë pjesë të asaj lavdie, të paktën shërojeni duke e respektuar madhësinë e lavdinë që e kanë bërë heronjtë e këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Berisha, kur po thoni që s'keni qenë dhe keni komplekse që s'keni qenë pjesë e asaj lufte, bash fillova t'i shoh grupet parlamentare, edhe në LDK po e shoh një që ka qenë kështu fort në mënyrë të lavdishme sigurt, në Vetëvendosje po i shoh pesë, e në PDK po i shoh dy.

Kjo është gjendja aktuale qysh po ju shoh tash. Kështu që nuk bën të hyhet andej, sepse ka prej secilit grup parlamentar që ofendohen, sepse kanë qenë pjesë e luftës çlirimtare. Prandaj, është fort gabim të flitet në mënyrë monopolizuese për luftën çlirimtare. Unë besoj që nuk bën të flitet hiç në këtë drejtim. Është në rregull të flasim për veteranët, është në rregull të japim kritika, por nuk është në rregull të flasim prej dimensionit të komplekseve kush ka qenë e kush s'ka qenë, sepse mendoj që prej të gjitha grupeve parlamentare këtu kanë qenë.

Jo LDK-ja e ka radhën tash. A do replikë, Hisen? Urdhëro!

HISEN BERISHA: Kryetar,

Unë atë thirrje nuk e bëra për veteranët që janë në sallë, se unë i njoh me emra dhe me figurë krejt kush janë. Një.

E dyta, nuk e dhashë në mënyrë gjeneralë, se të gjithë deputetët hyjnë aty, se unë e di kush ka qenë e ku ka qenë e sa kanë bërë. Problemi është që vendimmarrja e tillë është diskriminuese dhe është ndesh me standardin e respektimit të kategorive shoqërore. Dhe ju e dini dhe të gjithë jeni të vetëdijshëm se kategoria më e diskriminuar, jo vetëm tash që po bëhet kjo paga minimale, por edhe kur miratohet buxheti, janë objekt trajtimi edhe përforje, dikush të bëjë patriotizëm, e dikush të tregojë ligjshmëri e parimësi, pikërisht veteranët. E është turp, se ne e dimë mirë se

janë të diskriminuar, se me 170 euro nuk mund të jetojmë as unë as ti, dy ditë nuk mund të jetojmë, edhe as kurrë një ne që jemi këtu. Për neve ka standard të lartë jetësor, sepse kartelat tona na tregojnë shifra të tjera kur shkojmë në bankomat. Ata jetojnë me 170 euro. I kam njëqind mesazhe, nëse doni jua lexoj, ose i publikoj, e i lexoni vetë. Njeri që më shkruan që s'ka miell te shtëpia, e veteran. Se i ka 170 euro, s'ka ku punon. Nuk e kam lënë unë. Nëse e ka lënë dikush, përmirësojeni ju. Lëreni frazeologjinë autike, e kanë lënë, e kanë lënë.

Keq është bërë njëzet vjet, bëjeni mirë sot. Lëri këto forma të shprehjes. Ku ishte ti që s'e bërë? Nuk kanë pasur kohë ata të shkojnë në Beograd t'i bëjnë ato hartat e me gjeneralët e Serbisë. Mos fol gjepura. Kujdes! Je duke folur me Hysen Berishën, kujdes!

KRYETARI: Vazhdojmë. Ia japim fjalën kryetarit të Grupit të AAK-së, Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Qetësi, ju lutem!

BESNIK TAHIRI: Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Konstatimi i parë i të gjithë neve si deputetë është që paga minimale, respektivisht ngritja e kësaj page minimale është imperativ i kohës, është diçka që të gjithë duhet ta trajtojmë me kujdes. Kjo pagë minimale është e vërtetë edhe ajo që u tha se nuk është ngritur deri tash. Fatmirësisht ka ardhur një amendamentim i ngritjes së kësaj page dhe mendoj se kjo rritje e kësaj page duhet të vijë dhe vjen në bazë të një kriteri. Në qoftë se e shohim me kujdes Ligjin e punës, shohim që gjatë përcaktimit të pagës minimale para sysh duhet të marrim disa faktorë. Faktori i parë dhe më i rëndësishmi për përcaktimin e pagës minimale është kostoja e shpenzimeve jetësore. Pika e dytë ka të bëjë me përqindjen e shkallës së papunësisë. Pika e tretë ka të bëjë me gjendjen e përgjithshme në tregun e punës dhe pika e katërt ka të bëjë me shkallën e konkurrencës dhe produktivitetit në vend.

Ajo që të gjithë e dimë dhe këtu nuk kemi nevojë ta mësojmë njëri-tjetrin është se kriteri i parë, kostoja e shpenzimeve jetësore është rritur dhe paga minimale siç është e përcaktuar me amendamentimin e këtij ligji nuk përkon as me kriterin e parë e as me katër kriteret. Shpesh jam pyetur prej kolegëve deputetë dhe prej ministrit Murati pse dhe ku i gjej mjetet dhe paratë kur kemi propozuar që paga minimale të jetë 370 euro dhe bruto 400 euro. Është e vërtetë që kjo do të ishte një barrë e madhe për sektorin privat, sikurse që është e vërtetë, se këtu ka edhe ndërmarrës deputetë. A bën Time veç pak, të lutem.

Këtu ka deputetë që janë ndërmarrës dhe të cilët e dinë, thonë nuk po kemi mundësi të gjejmë punëtorë. Këtu ka ndërmarrës ose ka ndërmarrës në ndërtimtari, që thonë për shkak të skemës

sociale, të atij sociali që e marrin nuk po mund të vendosim njerëz në punë. Pra, kemi një situatë ku duhet ta trajtojmë me gjakftohtësi, mirëpo edhe me një kalkulim real të situatës. Po, të gjithë jemi këtu si deputetë të një mendimi që paga minimale duhet të rritet, sikurse të gjithë që e dimë, ne mund ta mashtrojmë njëri-tjetrin, po të gjithë e dimë që pagë nën 250 euro, përveç tek që ne e kemi bërë si Aleancë një hulumtim, përveç tek punëtorët fizikë, te punëtorët e sigurimit, të cilët pjesërisht mund ta kenë pagën 230 a 240, në disa organizata pak më të madhe, paga minimale të të gjithë sektorët e tjerë ka arritur ta kalojë 250 euroshin.

Pra, në aspektin real, paga minimale 250 euro s'po them që është prej krejt, pra nuk po them për 140 mijë që janë të regjistruar, që nënkupton dyzet për qind të tyre janë pjesë e ATK-së, po e dimë që paga minimale sot për sot në shumicën dërmuese të 90-përqindëshi ka arritur të 250 euro.

Në këto rrethana, unë mendoj që vendimi i sotëm dhe vendimi i ministrit Murati që po na e sjell këtu, realisht shpërfaq një pazotësi të një kalkulimi të një vendimmarrje pak më përtej. Në këtë temë do të thosha që 250 euroshi besomëni nuk e ka impaktin. Të gjithë e dimë që po t'ia heqim dushkun, ne e dimë që ndoshta secili prej neve ka ndonjë punëtor 250- euro ekziston paga minimale në treg. Andaj, sa i përket kësaj nuk mendoj që jemi duke bërë ndonjë shërbim as për punëtorët që janë të kyqur në sektorin privat, e qe besa as për privatnikët për sektorin privat të cilët pastaj do të shtyeshin prej një vendimi ministër të juajin që të shkojnë edhe ata pak përtej, sikur do të duhej të shkonte Qeveria me ngritjen e pagës, me të njëjtën gjë do të shtyhej sektori privat të shkojë pak përtej p.sh. të 350 euro, që në qoftë se s'mundeni 400, të 350 a 300.

Pra, në rastin e parë, ajo që dua t'ju them është që ne duhet të jemi shumë seriozë. Edhe unë kërkoj prej ministrit Murati që në këtë temë të ketë një diskutim shumë serioz mes dy leximeve, për shkak se kjo pagë, 250 euro nuk është rritje. Nuk dua ta përdor, se jemi bërë duke thënë mashtrim, po është njëfarë shpërfaqje e një pazotësie për të shkuar më tej, e ai vendim përtej e dëmton sektorin privat të mos shkojë përtej.

Andaj, zoti ministër, unë kisha kërkuar prej jush, kisha kërkuar prej kolegëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje që në këtë temë të ulemi e të diskutojmë seriozisht, haptazi, jo ta ofendojmë njëri-tjetrin, se gjithkush e dimë gjithsecili kush është, kush ka zoteni, kush është më veteran, kush është më pak, kush ia ka bërë argatin në luftë, kush e ka bërë pas luftës. Nuk është temë kjo. Tema është sot a mund në këtë pagë minimale ta trajtojmë më seriozisht, duke e ngritur pagën minimale, duke marr guximin si Qeveri, por njëkohësisht duke e shtyrë sektorin privat të veprojë.

Te çështja e veteranëve, është një fatkeqësi e madhe që çfarëdo teme që të hyjmë diku, diqysh veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që folëm të gjithë sa të vlefshëm janë e sa shumë i përkulemi veprës heroike të tyre, diqysh i gjejmë në temë.

Për ne si grup parlamentar, është tepër me rëndësi që kjo kategori e njerëzve, mirëpo edhe kategori të tjera mos të diskriminohen, në emër të një procesi apo tjetër. Unë mendoj që Bekë Berisha e shpjegoi shumë qartë, shumë saktë. E trajtoi, tha në rregull qenka një proces i verifikimit, i gjykimit, ku di unë. Unë nuk di qysh e merr gjumi dikush që është paraqitur veteran e nuk është veteran. Sinqerisht e kam. Mirëpo kjo është temë morale. Tash po flasim për një temë pragmatike. Për një temë e cila i prek të gjithë. Kërkesa ime është që ne ministër, të ulemi, të diskutojmë dhe të mos e bëjmë një gabim shumë të madh që pastaj vijmë në situatën kur unë e mora shishen e plastikës e i mëshova këtu, tash me shishë të plastikës na vijmë veteranët përpara. Ju kisha lutur, ju lus, në qoftë se ne në këtë vendim, dhe në qoftë se nuk dakordohemi, se për të kaluar paga minimale unë jam plotësisht për, pra kjo është po, edhe aferim, edhe ju komplimentoj, në rregull jemi.

Por, në qoftë se ne vijmë sot dhe e miratojmë 250 euro pa një zotim tuajin që ne duhet të ulemi për veteranët. Kjo nuk është kërcënim, se unë s'kam nën kontroll veteranët, mirëpo unë ju garanton që ju do të keni protesta. Do të thonë qysh unë veteran e në Ligjin në nenin 18 thotë në mënyrë eksplicite: pensioni i veteranit është i barasvlershëm me pagën minimale. Thotë e pse bre vëlla me hiqte, pse e hoqët atë nen, pse ju penguan e hoqët atë nen? A s'ju penguan kur ju çliruam, a? Pra, kemi për të ardhur, po ju parapërgatis në një situatë, kur ndoshta na duhet prapë të lëshojmë pe me mjete jokonvencionale.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës këtë draft siç e tha deputeti Berisha e kundërshton. Pra do të votojë kundër. Me një zotim që ne do të ulemi me kolegët e Komisionit për Buxhet dhe Financa, me shefat e grupeve parlamentare, në mënyrë që ta përmirësojmë pagën minimale. T'i lëmë veteranët aty. Kur të bëhet numri, se një vit është në pyetje. Në qoftë se qenka që paska të rrejshëm për një vit kjo punë sqarohet, pastrohet. Po jo t'i largojmë tash. Për besë, ju them me përgjegjësi të plotë do të lëshoni pe, se protestat do t'ju detyrojnë të lëshoni pe.

Për të mos ardhur aty, po ju lus që, ne do të votojmë kundër, po të ulemi, të diskutojmë, të sqarojmë. Nuk është një numër i madh i tyre dhe ta shtyjmë përpara dhe pastaj të shohim edhe skemat pensionale, ta sjellim ligjin, se ne Aleanca do ta votojmë Ligjin për skemë pensionale për reformën, ta shohim me të, le ta rregullojmë këtë temë, por jam për ta rregulluar, përndryshe, ju garantoj protestat i keni përpara. Unë s'mund t'i thërras, po ata vetë do të protestojnë.

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Enver Dugolli.

**ENVER DUGOLLI:** I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Kur po dëgjoj kolegët nga opozita e debatet e diskutimet që po bëhen këtu, unë thjeshtë jam pak i habitur a po flasim për Ligjin e veteranëve dhe kategorive të dala nga lufta, apo po flasim për Ligjin për pagën minimale. Thjesht, është një abuzim i skajshëm që po bëhet me këtë temë, siç është bërë që njëzet vjet me këtë kategori të dalë prej luftës, me veteranë, me invalidë, me familje të dëshmorëve. Është për turp që deputetët që ishte dashur të jenë të sinqertë para qytetarëve dhe para këtyre kategorive, edhe sot abuzojnë në emrin e tyre e me kontributin e tyre. Nuk është në rregull, për shkak se po flasim për pagën minimale, e ishte dashur që të fokusohemi këtu.

Unë po kthehem në temë për të dalë prapë te tema të cilën vetë disa kolegë deputetë e ngritën.

Të dashur qytetarë,

Në mbledhjen e rregullt të Qeverisë të datës 13 prill 2022, në mesin e shumë vendimeve të rëndësishme të Qeverisë së Kosovës, ka miratuar dy projektligje, njërin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe e dyta për shqyrtimin për plotësim-ndryshimin e ligjeve që e përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallën tatimore për të ardhurat personale vjetore.

Në rastin e parë, më lejoi të ritheksoj që njëherë me plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndarje buxhetore, vendi ynë për herë të parë ka shënuar një performansë të shkëlqyer në rritjen e të hyrave buxhetore në masë prej 17 për qind. Për herë të parë, Republika e Kosovës do të ketë buxhet afro tre miliardë euro.

Të dashur qytetarë,

Ky është një rezultat i arritur falë një pune me përkushtim dhe disiplinë të Qeverisë së Kosovës, e cila po e bën menaxhimin e parasë publike.

Sa i përket performansës së fortë të të hyrave publike, Kosova ka marrë vlerësime pozitive nga organizatat ndërkombëtare.

Në rastin e dytë, Qeveria e Kosovës për herë të parë ka miratuar projektligjin që e cakton vlerën e pagës minimale në vlerë prej 250 euro neto, apo 264 euro bruto.

Të nderuar qytetarë,

Ky ka qenë synim i Qeverisë Kurti që nga ditët e para të qeverisjes të determinuar edhe nga programi zgjedhor i Lëvizjes Vetëvendosje në zgjedhjet e 14 shkurtit.

Të nderuar kolegë,

Për njëmbëdhjetë vite paga minimale ka qenë e pandryshuar në Kosovë, ndërsa në vendet e regjionit paga minimale pësonte rritje graduale, në Kosovë ajo mbeti e pandryshuar për njëmbëdhjetë vjet rresht.

Partitë opozitare që dikur ishin në pushtet nuk ndërmorën asnjë veprim institucional e as ligjor në këtë drejtim. Por, përderisa Qeveria Kurti synon që rritjen e pagës minimale të përfitojnë rreth 100 mijë punëtorë, të gjithë punëtorët me pagë të ulët që deri dje paguheshin me 130 euro ata nën moshën 25-vjeçare, e në rastin më të mirë, 170 euro ata që janë mbi moshën 35-vjeçare.

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Qeveria e Kosovës ka miratuar dhe ndryshuar shkallën tatimore që parasheh që të gjitha pagat të mos taten deri në 250 eurot e para. Ka përpjekje nga partitë opozitare që edhe disa media të lidhura me to që ta relativizojnë çdo sukses të Qeverisë Kurti. Sa i përket pagës minimale u përpoqën që të vazhdojnë të ndërtojnë narracionin se kjo vlerë është e pamjaftueshme në këto rrethana të rritjes së çmimeve. Megjithatë, partitë opozitare sa ishin në pushtet nuk ndërmorën asnjë veprim në rritjen e pagës e moralisht nuk kanë të drejtë të abuzojnë me vendimet që merr Qeveria Kurti në përmirësimin e standardit jetësor të qytetarëve që në janë në rendin e fundit sa i përket realizimit të të ardhurave.

U përpoqën, siç po përpiqen edhe sot, e do të vazhdojnë të përpiqen që të tërheqin paralele mes rritjes pagës minimale me pensionet dhe beneficionet e veteranëve të luftës.

Të nderuar kolegë dhe qytetarë të dashur,

Argumenti se vlera e pagës minimale prej 250 euro interferon me pensionet e beneficionet për veteranët e luftës nuk qëndron. Prandaj, është e padrejtë që sot të shtrohet kjo çështje.

Në vitin 2017 apo në vitin 2016, gjegjësisht në vitin 2017 ka hyrë në fuqi, Qeveria e kaluar e udhëhequr nga koalicioni kishte miratuar Ligjin nr. 05/L-141 për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr.04/L-261 për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mes tjerash ka shfuqizuar, ka fshirë nenin 18, i cili lidhej me pagën minimale.

Ky plotësim i ligjit të vitit 2017 i bërë PAN-i kishte shkëputur çdo ndërlidhje me efekt ligjor mes pagës minimale dhe pensioneve dhe beneficioneve të kategorive të dala nga lufta.

Ishin këto parti opozitare që dikur në Qeveri e bënë këtë ndërhyrje ligjore, e kaluan fshehurazi, pa zhurmë këtë plotësim-ndryshim të vitit 2017. Domethënë, shumë tinëzisht filluan e bënë atë ndryshim dhe nuk u bë kurrfarë buje, besa nuk u bë as organizatat e dala nga lufta, çuditërisht.

Andaj, është e padrejtë dhe jo korrekte çdo përpjekje që ka për qëllim instrumentalizimin e pensioneve dhe beneficioneve për veteranët e luftës me rritje e pagës minimale.

Qeveria Kurti e ka një komunikim të vazhdueshëm me organizatat e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në vazhdimësi vihet në pah përkushtimi i Qeverisë për thellimin e bashkëpunimit me Organizatën e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Krahas trajtimit të kërkesave dhe shqetësimeve të tyre, lidhur me mirëqenien e veteranëve dhe mundësinë e shtimit të bashkëpunimit për të përmirësuar gjendjen e tyre duke trajtuar edhe çështjet e pastrimit të listave të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kur jemi këtu te veteranët. Ne të gjithë e dimë që numri real i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk është ky që po na servohet e na ka sjellë deri këtu.

Është e pamjaftueshme paga apo beneficioni që unë e parapëlqej që të mos quhet pension, për shkak se veteranët e vërtetë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duhet ta gëzojnë një beneficion apo një pagë shtesë. Mirëpo, kjo ka të bëjë me Ligjin për veteranët të cilin e keni sjellë dhe e keni miratuar ju të dashur kolegë nga opozita.

Për më keq, e keni rritur numrin, e keni rritur numrin. Veç një kalkulim i thjeshtë. Në ligjin bazik në të cilin po thirrreni, por të ndryshuar dhe të plotësuar në vitin 2017, është një tavan, i cili e determinon edhe shumën apo lartësinë e pagesave për këtë kategori, është 0.70 për qind e bruto produktit kombëtar. Dhe, nëse e bëjmë një kalkulim të thjeshtë; sot, përfutur të kësaj kategorie janë mbi 37 mijë veteranë dhe pagesat që i marrin ata nga 170 euro e tejkalon 0.70 përqindëshin e bruto produktit kombëtar.

Dhe, prapë një kalkulim i thjeshtë; nëse listat do të ishin pastruar dhe do të bëhej përpjekje që të pastrohen, asnjë veteran i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk do të mbetej nën 350 euro që do t'i merrte. E kjo për shkak se ne dimë që dy lista kanë qenë referencë, lista e IOM dhe lista e TMK-së. Dhe, në rastin më të keq në TMK lista e veteranëve më 2009 ka qenë 23 mijë dhe në mbledhjen që i mbanim thoshim që është e fryrë. Prandaj, hajde të bëhemi bashkë...

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputeti Anton Quni.

**ANTON QUNI:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

U ngjita që ta marr fjalën nga parafolësit e mi, por edhe nga qëndrimi i ngurtë i ministrit edhe disa anëtarëve, deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët me ngul e mbrojnë këtë variant të projektligjit.

Unë nuk kam diçka të re për të thënë, por thjeshtë, të sjell në kujtesë disa shembuj që praktikohen në shtete demokratike, shtetet e Perëndimit, të cilat ne në shumë raste edhe i marrim si model.

Një normë ligjore duhet ta kuptojmë se në ndërkohë bëhet pjesë e kulturës. Do të thotë, nëse me një normë ligjore e privilegjon një komunitet, një kategori, ajo bëhet edhe pjesë e përgjithshme e kulturës sonë ndërkohë.

Por, nëse me një komunitet apo me një kategori me ligj abuzon, atëherë duhet edhe ta presësh që ndërkohë do të bëhet pjesë e kulturës sonë shtetërore dhe kombëtare që me ato kategori në vazhdimësi të abuzohet.

Po e marr shembull Zvicrën, të cilën besoj që të gjithë e keni vizituar, keni përjetime, keni përvoja e të tjera. Në një ndër kategoritë më të trajtuara, veçanërisht të trajtuar me ligj dhe të mbrojtur, janë punëtorët. Deri në ato përmasa sa që është bërë kulturë te qytetarët, nëse një punëtor është në radhë në ndonjë institucion, në ndonjë restorant për ndonjë shërbim, ai do të jetë i pari i cili do të shërbehet.

Do të thotë, të gjithë ata me kostume, me kollare, do të largohen dhe t'i japin përparësi punëtorit që ai t'i kryej shërbimet e veta dhe sa më shpejt t'i kthehet punës.

Zvicra nuk merret me veteranë, që 500-600 vjet nuk kanë pasur luftë e të tjera. Por, i kemi edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që ne shpesh i marrim për model. Unë kam pasur rastin në vitin 2003 gjatë një studimi në Universitetin Blumington, kur plotësoja dokumente të ndryshe, duke filluar prej sigurimit shëndetësor deri te transporti urban, ishin shumë pyetje të cilat ishin të fushës së veteranëve.

Aty bëhej pyetje, a je veteran i Luftës së Dytë Botërore, veteran i Paqësorit, veteran i Koresë, i Vietnamit, Gjirit Persik e të tjera, dhe ishin kategori të ndryshme, dhe nëse ishe, natyrisht i gëzoje beneficinet e ndryshme.

Por, edhe një veteran kërkonte ndonjë shërbim në ndonjë institucion, nëse me pamjen e tij tregonte që është veteran, ai respektohej shumë prej qytetarëve, i jepej përparësi në çdo gjë.



Pse po e them këtë? Nëse ne sot si komunitet, si kategori, i përjashtojmë veteranët nga trajtimi me këtë projektligj, i vendosim në kategorinë me të ulët të benefiteve të cilat duhet t'i gëzojnë nga shteti.

Zoti ministër, të jeni të bindur se në të ardhmen kjo do të bëhet pjesë e kulturës, dhe jo që vetëm ministria, jo vetëm Qeveria po abuzojnë me të, por nëse ata do të abuzohen në komunë, në ambulanca, në QKUK e të tjera, dhe kjo është shumë e rrezikshme, shumë e rrezikshme, sepse nesër do të kemi nevojë për ta.

Por, edhe të gjithë ata ushtarakët, policë, zjarrfikës të cilët e rrezikojnë jetën, sot marrin një shembull të mirë se si do të trajtohen ata në të ardhmen nëse e rrezikojnë jetën e tyre.

Ne, sot duhet ta japim një mesazh shumë të fuqishëm, se për çdo kategori e cila ka dhënë kontribut dhe do të japë kontribut edhe me çmimin e jetës për t'i ruajtur këto vlera tona të cilat ne po i kultivojmë, gjithnjë, shteti, shoqëria do të jenë në përkujdesin e tyre.

Do t'ju lusja zoti ministër, t'i merrni parasysh të gjitha vërejtjet që u dhanë. Besoj që është çështje që i tangon të gjitha partitë politike. Unë nuk kam dyshime që ndonjë parti politike ka ndonjë qëndrim ndryshe ndaj atyre që kanë sakrifikuar edhe me jetë, por e marr në kuptim në asaj që kemi mungesë të buxhetit, por ju kisha lutur që t'i keni parasysh të gjitha këto vërejtje, ta rishikoni projektligjin dhe të vini me një projektligj, i cili këtë kategori nuk e përjashton nga trajtimi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash ia japim fjalën deputetit Rashit Qalaj.

**RASHIT QALAJ:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,

Me të vërtetë po flasim sot për një projektligj, i cili ndoshta është njëri ndër projektligjet më të rëndësishme për momentin për qytetarët e Kosovës, sidomos për një shtresë më të varfër të popullit të Kosovës, e cila jeton në kushte mjaft të vështira.

Është e vërtetë, siç thanë edhe disa deputetë paraprak, që paga minimale ka vite që nuk është rritur dhe kjo pagë minimale ka qëndruar e tillë edhe përkundër nevojave që paga minimale të rritej para disa viteve.

Nëse e shikojmë pagën minimale e cila ende është në fuqi dhe pagën minimale e cila është propozuar nga Qeveria aktuale, atëherë gjithçka mund të vërejmë, por nuk mund të vërejmë rritje.

Nëse e analizojmë se sa ka qenë vlerë e pagës minimale në fuqi në treg dhe atë pagë minimale sa ke mundur që ta mbushësh shportën nëpër dyqanet tona, dhe sa është vlera e kësaj page minimale të propozuar, po ashtu në relacion me shportën të cilën qytetari do të shkojë në dyqane për t'u furnizuar, besoj që nuk mund të flasim për rritje, absolutisht hiç.

Në numra, nëse e krahasojmë 170 me 250, po. Por, nëse flasim për vlerën, duke e pasur parasysh gjendjen në të cilën jemi sot me ngritjen enorme të çmimeve, me gjendjen që e kemi në ekonomi e të gjitha të tjerat, atëherë më së paku mund të flasim për rritjen e pagës minimale.

E di realisht ministri i Financave dhe Qeveria kujdesen për buxhetin dhe gjithmonë buxheti i një shteti është i kufizuar, e kuptoj atë dhe është krejt normale, mirëpo në anën tjetër nganjëherë duhet që të dalim përtej kësaj. Realisht, do të kisha kërkuar që paga minimale, jo për elektorat, jo për çështje të votave, por për çështjen e ekzistencës së popullit, të jetë më e lartë se 300 euro, dhe prapë nuk do të ishte e mjaftueshme.

Prapë, gjendja nuk do të përmirësohej aq për kategoritë më të varfra të këtij vendi. Dhe, po zoti Enver Dugolli, deputet, koleg imi në Komisionin për Siguri, besoj që po të ishin edhe veteranët të përfshirë në këtë ngritje të pagës minimale, nuk do të ishte temë sot, nuk do të flisnim për veteranët sot, por pikërisht neni 2 dhe paragrafi 3.1 që i përjashton deri në kategorizimin e veteranëve, na detyroi të flasim edhe për veteranët sot. Dhe, veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të Republikës së Kosovës, dhe ne jemi deputetë të Republikës së Kosovës, kur flasim për veteranët, besoj që nuk do të duhej të kishim ndasi në parti politike për shkak se veteranë kemi në të gjitha partitë politike.

Janë të reprezentuar edhe këtu, bile jo vetëm veteranë, por edhe veprimtarë që kanë punuar për këtë shtet shumë më herët, me dhjetëra vite më herët. Problemi është te ligji bazik. Është fakt që ka qenë gabim, që e konsideroj që është gabim që veteranit i është ndaluar që të punojë. Kurrë përjetë nuk do ta kisha ngritur dorën që ta votoj atë ligj, kurrë, pavarësisht kush ka qenë kryeministër, kush ka qenë i partisë sime apo dikush tjetër.

Kurrë përjetë nuk do ta votoja një ligj që një veterani t'i ndalohet që të punojë. Është gabimi më i madh që ka mundur të ndodhë ndonjëherë. Po flas përtej partisë politike, veteranët, ne të gjithë po vrapojmë kur po kemi ceremoni të ndryshme, përvjetorë të ndryshëm, te varrezat e dëshmorëve të cilët kanë pasur fatin që ta japim jetën për lirinë e këtij vendi, ndërsa ne të tjerët të jetojmë, dhe kur ne mburremi të gjithë me veprat e dëshmorëve tanë, me veprat e veteranëve tanë, me veprat e invalidëve të luftës, ne duhet, po ashtu t'i trajtojmë këto kategori ashtu siç edhe e meritojnë.

Është fakt që veteranët janë përdorur edhe në fushata nga të gjitha partitë politike, s'ka diskutim. Është fare e lehtë që të verifikohet kjo. Pra, është fakt që veteranët nuk janë trajtuar asnjëherë, kurrë, ashtu siç duhet.

I nderuar ministër,

Unë mendoj që fillimisht në këtë projektligj, veteranët të mos diskreditohen, procesi që është në gjykatë, të konsiderohet si një proces i ndarë. Dhe, shpresojmë që proces të përfundojë sa më shpejt në gjykatat tona, dhe ta dimë se kush është veteran i vërtetë e kush jo, mirëpo në anën tjetër procesi të vazhdojë, në mënyrë që veteranët e vërtetë të mos dëmtohen, të mos diskriminohen në lartësinë e shumës së pagës minimale.

Tekefundit, ne si shoqëri ua kemi borxh veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që të trajtohen së paku më mirë se që po trajtohen tash. Dhe po, besoj që shumë shpejt duhet ta rishqyrtojmë ligjin bazik për veteranët, dhe ne t'i trajtojmë ashtu siç duhet me Ligjin që është për veteranë, dhe atë duhet ta bëjmë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Po ashtu, po shpresojmë që edhe organet gjyqësore, organet e drejtësisë të punojnë më shpejt, në mënyrë më efektive, ta përfundojnë këtë çështjen e veteranëve, e cila është duke u zvarritur vite e vite. Sepse, sa më shumë që zgjatë, aq më shumë diskutohet për këtë problem pa nevojë, rasti është te organet e drejtësisë, dhe është në dorën e tyre që t'i japin epilog në mënyrën më të drejtë të mundshme, ashtu siç e do ligji.

Askush nga ne këtu, nuk besoj që ka ndonjë individ këtu, i cili kishte pasur dëshirë ta kemi në listën e veteranëve një njëri që nuk ka qenë farë i angazhuar, e që s'ka dhënë kontribut, nuk besoj që ka ndonjë njëri këtu.

Prandaj, prapë po e përsëris, ta ndajmë si proces, ndërsa t'i përkrahim veteranët njëjtë me këtë shumën e pagës minimale, sido që ta quajmë, ose kontribut për ta ose beneficion, sido që ta quajmë. Veteranët i kemi keq.

Dhe e dyta që është e rëndësishme, t'ua mundësojmë që ata të punojnë pa ndonjë pengesë ligjore dhe të mos kenë pasoja te beneficionet që i marrin sot. Unë besoj fuqishëm që ne si grup parlamentar do ta kishim përkrahur sikurse të mos ishin diskriminuar këto kategori, siç janë veteranët, të verbrit dhe kategoritë tjera.

I nderuar ministër,

Do t'ju kishim lutur që, po flas në emër të grupit parlamentar, që t'i merrni parasysh vërejtjet që i dhanë deputetët sot, të të gjitha partive politike, në mënyrë që ky projektligj pastaj të votohet dhe të ecim përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Mos është lajmëruar dikush prej Vetëvendosjes në emër të Gazmend Gjyshincës, i cili nuk është këtu? Artani a po? Artan Abrashit ia jepni fjalën te mikrofoni i Gazmend Gjyshincës.

ARTAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra prezentë në sallë,

Është lajm i mirë që më në fund po vjen ky vendim në Kuvendin e Republikë së Kosovës, dhe po e trajton një çështje e cila është diskutuar shumë, mirëpo nuk është bërë asgjë në këtë drejtim.

Për fat të keq, deklaratat, sugjerimet, edhe pse në të drejtën e tyre, të shumë kolegëve, nuk qëndrojnë dhe konsideroj që janë shumë dashakeqe. Të bësh sot analizë të paqëndrueshme ekonomike, se pse nuk duhet të miratohet ky vendim, e para.

Të bësh sot kërkesa absurde me temën që nuk ka të bëjë me këtë temë, duke i trajtuar kategoritë të cilat nuk kanë të bëjnë me temën e diskutimit, nuk kanë të bëjnë me çështjen e pagës minimale, fsheh një fakt të hidhur, e që është se partitë politike të cilat deklarohen kundër këtij vendimi, grupet parlamentare, janë për lejimin e shfrytëzimit dhe eksploatimit të qytetarëve në tregun e punës. Nuk ka asnjë shpjegim tjetër.

Këto tema të cilat u shtruan këtu, veteranët, kategoritë sociale, kategoritë të cilat kanë nevojë për mbështetje, nuk kanë të bëjnë ekskluzivisht me këtë çështje të cilën ne po e trajtojmë sot.

Këtu e përcaktojmë një pod nga i cili nuk mund të biem kur vjen puna te pagesa e qytetarëve të cilët e shesin punën e tyre në tregun e punës. Prandaj, abuzimi në këto përmasa që po ndodh në Kuvend të Republikës së Kosovës, mund të jetë natyrisht në të drejtën e tyre, mirëpo nuk qëndron aspak dhe konsideroj që po tejkalohet edhe minimumi i etikës si deputetë të Republikës së Kosovës.

Çështjen e rregullimit të pagës minimale, tashmë shumë shtete e kanë bërë që në shekullin e kaluar. Kosova është vend i ri dhe këtë gjë duhet ta bëjë. Kjo le të jetë një pikënisje. Natyrisht, e kemi parasysh që nuk i plotëson të gjitha nevojat, mirëpo pas shumë analizave, pas shumë ekspertizave të cilat janë bërë nga njerëzit e fushës, është dhënë rekomandimi që kjo pagë minimale për momentin i përgjigjet nevojave të ekonomisë.

Ne, nuk dyshoj aspak, si deputetë të Kuvendit të Kosovës nuk do të hezitonim ta ngremë dorën qoftë edhe për 1 mijë euro pagën minimale, mirëpo e dini që ky është absurditet dhe kjo çon në kolaps ekonomik.

E para, ose ta ngre informalitetin në një përmasë e cila nuk ka ekzistuar në Kosovë, ose-ose do t'i bankrotonte shumë biznese të vogla që ashtu-kështu mezi ia dalin. Kjo që po ndodh sot është një lajm i mirë, kjo që po ndodh sot është një gjë e mirë.

Prandaj, do t'i lusja deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta lënë anash fantazinë e tyre elektorale duke u shtyrë me njëri-tjetrin se cili po jep propozime më kreative se tjetri rreth çështjes së pagës, duke e ditur që është një çështje e ndjeshme kjo. Të marrim këtë vendim i cili është i nevojshëm, është i domosdoshëm, dhe natyrisht në të ardhmen në rastin e parë po që se kemi mundësi për ndryshim dhe plotësim e tij, edhe duke i përfshirë edhe kategoritë të cilat mund të jenë temë e diskutimit, kjo gjë edhe do të bëhet, porse si pikënisje është një vendim i mirë. Prandaj, bashkërisht t'i lëmë anash këto gjëra të panevojshme, të vazhdojmë tutje me aprovimin, respektivisht votimin e këtij vendimi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

**BLERTA DELIU-KODRA:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të mediave,

E para, këto diskutimet e sotme për projektligjin që e kemi në këtë seancë plenare, mundoheni pak ta kuptoni edhe qasjen e opozitës sot, për përfshirjen edhe të disa kategorive në pagën minimale, e kategoritë të cilat u përmenden me të drejtë nga kolegët deputetë, pa dashur të bëj politikë, dhe asnjëherë pa menduar që ne sot po flasim për çështje elektorale kur përmenden veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Nuk mendoj që ka deputet këtu që sot shfrytëzon gjithë atë emër të rëndësishëm të veteranit që të bëjë politikë. Por, konsideroj sikurse veteranët, ashtu edhe të verbrit, personat dhe kategoritë e tjera që janë paraplegjikët e tetraplegjikët, të përfshihen në këtë kategorizim dhe s'po kërkon opozita asgjë më shumë e as më pak, por të ketë një trajtim pak më të mirë e më të drejtë nga Qeveria e Republikës së Kosovës në raport me këto kategori, dhe këtë u munduan ta thonë edhe kolegët e Partisë Demokratike të Kosovës.

Sidoqoftë, i nderuar kryetar,

Sot, nuk e mora fjalën të flas shumë për projektligjin ndonëse kisha disa komente nga diskutimet. Por, kam një çështje tjetër që tërthorazi e pashë në diskutimet e kolegëve të Lëvizjes Vetëvendosje.

Në këtë kohën e fundit është vënë një tendencë e hapur e partisë në pushtet që t'i mësojë gazetarët, të cilët sot i kemi lart se si të raportojnë, se si t'i quajnë gazetarët të lidhur me disa

parti në fjalë, se si këta gazetarë cilësohen si ndërmarrje e përbashkët kriminale. Herë cilësohen si kompani të kriminalizuara.

Përderisa gazetarët u bëjnë pyetje ministrave nëse motrat ose vëllezërit e tyre janë punësuar në ndonjërin prej ministrive, ministri i kësaj Qeverie i quan, budallaqe pyetjet e tyre.

Të shkoj edhe më tutje. Zoti kryetar i Kuvendit, duhet të flisni hapur me deputetët që sot edhe në këtë Parlament synojnë që ta ndalin fjalën e lirë të mediave të cilat ne për çdo ditë i kemi këtu, dhe pa këto nuk jemi të gjallë politikisht e as si përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Zëri ynë dëgjohej përmes tyre atje.

Nuk është në rregull që sot diskutimet e kolegëve të atakojnë mediat, sepse e thashë, kjo Qeveri në vazhdimësi, duke tentuar të minojnë kritikën, sulmin gjatë gjithë kohës e adreson tek ata atje lartë.

Prandaj, duke qenë njëra prej gazetarëve që ka punuar një kohë të gjatë në media, ju lus zoti kryetar që të kontribuoni sadopak, jo për t'i edukuar deputetët, mendoj që janë mjaftueshëm të ditur të edukuar, sa të mos cenojnë fjalën e lirë. Shihni raportet e fundit për Kosovën në raport me median, shihni Reporterët pa Kufi. Shihni Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit se çfarë thotë për lirinë e medias sot në Kosovë. Si atakohen e sulmohen gazetarët, si linçohen e fyhen, si ky pushtet, po e them, provon që të minojë çdo zë kritik nga mediat e lira.

Dhe unë e kuptoj mazhorancën kur akuzon opozitën, tash mos e drejtoni gishtin gjatë gjithë kohës edhe tek ata që po mundohen ta bëjnë një punë të mirë që ne të jemi më afër qytetarëve e të flasim për politika të cilat prekin qytetarët e Republikës së Kosovës.

Dhe për fund, po i referohem vetëm të dhënave të fundit, sepse para disa ditësh kemi pasur, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e ka pasur ditën ndërkombëtare që objekt trajtimi e ka pasur pikërisht lirinë që sot e kanë mediat në Kosovë.

Dhe nëse i shohim vetëm statistikat e sulmeve, më 2019 i kemi pasur 21 raste të sulmeve ndaj gazetarëve, më 2020, 24 raste, ndërkaq më 2021 Kosova shtet i pavarur i ka pasur 29 raste të sulmeve të ndaj gazetarëve. Prandaj, po kërkoj korrektësi dhe po kërkoj që kolegët e mi të jenë të vëmendshëm në raport me sulmet e pareshtura që sot po i bëjmë në drejtim të medias së lirë.

Mendoj që është në shërbim të shtetit tonë demokratik, e në shërbim të një Kosove që aspiron integrimin në fusha, mekanizma ndërkombëtarë.

KRYETARI: Fjalën ia japim deputetit të fundit që është për diskutim në këtë seancë, Isak Shabani. Por, ju lutem që t'i qëndrojmë temës për të cilën po flasim. Është sjellë në Kuvend një projektligj për të cilin po bisedojmë.

Ju lutem, regjia! Isak Shabani është një deputet i Kuvendit të Kosovës dhe po dëshiron të flasë.

ISAK SHABANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky projektligj është për Qeverinë, e jo për qytetarët. Me një projektligj ndryshon një grup ligjesh pa kurrfarë kriteri. Kjo nuk ndodh në sisteme demokratike, një gjë e tillë mund të ndodhë vetëm në sistemet autoritare.

Me Ligjin e punës, në nenin 57, paragrafi 1, Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomik Social. Pra, me ligj përcaktohet që Këshilli Ekonomik Social, në të cilin kanë përfaqësim të barabartë Qeveria, bizneset dhe sindikatat, të bëjnë propozimin për ndryshimin e pagës minimale.

Një këshill duhet të merret vendimi në rastin konkret për shkak të pakënaqësive me propozimin e Qeverisë, vendimi nuk është marrë. Kryeministri nuk ka gjetur mirëkuptim të propozojë pagën minimale sipas ligjit, por ka marrë vendim arbitrar të ndryshojë një numër të ligjeve e të realizojë vendimin e tij për pagën minimale që bie në kundërshtim me kërkesat e partnerëve ekonomikë e socialë.

Sindikalistët nuk kanë kërkuar asgjë më shumë se atë që ka premtuar kryeministri gjatë viteve kur ka qenë në opozitë dhe gjatë fushatave zgjedhore, kur i mashtronte qytetarët, sindikalistët dhe të punësuarit se ata do të gjejnë mbështetje te Qeveria që ai do të udhëheqë.

Në këto rrethana, kur inflacioni ka ngritje marramendëse në produktet jetike për jetesë, kur çdo ditë e më shumë të punësuarit po shndërrohen në raste sociale, ju dhe Qeveria juaj propozoni pagën minimale 250 euro, pa kurrfarë koordinimi me partnerët socialë. Prandaj u bëj thirrje të gjithë deputetëve të mos e votojnë këtë projektligj për shumë arsye.

Ky projektligj nuk duhet të votohet sot, sepse propozimi nuk është bërë sipas Ligjit të punës dhe Ligjit të KES-it, Këshillit Ekonomik Social, i cili definon qartë se si bëhet propozimi për pagën minimale.

Nuk duhet të lejojmë që të kalojë ky ligj, i cili është në mospajtim me sindikatat dhe në kundërshtim me Ligjin e punës dhe KES.

Ky projektligj nuk duhet të votohet, sepse nuk është ngritur paga minimale varësisht nga rritja e pagës mesatare në sektorin privat dhe me lëvizjen e kostos së shportës familjare, siç ka premtuar vetë kryeministri, por t'i mashtrorë punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre për votë.

Ky projektligj nuk duhet të miratohet, sepse i ndryshon ligjet që shkëpusin pagën minimale nga skema pensionale dhe nuk duhet lejuar që me këtë ligj të ndryshohet Ligji i punës e t'i lejohet Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Financave, pa kurrfarë konsensusi me përfaqësuesit e të punësuarve në sektorin privat dhe publik të vendosë për pagën e mijëra të punësuarve.

Nuk duhet lejuar të merret vendime autoritare për personat me aftësi të kufizuara, si të verbrit, personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Nuk duhet lejuar të kalojë ky ligj që lejon një ministër të luajë me fatin e kategorisë më të ndjeshme e shumë meritore të shoqërisë tonë, siç janë veteranët dhe invalidët e luftës.

Kryeministri kishte premtuar kur kërkonte votën e qytetarëve për të bërë kryeministër, në një tryezë të organizuar me përfaqësues të Sindikatave të Kosovës se me të marrë pushtetin, ai do të fillojë një dialog social para marrjes së vendimit për rritjen e pagës minimale. Le që nuk e filloi dialogun social, po injoroi, i fyeu, i poshtëroi organizatat sindikale të Kosovës. Dhe, në fund, me veprimin e tij sot, me këtë projektligj po u thotë 'unë jam këtu, nuk ju pyes fare, bëj çka dua dhe e ndryshoj ligjin kur e dua dhe nuk qaj kokën për ju'.

Të punësuarit sidomos në sektorin privat nuk po kërkojnë asgjë më shumë, vetëm atë që u ka premtuar kryeministri, pagën minimale 350 euro. Ata u kanë besuar deklaratave të tij se nuk do të ketë pagë nën 350 euro dhe sot po ndihen të mashtruar e të tradhtuar nga Qeveria.

Rritja e pagës minimale me ligjet ekzistuese automatikisht i rrit pensionet e veteranëve, të personave me aftësi të kufizuara, gjë që nuk ndodh me këtë projektligj.

Në këtë projektligj ndryshon Ligji për veteranët e UÇK-së, ndryshon neni 16 a, nënparagrafi 3.1, ku përcaktohet se deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranëve të Luftës së UÇK-së skema pensionale zbatohet siç është paraparë me ligjin bazik.

Bazuar në nenin 8 të ligjit bazik për veteranët e Luftës së UÇK-së pensioni i veteranit luftëtar të UÇK-së nuk mund të jetë më i vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë.

Mbështetur në ligjin bazik dhe në plotësimin e ndryshimin e Ligjit për veteranët luftëtarët e UÇK-së, me ndryshimin e pagës minimale, duhet të ndryshojë edhe pensioni mujor i veteranëve.



Sipas këtij projektligji që është në shqyrtim, pensioni nuk i referohet pagës minimale, por veteranët mbesin në mëshirën e ministrit të Financave se çfarë propozimi do t'i japë Qeverisë për të përcaktuar pensionin e tyre.

Ky projektligj që na ka ardhur për votim i diskriminon veteranët derisa të bëhet kategorizimi i tyre siç e parasheh ligji.

Neni 2, paragrafi 2.1 i këtij projektligji thotë: “Deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranëve luftëtarë të UÇK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës në propozimin e Ministrisë së Financave vendos për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual”. Pra, fshij nenin 16.a, nënparagrafin 3.1, i cili referohet ligjit bazik që pensioni i veteranit nuk mund të jetë nën pagën minimale.

Pyetje: Cili do të jetë pensioni mujor i veteranit të luftës? Mundësitë buxhetore janë, kostoja e jetesës është shumë e lartë, inflacioni përditë e më shumë po rritet. A do të vazhdoni lojën tuaj në raport me këta njerëz meritore për lirinë e vendit tonë dhe meritore për të qenë ju sot këtu në Qeveri edhe ne si deputetë në Kuvendin e Kosovës.

Nuk është mirë që mirëqenia e kësaj kategorie të djeshme të shoqërisë tonë të mbetet në dëshirën e një ministri për të bërë apo jo propozimin, përcaktimin e pensionit të dinjitetshëm për ta.

Neni 3, paragrafi 2 i këtij projektligji ndryshon edhe Ligjin për persona të verbër dhe në këtë nen thuhet se Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Financave vendos për lartësinë e shumës së kompensimeve për personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj varësisht nga mundësitë buxhetore dhe kostoja e jetesës.

Ky nen e ndryshon nenin 7, paragrafin 2 të ligjit bazik ku thuhet: “Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë”. Cili do të jetë kompensimi për personat e verbër, a do të marrin 170 euro apo 250 euro, pse paga minimale që keni caktuar ju nuk vlen për persona të verbër dhe pse është refuzuar kërkesa e personave të verbër për të marrë pension kontributdhënës.

E njëjta gjë ka ndodhur edhe me një kategori të ndjeshme të shoqërisë tonë, personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe nga memorandumit shpjegues kujtojmë që nuk është marrë parasysh asnjë rekomandim i tyre.

Me këtë projektligj ndryshohet edhe Ligji i tatimit në të ardhurat personale. Partia Demokratike në vazhdimësi ka kërkuar të bëhen ndryshime në politika fiskale në këto rrethana krize. Ne edhe

sot kërkohet që të bëhet ndryshimi i pakos fiskale në radhë të parë uljen e TVSH-së për produkte esenciale të konsumit familjar, rishikimit të akcizës së derivateve dhe të mos ngrihet çmimi i rrymës pa kurrfarë kriteri dhe në dëm të qytetarëve.

Me këtë ndryshim që është bërë në Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale, Partia Demokratike nuk pajtohet, sepse nuk ndikon asgjë në përmirësimin e jetës së qytetarëve që kanë pagat e ulëta.

Qytetarët e Kosovës presin që të miratoni një pako fiskale që do të mbështesë rritjen ekonomike, stabilizimin ekonomik dhe uljen e pabarazisë sociale, sepse kështu keni premtuar dhe, në fakt, i keni mashtruar qytetarët.

Nuk pajtohem as me ndryshimin e Ligjit të punës në pjesën që ka të bëjë me pagën minimale, sepse është kaluar mandati për propozimin e pagës minimale te Ministria për Financa, në rast se nuk arrihet një konsensus me KES. E konsideroj shumë të rëndësishme konsensusin me KES-in dhe nuk e shohim të arsyeshme kalimin e këtyre kompetencave për propozimin e pagës minimale nga ministri i Financave.

Të nderuar deputetë,

Kryeministri ka premtuar se me të bërë kryeministër paga minimale do të bëhet për sektorë të ndryshëm dhe do të rritet varësisht nga zhvillimi ekonomik. Na ka lodhur duke proklamuar se ka rritje ekonomike në qeverisjen e tij, kjo rritje nuk po reflekton në jetë në të mirë të qytetarëve, po në fakt, ka varfëruar qytetarët dhe ka vënë përballë vështirësive të jetës përditë e më shumë. Ka thënë se paga minimale duhet të bëhet në bazë të orëve të punës, e jo ditëve të punës. Ka premtuar se do të krijojë Gjykatën e Punës dhe t'i mbrojë punëtorët për të fuqizuar sindikatat. Kjo nuk ka ndodhur dhe nuk po ndodh, përkundrazi sindikatat janë anashkaluar dhe janë injoruar.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike, siç thanë kolegët paraprakë, nuk do të përkrahim këtë projektligj dhe i ftojme të gjithë deputetët të mos përkrahin një projektligj të tillë dhe të mos i përkrahim politikat që dëmtojnë kategoritë e ndjeshme të shoqërisë tonë. Faleminderit!

**KRYETARI:** U lajmërua edhe Enver Haliti për fjalë.

**ENVER HALITI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Në këtë debat sot u fol për gjithçka, vetëm për pagën minimale nuk u fol, nuk u trajtua seriozisht nga shumica e deputetëve të opozitës.

Premtimet që janë dhënë nga Qeveria Kurti po dëshirojnë që të realizohen brenda një viti, nuk po i pritët opozitës.

Nëse ndalesh edhe i analizon fjalimet e tyre thuaja se Lëvizja Vetëvendosje ka qeverisur përgjatë 20 vjetëve të kaluara, ekzaltohen nga fjalimet e tyre për kategoritë e veteranëve të luftës, për kategoritë sociale, për të cilat asnjëherë nuk e kam pasur respektin dhe trajtimin që ata meritojnë.

Vetë me ligje që i kanë votuar në këtë Parlament, opozita e sotme që dje ka qenë në pozitë, i ka caktuar këto benefite, i ka caktuar edhe kriteret, ua ka ndaluar edhe mundësinë që ai veteran, i cili ka një marrëdhënie pune, që ta shfrytëzojë këtë pagesë prej 170 euro. E lind pyetja këtu: Pse në vitin 2018, kur Këshilli Ekonomik Social ka propozuar që paga minimale të jetë 240 euro, pse qeveritë e kaluara nuk e votuan në Parlamentin e Kosovës? A mund të lindin dyshimet që pikërisht ato qeveri nuk kanë qenë të gatshëm që edhe veteranët të përfitojnë nga ajo rritje që ka propozuar Këshilli Ekonomik Social, për shkak se ka qenë e ndërlidhur me Ligjin për veteranët, neni 18, me pagën minimale.

Vetë këta individë, këto parti politike në vitin 2017 e kanë ndryshuar Ligjin për veteranët dhe e kanë hequr nenin 18 që e lidh me pagën minimale në Kosovë. Ndërsa sot në fjalimet e tyre secili më shumë se tjetri shigjetat i drejtojnë nga Qeveria Kurti kinse kjo Qeveri ka bërë një diskriminim sa u përket veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në këtë ligj është qartë e specifikuar që ne po votojmë sot për pagën minimale që i prek hiq më pak se 40 mijë të punësuar në sektorin publik, të cilët për momentin kanë të ardhura të deklaruara në Administratën Tatimore nën pagën minimale. Do të thotë ky ligj e prek vetëm këtë kategori.

Qeveria dhe Ministria e Financave e kanë theksuar edhe në këtë projektligj që do të rregullohen me reforma të tjera që ka në plan, mirëpo jo vitin e parë, keni durimin. Do të trajtohen edhe kategori të tjera sociale, edhe veteranët e luftës, edhe personat paraplegjikë e tetraplegjikë, edhe të gjitha kategoritë, pensionistët e të gjithë të tjerët.

Mirëpo është po e njëjta parti politike që është në opozitë, Lidhja Demokratike e Kosovës që dy herë radhazi nuk e voton një projektligj, i cili ka për qëllim reformën sociale, ku është një projekt i cili do ta garantojë përfshirjen e të gjithë personave që kanë nevojë për përkrahje sociale dhe do të ndërtohej sistemi.

Është e dyta herë që Lidhja Demokratike e Kosovës veton kundër asaj marrëveshjeje, nuk lejon.

E ka thënë qartazi ministri i Financave, do të ketë edhe reformë pensionale, ku do të merren me secilën kategori që janë në Kosovë, mirëpo mos pritni që gjatë një viti të parë qeverisës do të ndodhin të gjitha këto, secila në kohën e vet dhe në vendin e vet.

Thanë që do ta votojnë nga Partia Demokratike këtë projektligj nëse nuk është diskriminues, po diskriminimi ka ndodhur nga ju, të nderuar, a nuk ka ndodhur diskriminimi deri tani me kategoritë e luftës, e sidomos me veteranët. Pse i keni lejuar veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të shndërrohen në raste sociale? Ku ishit deri dje? Cila Qeveri është marrë seriozisht me ta, cila Qeveri është marrë me trajnimin e tyre dhe përgatitjen dhe aftësimin e tyre për të qenë të aftë për punë dhe të zgjidhë statusin e tyre social. Pse i keni lejuar veteranët të jenë kategori e rasteve sociale? Unë nuk besoj që turp më të madh dhe degradim më të madh për veteranë që ka ndodhur që të mesin si kategori sociale. E sot po kërkon që brenda një viti të zgjidhen të gjitha, do të zgjidhen, mirëpo jo vitin e parë, secili rend me rend. Faleminderit!

KRYETARI: Abelard, ke kërkuar replikë lidhur me këtë që tha zoti Haliti.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit! Qeverisjet e Partisë Demokratike të Kosovës besoj i kanë prekur secilin deputet që është prezent.

Dhe probleme të tilla çfarë po diskutojmë sot në kohën sa ka qeverisur Partia Demokratike nuk ka pasur, aq më pak degradime të tilla nuk ka pasur.

Prandaj, asnjëherë në asnjë Qeveri nuk janë trajtuar me dinjitet veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës se sa prej Qeverisë së Partisë Demokratike, sepse në fund të fundit, ajo edhe e ka etabluar edhe çështjen e përkrahjes financiare ndaj tyre, e cila sot me standardin të cilin po jetojmë dhe me shtrenjtimin të cilën e kemi përjetuar dhe po e përjetojmë çdo ditë e më shumë është i pamjaftueshëm. Prandaj, edhe inflacionin duke pasur për bazë, edhe shtrenjtimin e çmimeve si rezultat i shumë faktorëve të jashtëm, këto janë të pamjaftueshme.

Pra, sot ju jo që s'po avanconi në këtë drejtim, po përkundrazi po degradoni. Pra, përderisa po doni që ta ngrini pagën minimale, edhe atë pa një dialog social, ju në anën tjetër edhe në këtë ngritje keni vendosur t'i anashkaloni veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj, unë i kërkoj ministrit të Financave si kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ta tërheqë këtë projektligj, t'i bëjë përmirësimet të cilat po i kërkojmë si grupe parlamentare të opozitës dhe pastaj, përmes një dialogu social, ashtu siç është e paraparë edhe aktualisht me ligj, të arrihet kompromisi për pagën minimale në Republikën e Kosovës. Ne i dimë kushtet tona edhe nuk mund të kërkohej diçka që është e paarritshme, po në anën tjetër, nuk mund të shkohet edhe në një drejtim në një formë çfarë po do me çdo kusht Qeveria e Republikës së Kosovës që duke i anashkaluar faktorët që i ka në këtë proces, të vendosë vetë për pagën minimale, sepse është e papranueshme dhe është e patolerueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe Hisen Berisha, një replikë për këtë që e tha zoti Haliti.

HISEN BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Unë i dëgjova disa që folën pas fjalës sime. U tha atje pse i keni lënë e qysh i keni lënë, askush s'është duke e lavdëruar punën e të kaluarës. Është realitet se paga apo pensioni i veteranëve ka qenë mbi nivelin e pagës minimale që do të thotë ka qenë brenda normës së ligjit. E të flisja me atë gjuhë atje, se unë jam pak pigment i bardhë, isha bërë më i kuq se kjo drita e mikrofonit tim, kur provoj të them prapë ose të spekuloj brenda normave, se neni 16, linja 3, pika 1 e thotë qartë 'se mbetet në fuqi neni 18 derisa nuk përfundohet Ligji për kategorizimin e veteranëve'.

Pra, ne jemi duke folur qartë dhe nuk e kemi me kurrfarë tendence, as të përfitojë patriotizëm, se ne periudhën e patriotizmit e kemi kryer, as të përfitojmë, se edhe këta kategoria e veteranëve nuk janë aq shumë. Ju po thoni 60 mijë, po 38 mijë marrin pagë, dhe ata besoj që kanë rënë, se unë veç këtë viti që iku, në fakt, diku kam marrë pjesë në nja 17 a 20 varrime veteranësh, që do të thotë se jemi duke spekuluar me një kategori që duhet respektuar e nderuar, e jo të përdoret për gjuhë debati këtu, për diçka që flet ligji, jo ne, jo emocionet, jo përkatësia, e tjera. Lexoni me kujdes dhe të reflektojme mbi këtë kategori, për të pavërtetat që po mundoheni të parafrazoni, po ju garantoj se këta që janë futur në ato lista janë njerëzit që kanë pasaktësi në informacione, kurse spekulantët, për të cilët jam i gatshëm t'i vihem në shërbim kryeministrit deri sa t'i zbulojmë krejt, e çdo komisioni, sepse jam kundër qenies së tyre. Kurrë s'mund t' i kapësh, sepse ata kur e kanë bërë spekulimin, e kanë bërë nëpër rrugë korruptive dhe atë strukturën komanduese, informacionet në aplikacione i kanë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Fillimisht po ia japim fjalën Armend Mujës, ia kemi borxh një replikë, sepse nuk e kam vërejtur, e ka pasur me Isak Shabanin një replikë, disa pretendime që janë ngritur në fjalimin e tij.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar,

Në fakt, desha t'i jap disa sqarime, sepse e shoh që ka mosbesim, dikush e tha s'ka rrogë minimale, jo s'ka rrogë sot 130 euro, është mirë të sqarohemi që 40 mijë qytetarë të Kosovës që raportohen në ATK e kanë rrogën 130 euro, ose nën të, vërtet ekziston kështu. Nja 88 mijë e kanë nën 170 euro, dikujt po i duket e pabesueshme, po vërtet këto të dhëna i ke në ATK dhe paradoksi është që diku 120 mijë veta që e kanë rrogën e vogël, është përdorur si arsyetim mosrritja e pagës së tyre, sepse ka qenë e lidhur me veteranë. Pra, për 38 mijë është dëmtuar mirëqenia e 120 mijë personave.

Ajo çka ne kemi thënë, zoti kryetar, është kështu: Ta rritim pagën minimale, ta heqim këtë ngërç, sepse lidhja është shkëputur që më herët dhe, e dyta, të punojmë paralelisht, ta studiojmë se sa ka nevojë ta kenë veteranët, çfarë kategorish duhet të ketë dhe çfarë pastrimi duhet të ketë. Për këtë e kemi propozuar edhe një marrëveshje ndërkombëtare me Bakën Botërore prej vitit 2019, aty

është paraparë edhe rritje e skemave, edhe reformimin, edhe adekuatshmëri e pagesave, vetë jam angazhuar me mish e me shpirt të diskutojmë me të gjithë deputetët e opozitës, se për këtë po bëhet fjalë, ky projekt është për veteranët, për pensionistët, për fëmijët dhe, në fund u refuzua javën e kaluar pikërisht nga opozita, pa ndonjë arsytim.

Dhe tjetra është, për veteranët. Ne e kuptojmë, neve po na tregohet diçka që e dimë, nuk është pagesë e mjaftueshme, por dy herë, edhe në nëntor, edhe në dhjetor 2021, edhe tash në prill, çdo mundësi që e ka pasur buxheti i Kosovës e kemi shfrytëzuar për familjet e dëshmorëve, për veteranët. Prej vitit 2016 atë pagesë e kanë pasur, e vetmja rritje ka ndodhur gjatë këtij viti që është me Qeverinë Kurti, e dimë që nuk është mjaft, por neve na duhet një shtegdalje dhe për këtë arsye i lus deputetët e opozitës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Hykmete Bajrami, replikën e keni me Enver Halitin, me siguri, apo?

**HYKMETE BAJRAMI:** Po, faleminderit, kryetar!

Është e vërtetë Enver Haliti nuk ma ka përmendur emrin, e ka përmendur Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe lidhur me mosvotimin tonë për marrëveshjen financiare për kredinë, e cila mundëson reformën sociale.

Ju lutem, mos manipuloni, nuk e ka rrëzuar LDK-ja një marrëveshje të tillë, LDK-ja i ka 14 deputetë në këtë legjislaturë, jeni ju 58, LDK-ja nuk voton kundër parimeve të veta, kemi thanë që nuk votojmë të marrim kredi huamarrje 20-vjeçare për shpenzimet operative, për të blerë ju simpatinë e qytetarëve. Punoni, bëni punë konkrete. Ne i votojmë të gjitha marrëveshjet financiare, të cilat kanë të bëjnë me investime kapitale. Mirëpo, ju të nderuar, mbani deputetët në sallë, 58 jua ka dhënë populli, qytetarët e Kosovës jua kanë dhënë 58 deputetë në këtë sallë, nuk arrini t'i keni në sallë.

Mos harroni, kur LDK-ja ka qenë një kohë në Qeveri, e ka kaluar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, marrëveshjen e parë kontraktuale me BE-në dhe ju nuk e keni votuar një gjë të tillë, po ne nuk e kemi rrëzuar, nuk kemi dalë të themi s'po e voton Vetëvendosja, po i kemi mbledhur votat me grupet e tjera.

Andaj, mbështetjen e të tjerëve e keni, mos i nxirrni marrëveshjet në votim kur s'i keni deputetët këtu dhe mos pritni punën tuaj si Qeveri me 51% të votave ta kryejnë të tjerët.

Edhe një herë, LDK-ja kundër parimeve të veta nuk voton, po LDK-ja nuk mund ta stopojë një Qeveri të 51%-shit t'i përmbushë premtimet e veta, se keni premtuar që bëni mrekulli, urdhëroni,

tregojuni qytetarëve dhe mos e fajësoni LDK-në dhe mjaft më me 20 vjetët e kaluara, për shkak të 20-vjeçarit të kaluar qytetarët ju besuan, jua dhanë 51%, urdhëroni, vazhdoni punën.

KRYETARI: Tash po lajmërohen edhe të tjerë. Besnik, kush, më fal, Armendi. Mirë urdhëro!

BESNIK TAHIRI: Në qoftë se mund t'i bëj disa sqarime. Pak më saktë.

Ne të gjithë jetojmë në Kosovë dhe ne e dimë që pagën më të vogël në sektorin privat e kanë punëtorët e sigurimit fizik, respektivisht sigurimi. Sot e kam pyetur, kam shkuar në Komunë të Prishtinës, e kam pyetur njërin prej punëtorëve sa e ke rrogën, më tha e kam rrogën, i marr neto 230 euro, janë 250 euro, kjo është paga më e ulët.

Në një spital privat kam pyetur personalisht, e kishin 280 euro, rroga e një punëtori fizik sot në ditë paguhet 25 euro, pra ju lutem, në qoftë se mund të sqaroj edhe një herë.

Mbi bazën e këtij kriteri të Ligjit të punës, të këtyre katër kriterëve, siç thashë më herët, e para është kostoja e shpenzimeve jetësore, të tjerat s'po i përmend, kjo pagë minimale nuk është ngritje. Ne po kërkojmë, së paku Grupi ynë Parlamentar po kërkon prej zotit Murati që në këtë temë të ketë guxim të shkohet më lart, që 400 s'po bëka, mirëpo të trajtohet mënyra, për shkak se kjo pagë minimale sot nuk është rritje, për shkak se kjo pagë është në të gjithë sektorët, të mos i numëroj sektorët një me një, e para.

E dyta, kur flasim për aspektin që ndërlidhet drejtpërdrejt me pozicionin e opozitës, shikoni të sqaroj, Grupi Parlamentar, se që 2-3 herë thotë opozita zoti Muja. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka votuar programin e skemës sociale në komision, që ku është Hekuran Murati, le të thotë ndryshe dhe në seancë, në të dy votime që ka...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: A po të nevojitet edhe një minutë, zoti Tahiri? Urdhëro!

BESNIK TAHIRI: Pra, ne e kemi votuar dhe e votojmë, se ne mendojmë që kjo reformë është e rëndësishme, përkundër faktit që bëhen disa konsulenca apo çka di unë programe në këtë temë, po pjesa tjetër është shumë e rëndësishme se kemi aq shumë skema sociale që i kemi barrë, shteti është bërë barrë e skemave sociale.

Andaj, unë kërkoj që ta shihni prej kësaj perspektive, perspektiva është shumë e thjeshtë, jemi duke folur për disa kategori që kur ta marrim shumicën, nuk është pjesë e madhe dhe aty të mundë të rirregullojmë pagën minimale që i bien se është në rregull me nenin 18 me Ligjin e veteranëve dhe tema të tjera. Kjo është krejt çka kemi thënë dhe mos e devijoni, ju lutem.

KRYETARI: Ia japim edhe 60 sekondat e fundit Armend Mujës dhe të përmbylim, sepse fjalën e ka Qeveria pastaj.

ARMEND MUJA: Po, kryetar, në fakt unë nuk e thashë që AAK-ja ka votuar kundër, në fakt edhe në komision, edhe në Kuvend, duhet të jem korrekt, kanë qenë korrektë sa u përket marrëveshjeve ndërkombëtare.

Çështja kryesore është sa u përket parimeve, në Marrëveshjen me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të shtatorit 2020 është paraparë ky grant me Bankën Botërore, nuk kemi qenë ne në qeverisje atëherë, ky projekt ka filluar prej vitit 2019, është diskutuar, Banka Botërore ka diskutuar me të gjitha palët e interesit, sepse kërkohet marrëveshje 2/3, nuk mjaftojnë votat e Vetëvendosjes për t'u votuar një marrëveshje ndërkombëtare.

Edhe një herë po ju lus, t'i kthehem edhe një herë parimit për çështje që na prekin të gjithëve dhe politika sociale dhe skema sociale na prekin të gjithëve, ka nevojë për konsensus dhe një mënyrë e vetme ishte ky projekt. Dhe unë mendoj që ne nuk duhet të heqim dorë nga kjo, vetëm në fakt se ka humbur dikush zgjedhje ose jo, nuk duhet ta sabotojmë përpjekjen për të fituar këto kategoritë shoqërore që...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Baza e kundër-replikës tënde e preku replikën e zonjës Bajrami, ia japim 60 sekonda edhe asaj, për të qenë korrekt deri në fund.

HYKMETE BAJRAMI: Më fal, kryetar, Nuk kam për të shtuar diçka, ajo krejt çka mund të them është që ne jemi 14 deputetë, prapë po e them, Kuvendi i ka 120 deputetë, mblidhi deputetët në sallë, grupet e tjera po të përkrahin, mos e vë fajin te Lidhja Demokratike e Kosovës. E them edhe një herë, e kemi votuar, do ta votojmë secilën marrëveshje për investime kapitale të huamarrjes, por nuk mundemi në kohën kur ju vetë, zoti Muja, krekoseni për të hyrat buxhetore dhe rritjen e tyre, ne të marrim kredi për përmirësim të bilancit bankar, sepse nuk është në rregull.

Në kohën kur ju i referoheni, atëherë ka qenë pandemi, kemi pasur periudha të mbylljes totale dhe situata është komplet ndryshe sot në vitin 2022 me atë çfarë ka qenë në vitin 2020. Andaj, nuk mund t'i referoheni një gjëje të tillë, kështu që mos vazhdoni të akuzoni, po punoni, ju lutem, punoni!

KRYETARI: Po ia japim fjalën edhe zotit Avdullah Hoti, meqenëse fjala e zotit Muja kishte një vendim, i cili u mor gjatë Qeverisë, në të cilën ministër i Financave ka qenë zoti Hoti.



AVDULLAH HOTI: Të faleminderit, kryetar!

Si marrëveshje mund të jetë iniciuar në qeveritë paraprake dhe është iniciuar nga qeveritë paraprake, por është negociuar nga kjo qeverisje. Në funksion të informimit të drejtë të opinionit publik, sepse kolegët deputetë, të komisionit në veçanti, e dinë saktë se për çfarë bëhet fjalë.

Një marrëveshje që është 47 milionë euro, prej të cilave nja 6 milionë janë për konsulencë të ndryshme, për zhvillim të kritereve, e tjera, e tjera. 15 milionë janë për ta përmirësuar bilancin bankar për disa pagesa që janë bërë në fillim të vitit 2021, edhe nja 15 milionë a 17 milionë pjesa tjetër, është të lihen aty që kur të fusim skema të reja sociale, të paguhet për nja një vit skemat e reja sociale. Kaq.

A kemi ardhur në gjendje, si shtet, si Qeveri, që ne të marrim kredi nga banka...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Ma merr mendja që e kuptuam argumentin. 60 sekondat e fundit për zotin Muja dhe po shkojmë me fjalën e Qeverisë, sepse me të vërtetë e zgjatëm shumë.

ARMEND MUJA: Mirë, dakord atëherë, në njëfarë mënyre, sepse çdo ditë po implikohet se po thuhet nga opozita “kriza është tash sikur në kohën e pandemisë”, mund t’iu referohem edhe deputetët nga opozita që kanë folur kështu. Dhe, nëse qenka kështu, po jua jap një rast që ky projekt ka qenë vazhdimësi e një projekti të Bankës Botërore, në atë kohë Hekuran Murati tash është ministër, e ka mbështetur LDK-në, një marrëveshje të ngjashme për skema sociale në vitin 2020, dhe është implementuar deri në mars të vitit 2021.

Edhe atëherë Hekuran Murati dhe ne kemi pasur probleme, e kemi kapërcyer vetveten, për hir të qytetarëve e kemi mbështetur atë marrëveshje. Edhe një pjesë e kësaj marrëveshjeje është vazhdimësi e mbështetjes COVID, emergjenca e Covidit.

Dhe tjetra është sa i përket konsulencës. Shiko, në indicie fillestare marrëveshja për konsulencë ka qenë, tash është dy milionë, nuk është shtatë milionë, por në fillim, drafti fillestar ka qenë 4,7 milionë. Në fakt, ne e kemi zvogëluar atë, sepse nuk po bëhet pa konsultim...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Nuk na takon më ta vazhdojmë diskutimin. Kanë përfunduar të gjitha ato, përveçse nëse e shkelim Rregulloren, por po zgjatet shumë pastaj. Kështu që, do t’ia jepja fjalën zotit Çeku. Ka pasur nevojë për një ndërhyrje lidhur me një fjalë të mëhershme të deputetes Blerta Deliu, me siguri.

HAJRULLAH ÇEKU: Faleminderit, kryetar!

Është vetëm një sqarim lidhur me një pasaktësi që u tha më herët në raport me vlerësimin për lirinë e medias.

Po i citoj vetëm katër raporte ndërkombëtare, nuk po flas për raporte të Qeverisë, as për qëndrimet tona, por për vlerësime ndërkombëtare nga organizata kredibile në raport me lirinë e medias, demokratizimin, luftimin e krimit dhe korrupsionit dhe për nivelin e zhvillimit demokratik në vend. Dhe, po e citoj një letër të 81 organizatave të Shoqërisë Civile, e cila është dërguar para disa ditësh te presidenti Macron në lidhje me liberalizimin e vizave për Kosovën. Pra, është letër e organizatave ku citohen këto raporte.

Kështu thotë letra: “Vitin e kaluar Kosova rikonfirmoi pjekurinë e saj demokratike me zgjedhje shembullore dhe tranzicion të lehtë të pushtetit. Që atëherë Kosova ka bërë përparim të qëndrueshëm në të gjitha frontet. Përpjekjet e Kosovës në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë vënë në dukje nga Transparency International.

Në raportin e saj të fundit Kosova ka bërë përmirësimin më të madh vjetor në histori. Ngjashëm, Kosova ka bërë përmirësimin më të madh vjetor në histori dhe është renditur më lart se asnjëherë më parë sa i përket cilësisë së demokracisë së saj, sipas raportit të fundit të Freedom House. Në këtë aspekt nuk ishte befasi kur disa ditë më parë Reporterët pa kufi publikuan renditjen më të lartë të Kosovës në dhjetë vjetët e fundit. Me pak fjalë, vendi ynë sot është më i lirë e më demokratik, se kurrë më parë dhe kjo është pjesërisht arsyeja pse Kosova shënoi vitin e kaluar numrin e dytë më të ulët të azilkërkuesve në BE nga të gjitha vendet e rajonit, sipas Eurostat-it”.

Pra, janë raporte ndërkombëtare. Nuk është qëndrim i Qeverisë, nuk janë raporte tona, janë raporte ndërkombëtare. Kur ju referoheni këtyre raporteve, ju lus për korrektësi dhe për besnikëri ndaj fakteve. Kaq, asgjë më shumë. Janë raporte ndërkombëtare, të cilat për më tepër janë cituar nga 81 organizata të Shoqërisë Civile, më kredibilet që i kemi këtu, në letrën që ia kanë dërguar presidentit Makron në lidhje me çështjen e vizave.

Por, është edhe një raport ndërkombëtar që doli para disa ditësh, pasi që u dërgua kjo letër nga organizata të Shoqërisë Civile, nga Fondacioni për Inovacion Politik me bazë në Francë që bën matjet e çështjeve politike, ekonomike dhe sociale në botë.

Sipas këtij raporti, prapë as qëndrim i Qeverisë, as raport i Qeverisë, vetëm raporte kredibile ndërkombëtare. “89% e qytetarëve të Kosovës ndjehen se mund të shprehen lirshëm. Është ndër vendet e para në Evropë. 79% e qytetarëve të Kosovës ndjehen se ndryshimet mund të bëhen nëpërmjet votës, siç edhe ka ndodhur. Dhe, 73% e qytetarëve të Kosovës besojnë se demokracia funksionon në vendin e tyre”.

Kjo është lutja ime, edhe pse nuk e kisha ndërmend, por u keqcitua, për të mos përdorur ndonjë fjalë tjetër, raporti i Reporterëve pa kufij në raport me lirinë e medias dhe ky narracion, që kjo Qeveri është kundër mediave, ose që cenon lirinë e medias matet me organizatat kredibile ndërkombëtare që e bëjnë këtë punë. Dhe, kur u referoheni këtyre raporteve, ju kisha lutur t'u referoheni ashtu qysh ata e kanë nxjerrë Kosovën vitin e fundit.

A jemi aty ku duhet të jemi? Jo. Duhet të bëjmë edhe më shumë që t'i përmirësojmë këto parametra. Por, kur katër raporte ndërkombëtare dhe kredibile për lirinë e medias, për luftimin e krimit dhe korrupsionit, për demokratizimin, thonë që Kosova ka shënuar rritjen vjetore më të madhen në historinë e saj, të paktën rrini besnik fakteve dhe të dhënave të këtyre organizatave. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia japim fjalën ministrit Murati lidhur me projektligjin, për të cilin diskutuam disa orë, një fjalë përmbyllëse.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

U fol shumë dhe u diskutua shumë, shumë më pak ndoshta për temën, kishte edhe gjëra të tjera që u diskutuan gjatë këtij debati, apo diskutimi, mbi këtë projektligj që është prezantuar këtu. Por, konsideroj që si Kuvend duhet ta shohim se a jemi për ta rritur pagën minimale apo jo. Konsideroj se kjo është çështja që u shtrua sot këtu.

Domethënë, kemi një pagë minimale që është 130 euro, përkatësisht 170 për personat mbi 35 vjeç dhe çështja që po shtrohet këtu është: A mjafton kjo dhe a duhet të rritet? Po besoj që pati konsensus nga të gjitha grupet parlamentare që 130 euro dhe 170 euro nuk mjaftojnë, duhet të rritet. Pati grupe parlamentare nga opozita, që thanë se as paga prej 264 eurove bruto nuk mjafton dhe kërkuan që të shkojë edhe më lart.

Megjithatë, kërkesa që kemi ne si Qeveri është që diskutimet dhe kërkesat që i bëjmë, megjithatë t'i kemi të kornizuara brendapërbrenda koncepteve ekonomike, se fundja kjo është diçka që i përket fushës së ekonomisë dhe duhet të ketë parametra mbi të cilat caktohet, ka shembuj të shteteve në rajon, ka shembuj të shteteve në Evropë dhe janë disa përqindje në raport me pagën mesatare që ndiqen kur të përcaktohet paga minimale. Janë të gjithë ata faktorë që u përmendën, pra kostoja e jetesës, madje është edhe kushtet e punës, por edhe kushtet e tregut të punës.

Pra, në një vend ku ka papunësi të lartë, ku mosha e popullsisë është tepër e re dhe janë popullatë e re, të cilët ende nuk kanë arritur ta krijojnë përvojën e mjaftueshme që t'i rrisin aftësitë e tyre dhe të konkurrojnë me një pagë më të lartë, sepse megjithatë kushdo që ka aftësi, programerë, apo qoftë edhe në profesione apo zanate të tjera, as që e prek paga minimale. I kanë pagat 700 – 800 euro. E thanë edhe deputetë këtu, që ka kompani të cilët kërkojnë punëtorë të kualifikuar, por s'mund të gjejnë, sepse ka hipur çmimi i fuqisë punëtore.

Megjithatë, këtu po flasim për një minimum. Pra, bëhet fjalë për pagën minimale, e cila do të përcaktohet sipas orës së punës, pra edhe këtë duhet ta kemi parasysh. Sepse, në të kaluarën është përcaktuar si pagë mujore, por pastaj është abuzuar prej punëdhënësve, se janë detyruar punëtorët të punojnë 50 - 60 orë në javë, domethënë deri 50% më shumë sesa orari që është dashur të punojnë, siç parashihet me ligj, ndërsa janë paguar me pagën minimale fiks.

Unë me aq sa kam takuar nga përvoja personale, domethënë punëtorët që punojnë me pagë minimale, ata mezi presin që kjo të kalojë. Shpresa jonë si Qeveri ka qenë që kjo me mirëkuptimin edhe të Kuvendit, edhe të deputetëve, të kalohej me procedura të përshpejtuara dhe të ishte gati të hynte në fuqi, pra paga minimale, me datën 1 maj, kur edhe është Dita e punëtorëve. Pra, këtë kërkesë e kam bërë edhe në komisionin parlamentar, edhe në konferencë e kam prezantuar projektligjin e tillë, sepse është e rëndësishme që të lëvizet tutje me këtë çështje.

Pra, paga minimale duhet të rritet. A po bëhet mjaftueshëm, a po e përmbushim premtimin tonë? Konsideroj që po. Ne kemi premtuar, gëmi garuar me premtimin për 250 euro. Normalisht, që kjo nuk do të jetë fundi dhe nuk do të mbetet edhe njëmbëdhjetë vjet të tjera pa u ndryshuar. Pra, ligji e parasheh që kjo çështje të rishqyrtohet vit pas viti dhe të indeksohet edhe me inflacionin, me koston e jetesës dhe me indikatorë të tjerë. Por, fillimisht si start krahasuar me atë që e kemi tani, përbën rritje prej 100% për personat nën moshën 35-vjeçare dhe mbi 50% për personat mbi moshën 35-vjeçare. Domethënë, është rritje substanciale dhe normalisht që edhe tregut të punës i duhet kohë për përshtatje, se nuk është kjo çështje vetëm e dëshirës se sa po kemi qejf ta bëjmë pagën minimale. Është edhe çështje e indikatorëve ekonomikë, e kalkulimeve dhe pastaj edhe e zbatimit në terren.

Sa u përket çështjeve të tjera që u ngritën, po besoj u sqaruan tashmë, që shkëputja e pagës minimale nga pagesat për veteranët, pra nga pensioni i veteranëve, tashmë ka ndodhur që në vitin 2017, kur ky hyrë në fuqi ligji. Pra, është votuar në fund të vitit 2016, ndërsa ligji ka hyrë në fuqi në vitin 2017. Neni 18 i atij ligji është fshirë dhe aty parashihet që të ketë rikategorizim të veteranëve, madje-madje, nëse u referohemi shumave, e nëse po thuhet se 170 euro është e padinjitetshme për veteranin, aty në atë ligj çka është votuar, është që pensioni i një kategorie të veteranëve të jetë madje 120 euro. Pra, të ketë zbritje është paraparë. Dhe totali, tavani total është vendosur 0,7% e GDP-së dhe kjo ka ardhur si rezultat i fryrjes së listave, sepse fillimisht është hapur aplikimi, kur është parë se janë fryrë listat gjatë qeverisjes asokohe, ka ardhur si kërkesë pastaj që të vendoset një tavan, që kjo të mos tejkalojë në një abuzim me paranë publike, qysh edhe ka ndodhur.

Pra, tavani që ishte vendosur atëherë, parashihte që të jetë 0,7% e GDP-së. Po flasim për vullnete politike të subjekteve politike, deputetë të cilët e kanë ngritur dorën dhe kanë thënë “pagesat për veteranët duhet të jenë 0,7% e GDP-së”.

Asokohe, po supozoj se GDP-ja duhet të ketë qenë diku 6 miliardë euro, 0.7% i bie 42 milionë euro. Domethënë, deputetët e koalicionit qeverisës atëherë kanë ngritur dorën që pagesat maksimale për veteranët të jenë 42 milionë euro. Aktualisht, vitin e kaluar, nëse s'gaboj ka qenë 80 milionë, me gjithë shtesat që i kemi dhënë. Domethënë, dyfishi i asaj që është votuar në vitin 2016. Pra, si total është dyfishi, domethënë si buxhet, se po thuhet këtu që shteti nuk po bën për veteranët.

Shteti, qytetarët, solidarizimi ekziston. Pra, po jepen 80 milionë euro. Tjetër gjë që janë fryrë listat dhe kur pastaj ai 80 milionësh përpjesëtohet me listat e fryra, veteranët e vërtetë mbeten me më pak se që është dashur të marrin. Po, për neve është tepër e rëndësishme që t'i marrim gjërat një nga një. Pra, fillimisht, marrë parasysh koston e shtuar të jetesës, marrë parasysh vonesën në ndryshimin e pagës minimale, madje marrë parasysh edhe kërkesat tuaja, mua më kujtohet që duke filluar prej muajit dhjetor e tutje ka qenë kërkesë pikërisht e deputetëve të opozitës, që të rritet paga minimale. Pra, ka qenë kërkesë edhe e juaja, të nderuar deputetë, dhe këtë po e bëjmë.

Domethënë, sot para jush e keni një projektligj, i cili hap rrugën për rritjen e pagës minimale. Tani, nëse vërtet e keni menduar dhe ka qenë e sinqertë kërkesa, unë besoj që veprimi i duhur do të duhej të ishte votimi i këtij projektligji. Nëse edhe atë e keni pasur vetëm sa për pretekst për ta sulmuar Qeverinë, që s'po i përmbush premtimet, konsideroj që do të votoni kundër. Njësoj qysh disa prej jush kanë votuar edhe kundër reformës së skemave të asistencës sociale, e cila parasheh zgjerimin dhe reformimin në tërësi dhe ndërlidhjen edhe me tregun e punës të skemave sociale, në mënyrë që të kemi një skemë të mirëfilltë, e cila pastaj edhe i trajton dinjitetshëm ata që kanë nevojë, por edhe i mbështet për t'u riintegruar në tregun e punës ata që janë të aftë për punë dhe jo të mbeten barrë e buxhetit në vazhdimësi.

Konsideroj që debatet u shteruan, por megjithatë lutja ime për ju është që të mbështetet ky projektligj, t'i marrë votat e nevojshme, madje-madje s'kemi as pse vonohemi, meqenëse është çështje shumë e thjeshtë. Pra, janë dy faqe, një apo dy faqe projektligj, disa nene, që hapin rrugën për rritjen e pagës minimale, në mënyrë që sa më shpejt të mund ta marrim vendimin për rritjen e pagës minimale dhe ata punëtorë që punojnë 8 orë, 10 orë e ndoshta edhe 12 orë për 170 euro, më në fund pra të trajtohen dinjitetshëm, ta kenë një rritje të pagës, që është hapi i parë drejt rritjeve të reja në të ardhmen. Faleminderit!

**KRYETARI:** Të gjitha argumentet janë shteruar, po besoj, dhe e kemi dëgjuar njëri-tjetrin mjaft gjatë e secili në fund tash voton sipas bindjeve që i ka. Kështu që kërkoj nga administrata të më tregojnë më në fund, se sa deputetë jemi të pranishëm në këtë seancë aktualisht? Të tjerë në ndërkohë edhe po vijnë.

73 deputetë.

Ju lutem, zini vendet tuaja, sepse do ta votojmë Shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve, që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale, si dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore.

73 deputetë janë të pranishëm. I dëgjuam të gjitha argumentet e grupeve parlamentare, e po ashtu edhe qëndrimin e Qeverisë.

Të nderuar deputetë,  
Kush është për këtë projektligj?  
Kush është kundër?  
Kush abstenon?

Vetëm 56 deputetë kanë votuar. Një pjesë e deputetëve e ka shfrytëzuar të drejtën për të mos marrë fare pjesë në votim.

51 vota për, 5 vota kundër dhe të tjerët nuk kanë votuar. Kështu që, konstatoj që Kuvendi nuk pati kuorum për vendimmarrje. E hedhim këtë pikë në votim në një seancë tjetër, kur të kemi kuorumin e mjaftueshëm.

Shkojmë në pushim deri në orën 15:30.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: I thërrasim deputetët të kthehen në seancë, sepse po vazhdojmë me pikat e mbetura të rendit të ditës.

E kemi në radhë:

## **6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022**

Të nderuar deputetë,  
Komisioni Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Fjalën tash po ia japim ministrit të Financave, zotit Hekuran Murati, që ta paraqesë dhe të na e arsyetojë këtë projektligj që e ka sjellë Qeveria.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,  
Përmes këtij projektligji po bëhet një rishikim i jashtëzakonshëm mbi ndarjet buxhetore të vitit 2022, ashtu që të reflektohet edhe rritja e të hyrave, si dhe rritja e vlerës në kategorinë Subvencione dhe transfere në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me qëllim që të adresohet nevoja për mbështetje të familjeve gjatë krizës inflacionare dhe gjatë krizës energjetike që po përjeton vendi ynë, krahas edhe shumë vendeve të tjera në botë.

Edhe pse nuk jemi në mes të vitit për të bërë rishikim të rëndomtë, Ligji për financat publike dhe përgjegjësitë parasheh rishikime të tilla atëherë kur Ministria e Financave e sheh se ka ndryshim në trendin e të hyrave, apo edhe të shpenzimeve, gjë që e kemi aktualisht.

Në tremujorin e parë të vitit 2022 kemi një rritje të të hyrave prej 17% më tepër në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe kështu, duke konsideruar nevojën për intervenime shtesë në mbështetje të qytetarëve, përkatësisht me masat mbështetëse të prezantuara së fundmi nga Qeveria, një rishikim të tillë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e ka parë si të domosdoshëm.

Vlera që shtohet me këtë rishikim është 150 500 000 euro, kurse rishikimi bëhet vetëm në Ministrinë Financave si organizatë buxhetore, pra në programin e ringjalljes ekonomike, kategoria Subvencione dhe transfere.

Kjo vlerë, pra 150 500 000 euro financohet nga rritja e të hyrave në shumën prej rreth 66 milionë euro, ndërsa financimi i jashtëm shtesë kap shumë prej 40 milionë eurosh, kurse pjesa tjetër vjen nga shfrytëzimi i bilancit bankar ekzistues. Vlen të theksohet se meqenëse rishikimi është bërë vetëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, nuk ka pasur nevojë për dëgjime buxhetore edhe për organizatat e tjera, ngase ato nuk preken nga rishikimi në fjalë dhe Ligji për menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë e parashih edhe një gjë të tillë. Pra, dëgjimet buxhetore bëhen vetëm për ato organizata që preken nga rishikimi.

Marrë parasysh rëndësinë e këtij rishikimi, që edhe më tej t'u qëndrojmë afër qytetarëve me masa mbështetëse, ju ftoj që ta mbështesni dhe të procedojmë tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Po na mungon kryetari i Komisionit për Buxhet. A e ka deleguar ai këtë detyrë, apo...?

*(Ndërprerje incizimi)*

Zoti Muja, e ke fjalën.

ARMEND MUJA: Ndjesë, kryetar! Ishim në një takim. Sidoqoftë, lidhur me Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndarje buxhetore Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka trajtuar këtë pikë dhe të njëjtit i ka dhënë mbështetje me shumicë votash.

Gjithashtu, ne u kemi rekomanduar edhe deputetëve të tjerë që të njëjtin ta votojnë.

Nëse mundem, edhe në emër të grupit parlamentar?

KRYETARI: Po, tash po i thërrasim grupet.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar,  
Ky ligj ka për qëllim që të ndryshojë dhe të plotësojë Ligjin nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

Përmes këtij ligji buxheti i Republikës së Kosovës rritet në 2,9 miliardë euro. Në organizatën buxhetore Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, në nënprogramin, programin për ringjallje ekonomike, me kod 29300 shtohet buxheti me vlerë prej 150 milionë euro te kategoria e shpenzimeve, subvencione dhe transfere.

Janë disa rrethana që kanë kushtëzuar ndryshime te kategoria e programit për ringjallje ekonomike.



E para është kriza energjetike dhe zotimi i Qeverisë për të subvencionuar energjinë elektrike për shtresat më të varfra dhe bizneset.

E dyta është kriza e inflacionit, që ka rezultuar si pasojë e ngjarjeve në Ukrainë.

E treta është pakoja e re fiskale prej 100 milionë euro dedikuar sektorit publik, sektorit privat, ndihmës sociale, pensioneve dhe studentëve.

E fundit, mbështetja për subvencionin e naftës dhe pagesave të inpueteve bujqësore për bujqit e Kosovës.

Ky rishikim është bërë i mundur falë performansës së mirë fiskale. Gjatë katër muajve të parë të vitit 2022 Administrata Tatimore e Kosovës ka regjistruar rritje të të hyrave prej 34%, pothuajse në të gjitha kategoritë tatimor, përfshirë tatimin në të ardhurat e korporatave, tatimi i të ardhurave personale dhe TVSH e brendshme.

Gjithashtu, Dogana e Kosovës ka shënuar rritje prej 22% të të hyrave të mbledhura nga TVSH-ja në kufij. Pra, nën një kemi rritje të kërkesës për rishpërndarje dhe për të ndihmuar shtresa të veçanta, mirëpo në anën tjetër, po ashtu të hyrat kemi një performansë shumë më të mirë fiskale dhe kjo neve na detyron që ta bëjmë një plotësim-ndryshim të këtij ligji.

Andaj, u kërkojmë mirëkuptim të gjitha grupeve parlamentare që ta mbështesin këtë ligj në parim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ky ishte pra qëndrimi i Vetëvendosjes. Kalojmë te PDK-ja. Në emër të këtij Grupi Parlamentar, Mërgim Lushtaku.

**MËRGIM LUSHTAKU:** Faleminderit, kryetar!

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Buxhetit për vitin 2022 ka ardhur në shqyrtim pa kurrfarë arsyeshmërie, pa të dhëna se si është rrjedha e treguesve makroekonomikë, pa asnjë të dhënë se si është rrjedha e të hyrave në tremujorin e parë, pa kurrfarë sqarimi mbi bazën e çfarë të dhënash po rriten të hyrat prej 66 milionë eurove dhe shpenzimet për 150 milionë euro. Buxheti nuk duhet të mbështetet në shifra fiktive të buxhetit dhe duhet të ketë një analizë të detajuar në këtë formë dhe të paraqitet me arsyeshmëri.

Në rrethanat në të cilat ndodhemi ku çmimet e gjërave më jetike për jetesë po rriten nga dita në ditë e donjëherë edhe brenda ditës, qeveria duhet të ketë strategji të mirëfilltë për menaxhimin e situatës së vështirë në të cilën ndodhen qytetarët dhe bizneset e Kosovës.

Është e dëmshme për vendin dhe për qytetarët e për bizneset kur menaxhimi i parasë publike bëhet përmes politikave ad hok, përmes politikave populiste dhe mashtruese, siç po bëhet nga Qeveria Kurti, pa kurrfarë efekti në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve. Nëse e shikojmë tabelën e ndryshimit të buxhetit, shohim se të hyrat buxhetore janë rritur për 66 milionë

euro, tatimet direkte janë zvogëluar për 6,2 milionë euro, tatimi në të ardhurat personale është zvogëluar për 6,7, kurse kategoria të tjera është rritur për 0,2 milion. Kurse në tatimin indirekt janë rritur për 75 milionë euro. Të hyrat janë nga TVSH-ja, të rritur për 73 milionë etj.

Sipas këtyre të dhënave që na janë ofruar, vërehet se janë rritur të hyrat si rezultat i rritjes së inflacionit. Nëse këto shifra janë reale, atëherë rritja është bërë në kurrizin e qytetarëve dhe të bizneseve që paguajnë tatimin, më shumë si rezultat i rritjes së çmimeve dhe jo i ndonjë performanse pozitive të të hyrave. Shpenzimet buxhetore janë rritur për 150,5 milionë euro, duke thelluar deficitin buxhetor për 83,2 milionë euro, pra nga 383,3 milionë euro sa ka qenë, në 466,5 milionë euro. Kemi thënë edhe kur është miratuar buxheti, po e themi edhe sot se bazuar në shifrat e buxhetit të vitit 2022, por edhe në këto ndryshimet që po kërkohet të bëhen sot, ky buxhet është tërësisht konsumues, pa kurrfarë efekti zhvillimor. Nga 2 miliardë e 898 milionë euro që janë të parapara për shpenzime kapitale, këtu përfitojnë qytetarët e Kosovës, janë të paraparë vetëm 570 milionë euro. Kurse pjesa më e madhe e mjeteve buxhetore është planifikuar për politika ad hoc apo aty për aty populliste të kryeministrit Kurti, pa kurrfarë efekti në ekonomi, për të blerë paqen sociale me ata qytetarët të cilët janë në nevojë.

Me këtë ndryshim janë rritur shpenzimet për subvencione nga 894,5 milionë euro në 1 miliard e 45 euro. Për t'u tallur me qytetarët duke parashikuar pagesën vetëm 100 euro për vetëm një muaj.

Zoti Kryeministër, meqenëse nuk është edhe këtu, e kemi parë që është rritur buxheti për 150 milionë euro. Pse nuk iu ndanë qytetarëve të paktën për dy muaj nga 100 euro, por vetëm një muaj, meqenëse ky planifikim më shumë mjete për subvencione sesa i nevojitej këtë pagesë prej 100 euro për një muaj. Faleminderit!

**KRYETARI:** Në emër të Lidhjes Demokratike, deputetja Hykmete Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar përfaqësues të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar me kujdes Ligjin për plotësim-ndryshim të Ligjit për ndarjet buxhetore. Të ju them të drejtën, nuk kemi pasur edhe material të mjaftueshëm. Mungon memorandumi shpjegues. Nuk ka pasur rishikim të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe reflektim të këtyre ndryshimeve në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, mirëpo në bazë të asaj çfarë kemi marrë që është një nen dhe disa ndryshime që ndodhen në tabelën 1 të buxhetit, ajo çfarë shihet është që me këtë plotësim-ndryshim të Ligjit për ndarjet buxhetore, të hyrat janë rritur vetëm me 65 milionë, derisa shpenzimet në buxhet rriten përreth 150 milionë. Është tepër interesante, me krejt performansën e mirë siç e quan Qeveria apo edhe deputetët e mazhorancës

kemi një deficit buxhetor i cili kthehet në kohën e pandemisë. D.m.th. në nivelet 3,9 për qind. E neve të gjithëve na kujtohet se çfarë diskutimesh janë bërë në kohën e pandemisë, në kohën kur kemi pasur disa muaj të mbylljet totale.

Ne shohim gjithashtu që bilanci bankar ulet për plot 85 milionë euro. D.m.th. e kemi thënë edhe më herët, performansa e mirë në inkasimin e të hyrave buxhetore, sa i përket të gjitha kategorive të tatimeve, nuk është asgjë tjetër vetëm reflektim i ngritjes së çmimeve të të gjitha produkteve, gjë e cila e ka shtyrë Qeverinë mandej për pakon që e ka shpërndarë, e cila ka filluar ekzekutimin e asaj pakohe ende pa pasur plotësim-ndryshimet në buxhet, që ne konsiderojmë që është një shkelje.

Një shkelje tjetër, ministër, që ne e konsiderojmë që është bërë, është mosrespektimi i nenit 25 të Ligjit për menaxhim të financave publike dhe përgjegjësitë, ku në nen janë të parapara të gjithë hapat që duhet të ndërmerri si Ministri e Financave për plotësim-ndryshimin e buxhetit. Në fakt, në bazë të materialit që e keni dorëzuar, por edhe asaj që ju keni thënë në Komisionin për Buxhet, Financa dhe Transfere e është parë se asnjë nga këta hapa nuk është respektuar. D.m.th. e keni sjellë një dokument me një nen për plotësim-ndryshim dhe vetëm disa ndryshime në tabelën kryesore të buxhetit që është vështirë faktikisht që të japim edhe komentet tona.

Ne konsiderojmë që ka pasur nevojë për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për ndarje buxhetore, mirëpo kjo nevojë konsiderojmë që nuk është ndier vetëm nga ana e organizatës buxhetore, në këtë rasti siç është Ministria e Financave dhe disa ministrive të tjera të cilat e keni paraparë që t'u shpërndani fondet, qoftë ato për energji, qoftë për pakon e 100 eurove që keni shpërndarë, por ju keni neglizhuar kërkesat e të gjitha komunave dhe institucioneve të tjera të cilat do të kenë nevojë për një rishikim, edhe nuk di nëse sa do të keni kohë tani për të bërë një rishikim tjetër.

E thatë edhe vetë që ky rishikim ka ardhur më herët. Ajo çka shihet dhe është interesante, është që d.m.th. ndryshimi i projeksioneve për rritje ekonomike, pavarësisht rritjes së të hyrave që ju i proklamoni, rritja ekonomike është ndryshuar, është ulur prej 4,5 për qind në 2,5 për qind. Edhe këtë mund ta shohim që faktikisht komplet rritja e të hyrave është rritje fiktive, e cila veç mund ta dëmtojë kualitetin e jetës së qytetarëve dhe assesi ta përmirësojë për shkak se të hyrat e tyre mbeten të njëjta, derisa shteti t'i paguajnë më shumë tatime, për shkak të inflacionit, e ndërkohë që fuqia blerëse e mjeteve që ata i marrin, qoftë të hyrave nga sektori privat ose sektori publik bie çdo ditë e më tepër. Mos të harrojmë se inflacioni ka arritur nivelet pothuajse 12 për qind, nëse e krahasojmë prillin e këtij viti me prillin e vitit të kaluar.

Ministër,

Ne si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kemi parashtruar disa pyetje, d.m.th. vendimi për ndarjen, subvencionimin e 100 milionë euro, ka kohë që është marrë. Kemi bërë disa herë pyetje se prej cilit zë buxhetor i keni marrë këto mjete dhe cilës organizatë buxhetore ia keni

kaluar. Cila është organizata buxhetore në kuadër të buxhetit të Republikës së Kosovës që po e ekzekuton këtë shumë prej 100 milionë eurosh dhe kjo organizatë kujt po ia kalon mjetet? D.m.th. kush është subjekti në sektorin e energjisë që po i merr? Kush është përfituesi i fundit që po i merr këto mjete dhe asnjëherë nuk kemi marr përgjigje. Edhe sot ju e thatë që ky plotësim-ndryshim vjen si rezultat edhe i pakos së 100 eurove, po edhe subvencionimit të energjisë që e keni bërë. Prapë ne nuk e kemi të qartë se te cilat organizatë do të shkojnë dhe cili është subjekti privat faktikisht që do të përfitojë prej këtyre mjeteve. Është mirë që të jeni më transparent.

Ndërkohë, e kam cekur edhe në buxhetin e vitit 2021, rishikimin kur e keni bërë. Edhe në buxhetin e vitit 2022, edhe tash në këtë rishikim, prapë më befasoni, d.m.th. keni qenë shumë kundër çeqeve blanko të Qeverisë dhe si ka mundësi ministër që po vazhdoni, d.m.th. veç me shuma më të mëdha. D.m.th. i keni shumëfishuar shumat, po atë çfarë keni qenë tepër kundër, keni qenë shumë i zëshëm, edhe pse në buxhetet e mëhershme ka pasur tabela, ka pasur deshifrim dhe ka pasur faktikisht për secilin zë dhe për secilën shumë të buxhetit se nga do të shkojë dhe ku do të shpenzohet, ju i keni hequr ato shpallorje të cilat kanë qenë më përpara pjesë e buxhetit, sidomos prej kohës së pandemisë e këndeje dhe po vazhdoni prapë me këto çeqet blanko.

D.m.th. do të kishte qenë mirë t'u shpjegonit jo vetëm deputetëve të Kuvendit, në këtë rast mua, po edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës se çka saktësisht do të bëhet, ku do të shkojnë, sa mjete nga ky rishikim janë për pakon e 100 eurove? Qysh ka mundësi që ju keni filluar ekzekutimin, ju keni vendosur 100 euro të gjithë punëtorëve në sektorin publik, ende pa u bërë ekzekutimi, enda pa hyrë plotësim-ndryshimi në fuqi. Ku i keni marrë këto mjete? Cilët zëra buxhetorë i keni prekur dhe në cilin nen jeni thirrur, a keni pasur të drejtë? Edhe prej këtyre 150 milionëve tash sa po i rritni të hyrat, ku do të shkojnë këto mjete? Një pjesë të shpenzimeve 150 milionë gjithashtu keni planifikuar që ta financoni me kredi, nëse s'gaboj është shuma prej 45 milionëve, rreth dyzet milionë të cilat i keni nga huamarrja. Mundësisht na tregoni se prej cilit institucion financiar? Edhe kjo a do të jetë për subvencionimin e energjisë, për subvencionim e pakos 100 euro, apo do të shkojë huamarrja për ndonjë investim kapital? Ju lute, nëse ka mundësi të na jepni këto shpjegime. Përndryshe, me kaq material sa kemi marrë, Lidhja Demokratike e Kosovës, grupi ynë parlamentar nuk do ta votojë projektligjin. Faleminderit!

**KRYETARI:** Radha e AAK-së. Deputetja Albana Bytyqi.

**ALBANA BYTYQI:** Faleminderit, kryetar!

Projektligji mbi rishikimet buxhetore për vitin 2022, për mua dhe Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është vendim dhe projektligj i gabuar, pasi nuk ka ndikime pozitive dhe nuk reflekton me një menaxhim të duhur të financave publike të shtetit të Kosovës. Rishikimet buxhetore po bëhen, ndoshta asnjë investim e projekt zhvillimor në nivel shteti nuk

ka filluar për vitin 2022. Në vend se të punohet për zhvillim të shtetit e fillim të investimeve, Qeveria merret me plotësim-ndryshime të buxhetit.

Rishikimet buxhetore po bëhen, ndërsa nuk gjendet askund Ligji i pagave për personelin shëndetësor, mësimdhënësit, policet, zjarrfikësit e të gjithë punonjësit e shtetit, të cilët tani e sa kohë po kërkojnë ndihmën e shtetit.

Rishikimet buxhetore po bëhen, ndërsa askund nuk gjendet Ligji për sigurimet shëndetësore, një ligj shumë i nevojshëm dhe jetik për jetën e banorëve të shtetit tonë. Rishikimet buxhetore po bëhen, ndërsa paga minimale e propozuar nga Qeveria nuk përputhet me kushtet dhe nevojat e qytetarëve të Kosovës.

Rishikimet buxhetore po bëhen për vitin 2022, ndërsa ne si klasë politike, as qytetarët nuk e dinë se ku janë marrë ato fonde. Pra, mund të na thoni se në cilat projekte dhe në cilat komuna janë shkurtuar buxhetet dhe pse po i ndëshkoni qytetarët. Rishikimet buxhetore po bëhen, ndërsa para nesh kemi një Qeveri që nuk ka vizion, nuk ka as plan e as ide si të udhëhiqet shteti. Pra, nuk ka logjikë që të lëvizet buxheti i shtetit, ndërsa investimet dhe projektet kapitale të mbeten të njëjta.

Të dashur kolegë,

Ky projektligj që ka të bëjë me rishikimin e buxhetit nuk i ndihmon askujt dhe vetëm sa dëmton të gjitha investimet kapitale dhe një zhvillim normal të vendit tonë. Prandaj, për mua dhe grupin tim parlamentar, ky rishikim i buxhetit ishte dhe mbetet gabim i Qeverisë Kurti. Faleminderit!

**KRYETARI:** Zoti Muja, a deshët edhe një herë ta merrnit fjalën? Jeni lajmëruar tash në cilësinë e deputeti a po?

**ARMEND MUJA:** Po! Kryetar i Kuvendit, gjatë gjithë vitit kemi pasur kërkesa, sidomos te inflacioni se është evidente që ka pasur rritje të inflacionit, sidomos që ka filluar prej nëntorit të vitit të kaluar dhe është përcjellë deri në mars. Tash, shkaku i inflacionit, që rritet diku mesatarisht në tre muajt e fundit, 8.6-8.7 për qind. E vërteta është që në muajin e fundit e ka tejkaluar dyshifrorin, edhe është diçka që po ngjet në krejt globin, posaçërisht në rajon dhe në Evropë.

Edhe një kërkesë me të drejtë e ka pasur opozita që të ketë intervenime ose transfere sociale që u ndihmojnë këtyre shtresave më të varfra që ta minimizojnë efektin e inflacionit. Përgjigjja e Qeverisë ka qenë kjo. Përmes skemave që i prekin të gjitha kategoritë shoqërore, prej lehonave te fëmijët 45 milionë euro, është një kategori shoqërore. Dy është te garantimi i punësimit për të rinjtë. Tre, te pensionet, që ka pasur një rritje prej 11 për qind. Te sektori publik, te studentët. D.t.th. të gjitha shtresat pak a shumë janë prekur ose janë ndihmuar gjatë kësaj kohe.

Çështja e dytë, kjo sa u përket transfereve sociale, nëse i shikon transferet sociale në bazë të ligjit parashihet të shkojnë transferet dhe subvencionet në 1 miliard e 43 milionë euro që është diku 30 për qind më shumë se në vitin 2020, në kohë të pandemisë, e 47 për qind më shumë se në vitin 2019 sa kanë qenë Qeveria Haradinaj. Pra, ka pasur rritje të madhe signifikate të transfereve sociale edhe subvencioneve.

Tjetra është sa u përket investimeve kapitale. Mendoj që në kuadër të buxhetit parashihet një rritje rekord e investimeve kapitale i ofrohet 800 milionë euro, që është diku rreth 400 milionë euro më shumë sesa në vitin 2020. Pra, nëse implementohet si është, unë besoj që kjo do të ketë impakt të drejtpërdrejtë në rritje ekonomike.

Tjetra është sa i përket kategorisë së të hyrave. Gjithmonë unë po e dëgjoj inflacionin si rezultat ose si shkaktar të rritjes së të hyrave, apo një pyetje ishte pse është zvogëluar kategoria e të hyrave nga kategoria tatimore, tatimi në të ardhura personale. Arsyeja është se posa e diskutuam një ligj i cili në fakt për ata që marrin deri 3 mijë euro në vit u hiqet shkalla tatimore, u hiqet pagesa dhe e ka një implikim buxhetor sa unë kujtoj 24 milionë euro. Kjo është arsyeja.

I nderuar kryetar,

Në përgjithësi, shkalla e inflacionit nëse këtë vit është tremujor është 8,6 për qind, atëherë po i jap disa shpjegime pse nuk qëndron, pse nuk është inflacioni shpjegues i vetëm për rritjen e të hyrave. E para është në kategorinë e të ardhurave personale ka një rritje prej 14 për qind në raport me vitin paraprak, apo 24 për qind krahasuar me vitin 2019. Rritja e kësaj kategorie i ka dy shpjegime, ose është zgjeruar baza e atyre që punojnë, ose janë rritur rrogat, se përndryshe nuk rritet kjo lloj kategorie.

E dyta, është tatimi në të ardhura të korporatave. Besoni në këta katër muaj ne kemi mbledhur më shumë të hyra sesa për një dekadë është bërë gjatë gjithë vitit. Pra, kemi një rritje njëqind për qind në këtë kategori. Mendoj që në të ardhmen nëse vazhdon ky trend, ne do të kemi edhe ca shpjegime edhe hetime për këtë punë.

E treta është TVSH-ja në kufi. Është rritur 22 për qind. Inflacioni në import është 11 për qind, jo 22 për qind. Pra, me këtë dua të theksoj që janë edhe shpjegues të tjerë. Është rritur efikasiteti i Administratës Tatimore, i Doganave dhe natyrshëm ka një vullnet të shtuar të popullsisë për t'u përmbajtur rregullave që i përcakton shteti. Pra, ka një punë të shtuar.

Në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve në shtator të vitit 2020 që është diku gjashtë muaj para se të vijë Qeveria Kurti, rritja ekonomike që paraparë të jetë diku 4,7 për qind në vitin 2021, a në fakt përfunduar me 11 për qind pothuajse rritje ekonomike. Buxheti atëkohë ishte paraparë 1,8 miliard, ne kemi shkuar në 2,2 miliardë. Pra, gjithmonë kemi shkuar duke i tejkaluar

parashikimet. E vërteta është që gjatë kësaj periudhe po kemi më shumë kërkesa dhe nevoja sesa që po ka të hyra edhe me këtë ritëm të përsheptuar të performansës.

Dhe kjo është arsyeja pse duhet të rishikohet buxhet. Sepse duhet të ketë transfere dhe subvencione në kuadër të zotimit për energjinë. Duhet të ndihmohet pakojë 100 milionë euro për sektorin publik, sektorin privat, studentët, fëmijët, edhe punëtorët e sektorit privat. Edhe në fund, po ashtu kemi edhe zotime të drejtpërdrejta. Një arsye pse ne marrim shumë nga importi, është sepse importojmë ushqim shumë. Tash, në kuadër të këtij viti, ne kemi ndryshuar edhe politikën bujqësore. Kemi rritur rendimentet dhe pagesat e drejtpërdrejta në bujqësi, sepse përgjigjja më e mirë ndaj inflacionit dhe ndaj importit, është rritja e prodhimit të brendshëm dhe kjo është arsyeja pse është rritur edhe shkalla e pagesave direkte në disa kategori qind për qind. Në disa kategori shkon 200 për qind.

Unë i kisha lutur me mirësjellje të gjithë deputetët që të njëjtin ta votojmë në parim dhe pastaj në mes dy leximeve të vijnë me propozime të tjera në kuadër të kësaj kategorie, sepse ligji është i limituar në vetëm këtë kategori buxhetore, pra është prekur vetëm një organizatë buxhetore, atëherë çdo propozim që kanë, qoftë për shpjegime, ta bëjnë në kuadër të kësaj kategorie me amendamentet e tyre.

**KRYETARI:** Zonja Bajrami e doni replikë, apo fjalën e plotë? Mirë!

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryetar!

Po e marr fjalën me replikë, e të gjitha po i përfundoj.

Zoti Muja, m'u duk se fole për buxhet, nuk fole tani për projektbuxhet, sepse i përmende shifrat 200-300 milionë, e unë prapë po ju them 65 milionë janë rritur të hyrat me nenin që na ka ardhur amendament dhe 150 milionë janë rritur shpenzimet. Andaj, nuk ka mundësi të rritet 200-300 milionë andej, ose këndej. Kurse ajo çka planifikohet në buxhet, ajo çka është në ligj të buxhetit, pothuajse asnjëherë nuk është realizuar. Në vitin 2021 p.sh. buxheti ka qenë dy miliardë e 697 milionë, por është realizuar në dy miliardë e 490 milionë. Në vitin 2020 realizimi i buxhetit ka qenë 2,2 miliardë, në vitin 2019 prapë ka qenë 2,2 miliardë e në vitin 2020 po e dimë për shkak të pandemisë dhe mbylljes totale që e kemi pasur atëkohë.

Mirëpo, më lejoni t'ju them një gjë. Nuk mund të thoni që çmimet e importit janë rritur për 11 për qind, e të hyrat tatimore janë rritur me përqindje shumë më të lartë, ndërkohë që vetë më vonë po thoni që çmimet e ushqimeve janë rritur më së shumtë. Edhe ne këtë po e themi.

Ne importojmë ushqim, importojmë gjëra të cilat blihen. Mesatarja e inflacionit merret për të gjitha produktet, mirëpo i kemi disa prej tyre që inflacioni nuk është madje as 11 për qind, sa është i muajit prill-prill. P.sh. nëse e krahasojmë çmimet e miellit prill 2021 me prill 2022, 44 për

qind është inflacionit. Te buka 31 për qind, qumështi 17 për qind, te vaji e keni parë është stabilizuar çmimi, d.m.th. tash e kemi një çmim 3 euro, nuk po ka askush të ndërhyjë asgjë, 78 për qind rritje të çmimit, te sheqeri 37 për qind, te pastaj 17, te domatet 54, në naftë 53 për qind e kështu me radhë. D.m.th. kjo është ajo çfarë ka ndodhur në fakt. Edhe në raportin e Bankës Botërore të prillit të këtij viti kur përshkruhet performansa e vitit të kaluar, kur përmenden të gjithë sektorët që kanë pasur progres, përmendet pikërisht sektori i bujqësisë i cili ka pasur regres. Edhe thuhet është e befasishme sesi në sektorin e bujqësisë ka pasur regres, edhe arsyetimi jepet sepse është ngritur çmimi i inputeve bujqësore. Mirëpo, Qeveria në atë rast është dashur që të ndërhyjë.

Ne e kemi qe sa javë, ndoshta janë edhe muaj prej që keni marrë vendim për subvencionimin e naftës, po edhe sot e kësaj dite, bujqit e blejnë naftën me po të njëjtin çmim, si e blejmë unë e ti për veturat tona, njëjtë e kanë edhe ata për traktorët dhe tokën që e punojnë. Andaj, performansa e Qeverisë nuk matet me performansën e vitit të kaluar, sepse në vitin e kaluar të gjitha vendet që kanë pasur regres ekonomik që kanë pasur rënie ekonomike në vitin 2020, për shkak edhe të pauzës së konsumit dhe të gjithave, kanë pasur rritje ekonomike. Ju përkujtoj edhe një herë, Mali i Zi 15 për qind e ka pasur, minus 15 për qind rënien ekonomike, dhe po ashtu e ka pasur gati performansën. Mirëpo, ajo çka matet me suksesin e juaj është rritja ekonomike këtë vit, ku ju e keni ulur prej 4,5 për qind, në 2,8 për qind tani. Pikërisht me këtë projektbuxhet. D.m.th. e keni reflektuar. Edhe këto janë masat e juaja. Qysh ka mundësi që në njërin anë reflekton në ulje të shkallës së rritjes ekonomike dhe në anën tjetër na tregon për performansë të mirë.

Edhe një herë po e themi që rritja e të hyrave buxhetore nuk është asgjë tjetër, është rezultat i inflacionit që nënkupton, qytetarët po blejnë me çmime shumë më të larta sesa kanë blerë para një viti. Rrjedhimisht Qeveria meqenëse të gjithë taksat dhe tatimet janë me përqindje, inkason më shumë. Po kjo nuk nënkupton që ka kualitet më të mirë të jetës së qytetarëve. Dhe kjo ka qenë arsyeja pse ne kemi propozuar që të largohet TVSH-ja, sidomos për produktet bazë, sepse kështu mund t'ju ndihmojmë. Nuk ju keni ndihmuar. Beso, shkoni pyesni familjet që u keni dhënë para dhjetë ditëve njëqind euro, ku i kanë ato. Ato janë harxhuar me rastin e një hyrje në supermarket dhe sot e kanë gjendjen e njëjtë ekonomike. D.m.th. ju po e merrni me njërin dorë dhe po provoni ta shpërndani me tjetrën dorë, mirëpo mënyra qysh po e shpërndani nuk është në rregull.

Në anën tjetër, po është e vërtetë që ka pasur performansë të mirë në vitin e kaluar. A e dini se të gjitha raportet ndërkombëtare thonë që kontributin më të madh në këtë rritje ekonomike të vitit 2021 e ka pasur konsumi privat e gjithashtu rritja e eksportit. Dhe më tregoni vetëm një masë çka keni bërë ju për ta rritur eksportin? Asgjë. Kompanitë janë rritur vetë, i kanë gjetur tregjet vetë. Në fakt, ne një masë e kemi pasur në vitin 2020 për t'i përkrahur bizneset, masë të cilën ju e kritikoni edhe sot e kësaj dite. Mirëpo, kur vjen puna për t'i mbështetur, nuk i mbështetni. Kur vjen puna te krenoheni me performansën e atyre, atyre që i keni quajtur oligarkë deri dje, prapë



vazhdoni t'i quani si të tillë. Andaj, të shohim cilat janë masat e juaja. Edhe një herë e përmendët që kanë shkuar mjete në transfere sociale, kanë shkuar në subvencione etj. ne ato nuk po i shohim. Atë çka po e shohim është që rritet buxheti në Ministrinë e Financave. Çekun blanko për të cilin ka qenë kundër Hekuran Murati dhe për të cilin ka pasur shpalosje në tabelën 1 të buxhetit në vitin 2020. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Një replikë ia japim deputetit Muja.

**ARMEND MUJA:** Tri çështje: E para, te eksportet, çështja kryesore është mirë që po pranohet që janë rritur eksportet. Në fakt, i nderuar Kryetar, në katër muajt e fundit, këto katër muaj janar-prill 2022, ne po i eksportojmë 290 milionë euro, a beson ti që në krejt dekadën Kosova prej 2011 deri në 2019 në krejt vitin i ka eksportuar 290 milionë. Është duke ndodhur diç e jashtëzakonshme që kërkon studim.

E dyta, sa i përket arsyeve të rritjes ekonomike. Nuk është arsyeja e vetme rritja e konsumit si arsye për rritjen ekonomike të vitit të kaluar. Në fakt, gjysma e saj i atribuohet rritjes së formimit të kapitalit bruto, pra i biznesit nga dy miliardë ka shkuar në 2,8 miliardë. Po ka pasur investime shumë më të mëdha nga bizneset.

E treta është sa i përket të hyrave buxhetore. Nuk është viti i vetëm kur Kosova ka pasur rritje të inflacionit. P.sh. vitin e kaluar ka pasur një shkallë mesatare të inflacionit 3.4 për qind, po të hyrat buxhetore janë rritur 25 për qind. Pra, të hyrat buxhetore shkojnë përtej rritjes së shkallës së inflacionit. Apo në vitin 2008, sa herë ka pasur kriza, edhe ka pasur inflacion në Evropë, ai është bartur edhe në Kosovë. Ka pasur një rritje të inflacionit edhe në vitin 2011 të ngjashëm sikur sivjet, po nuk është reflektuar në rritje të të hyrave tatimore. Ajo çka duhet të premtohet, më fal ajo që duhet të pranohet, sepse është çështje e studimit kjo, dhe e hetimit potencialisht në fazën e dytë, është që të mësohet se si punohet me nder, edhe në fakt... ke paratë që kanë shkuar, unë besoj në formë të favoreve anësore, në formë të kllapave buxhetore, ne sot po i mbledhim dhe po i shpërndajmë me grupet shoqërore që kanë më së shumti nevojë. Ky është dallimi. Sepse, nëse këtë vit, në vitin 2022 buxheti, të hyrat buxhetore shkojnë 2,5 miliardë, në vitin 2019 kanë qenë 1,8 miliardë. Pra, po flasim për dy vjet, një rritje prej 700 milionë euro të hyra.

**KRYETARI:** Ia japim fjalën për kundër-replikë znj. Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Zoti Muja, veç kur po thua ne kemi eksportuar, a po mendoni Qeveria a? Ju Qeveria e Vetëvendosjes keni eksportuar? A e di kush ka eksportuar? Oligarkët që i keni quajtur deri dje. Ata kanë eksportuar. Kanë eksportuar në kohën e Qeverisë sonë, kanë eksportuar në kohën e qeverive të tjera dhe në kohën e Qeverisë suaj. Ata po eksportojnë. Unë po them, më trego këta që po eksportojnë, tregomë cilat masa ju i keni ndërmarrë për t'u ndihmuar. Tregoma një masë që e ke pasur ta ndihmosh eksportin. Ju lutem shumë, atyre njerëzve duhet t'u

thuhet ju lumtë. Edhe kur t'u ndihmojmë, kur u kemi ndihmuar, si rasti që u kemi ndihmuar ne, mos të dilni të shani një Qeveri vetëm pse u ka ndihmuar bizneseve, sepse jeni duke e bërë të njëjtën gjë. E keni subvencionuar energjinë elektrike me njëqind milionë euro dhe kurrë s'keni publikuar listë se kujt ia keni subvencionuar energjinë elektrike. D.m.th. kur u ndihmojmë ne, ata janë oligarkë. Kur u ndihmoni ju, çka janë?

**KRYETARI:** Zoti Muja më nuk ka të drejtë, sepse u krye forma e replikave, po me siguri kur po thotë ne eksportojmë, e ka fjalën për Kosovën, znj. Bajrami.

Tash fjalën ia japim ministrit.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në lidhje me ato që u thanë, pra siç e thashë në fillim, ky është një rishikim i jashtëzakonshëm dhe normalisht që cash-i ka mbetur ai që ka qenë fillestar, për shkak se ditët kalendarike apo afatet kalendarike kur duhet të miratohet cash-i kanë qenë më vonë sesa që është bërë ky rishikim. Dhe, tashmë ne e kemi sjellë në fakt cash-in, që është si pjesë e procesit të rregullt që vjen në Kuvend. E kemi miratuar në Qeveri dhe besoj që tashmë e keni si deputetë.

Sa i përket mbështetjes për qytetarët dhe këto 100 eurot që ju fillimisht i keni quajtur lëmoshe dhe tani po ankoheni se pse vonohet Qeveria dhe s'po i disburson më shpejtë.

Vetëm sa për t'i krahasuar masat, se kjo punë është matematikë. Kur po thoni që duhet të hiqet TVSH-ja për produktet bazë, e cila është 8 për qind dhe e cila do të hiqej për të gjithë, si për të pasurit si për të varfrit. Pra, edhe ai pasuri që e ka rrogën 2 mijë apo 3 mijë edhe deputetit t'i hiqet ajo TVSH, do të hiqej për të gjithë. Kurse me 100 euro që i japim ne, atë 8-përqindëshin e TVSH, ka vlerë 1 250 euro vlerë blerje.

Domethënë, duhet të shpenzohen 1 mijë e 250 euro që të mbërrihen 100 euro TVSH të paguara, apo jo? Pra, mbështetja është përtej kësaj. Ju kur po thoni të hiqet TVSH-ja, po thoni të hiqet 8% e çmimit, e cila në fakt vetëm sa do të kompensohej me rritje të marzhës së fitimit të bizneseve.

Në një ambient inflacionar, ku çmimet ndryshojnë dita e ditës, ne e ulim sot TVSH-në për 8%, reflektohet për dy ditë, ditën e tretë ngrihet 15% çmimi, dhe vetëm rritet marzha e biznesit. Pra, këtë po e doni ju. Ne s'kemi dashur ta bëjmë këtë, ne kemi dashur t'iu ndihmojmë atyre që kanë nevojë.

Kur po pyesni, kur janë paratë se s'po i shohim? Po normal që deputetët nuk i shohin se mbështetja ka qenë për ata që marrin pagë nën 1 mijë euro bruto, jo për deputetë. Po besoj që s'jeni të befashuar që deputetët s'e kanë marrë mbështetjen prej 100 eurove.

Sa i përket çekut blanko. Çekun blanko e kemi kritikuar, sepse asokohe ju thoshit “po na vyen ta kalojmë rishikimin se pa rishikim s’po mund t’i paguajmë me nga 170 euro qytetarët”. Besoj ju kujtohet.

Plotë njerëz më ndalnin në rrugë e në shesh, se u besonin fjalëve tuaja, thoshin, pse s’po votoni rishikimin se Qeveria do t’i na i japë nga 170 euro neve qytetarëve. Kalo i rishikimi si kaloi, çka ndodhi? I dhatë nga 290 euro për punëtorë, por jo punëtorit, bizneseve. Bizneseve ua dhatë, për punëtorë.

Tash, a i kanë parë punëtorët ato para apo jo, nuk e di. Mund t’i pyetni punëtorët dhe ndoshta mund t’ju përgjigjen punëtorët juve. Mirëpo, këto pagesa që ne po i bëjmë shkojnë direkt në xhepat e qytetarëve, në duar e qytetarëve, të cilat pastaj mund t’i shfrytëzojnë për t’i mbuluar disa prej faturave, ta japin një shtysë për çdo familje. Besoj që nëse e ka një student, e ka një pensionist, e ka një të punësuar, 300 euro i merr ajo familje. Domethënë, është goxha një shtysë për t’i mbështetur deri në tejkalimin e kësaj periudhe të vështirë.

Sa i përket menaxhimit dhe u përmend këtu edhe çështja se janë zvogëluar investimet kapitale. Më lejoni t’ua shpjegoj. Këtë e tha deputetja e AAK-së. Investimet kapitale kanë qenë 704,4 milionë euro të parapara, është vlera e njëjtë, asnjë cent nuk është prekur. S’ka zvogëlim të investimeve kapitale.

Vetëm çfarë ka ndodhur këtu, është rritur kufiri buxhetor: 1. Duke reflektuar rritjen e të hyrave dhe 2. Duke shfrytëzuar edhe pjesë nga bilanci bankar, por edhe nga huamarrja që t’ju dalim në mbështetje qytetarëve për shkak se situata ka ndryshuar. Pra, është përkeqësuar gjendja.

Në sapo menduam që e kaluam një krizë, që ishte kriza e pandemisë, dhe e tejkaluam atë për shkak të vaksinimit të shpejt dhe të suksesshëm nga ana e kësaj Qeverie, dhe normalisht edhe vullnetit dhe bashkëpunimit të qytetarëve që të vaksinohen me kohë dhe në mënyrë të shpejtë. Kemi qenë shteti i vetëm që për disa ditë me radhë që në vazhdimësi kemi vaksinuar 1% të popullatës çdo ditë.

E tejkaluam pandeminë, por ja që ndodhin kriza të tjera, pra siç është kriza energjetike dhe tani edhe kriza inflacionare për shkak të luftës në Ukrainë, të cilat janë jashtë kontrollit të kësaj Qeverie dhe cilëndo qeveri tjetër. Pra, është diçka jashtë kontrollit tonë.

Krejt çka mund të bëjmë, është t’ju dalim qytetarëve në ndihmë, gjë të cilën e kemi bërë, po e bëjmë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë.

Çka kemi bërë ne për t’i mbështetur bizneset? Ne i kemi mbështetur në punësim, ku përmes masave të Pakos sonë janë punësuar 10 mijë persona, gjysma prej tyre gra, gjysma janë gra.

Punësimi më i madh, besoj mund t'i gjeni dhe mund t'i merrni të dhënat në ATK, është në kategorinë e prodhimit. Pra, bizneset prodhuese kanë parë rritjen më të madhe të punësimit, vendeve të punës.

Kategoria e dytë është gastronomia. Tash, gastronomia, po besoj që një pjesë e madhe, pajtohem edhe unë, e besoj edhe ju e thoni këtë që një pjesë e madhe mund të jetë edhe formalizim i vendeve ekzistuese. Mirëpo, kjo e prodhimit ka korrelacion edhe me nivelin e eksportit, sepse s'do të ishte eksport pa prodhim. S'do të kishte prodhim pa pasur punësim. Të gjitha këto janë të ndërlydhura.

Kemi bërë subvencionimin e kredive investuese, e kemi hapur në tetor të vitit të kaluar. Muaji nëntor dhe dhjetor kanë parë rekord gjenerim të kredive të reja në sektorin banka. Rritja e investimeve apo kredive investuese, është rritje enorme. Nëse e krahasojmë marsin e këtij viti që është, po ashtu një muaj rekord, 237 milionë euro kredi të reja janë lëshuar për sektorin privat nga sektori bankar, është dyfishim i kredive investuese krahasuar me marsin e vitit të kaluar, është dyfishim. Domethënë, këtë e kemi bërë ne, kemi mbështetur bizneset, gjë që është thënë sa e sa herë nëpër sa fushata që kemi mbështetur prodhuesit me subvencionim të kamatave, të kredive, por s'është bërë asnjëherë. Ne e kemi bërë për herë të parë. Ne e kemi bërë. Subvencionim e kredive e kemi bërë ne.

Çka keni bërë ju, ka qenë të subvencionohet një tarifë të Fondit të Garancisë, por jo subvencionimin e kredive. Ne e kemi bërë këtë për herë të parë. Sa e sa vjet keni premtuar, kurrë nuk është bërë, u desh ne të vijmë pas sa e sa vjetëve për ta bërë për herë të parë, dhe tash po thua, çka keni bërë? Por, ja këto i kemi bërë.

Kemi mbështetur edhe konsumin edhe lukuiditien familjar. Kemi mbështetur edhe familjet që kanë humbur familjarin prej pandemisë. Të gjitha këto janë para në duar të qytetarëve që gjenerojnë kërkesë, gjenerojnë kërkesë, e cila kërkesë pastaj krijon vende të reja të punës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia japim fillimisht një replikë ndaj ministrit zonjës Bajrami, pastaj vazhdojmë me deputetin Hoti.

**HYKMETE BAJRAMI:** Ministër, i kemi mbështetur bizneset, do t'i kishim mbështetur prapë. 100 euro nuk po kërkojmë që t'i shohim, po kërkojmë që t'i shohim në buxhet, jo t'i shohim nëpër kontot tona, edhe të mos bësh injorantë kur flet me deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Nuk po i kërkojmë që t'i shohim, po i kërkojmë në letër, se për këtë arsye është ligji edhe është qindra faqe, që ti duhet të tregosh se ku i ke çuar.

Fondin për Garanci Kreditore e ka bërë Qeveria Mustafa, konkretisht në atë kohë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Është instrumenti i parë që është bërë ndonjëherë në histori që Qeveria t'i ndihmojë bizneset.

Në anën tjetër, për masat e tua, dil na trego sa ju ka kushtuar subvencionimi i kredive investuese. Pse e keni ndaluar subvencionimin e kredive konsumuese? I kam informatat. Sepse, të është keqpërdorur me të madhe. Njerëzit i kanë marrë sot 3 mijë euro, kanë ardhur i kanë marrë nga Qeveria 300 euro, pas një jave kanë shkuar dhe e kanë shlyer kredinë. Njëjtë e keni pasur edhe për 170 eurot.

Është ulur një grup i njerëzve dhe ka vendosur se kujt t'ia japë dhe kujt të mos ia japë. Kur kam shkuar në Kabinet të Ministrisë së Financave, ka pasur e-mail prej ministrit paraparak duke thënë, X shkollës private, edhe pse ia ka aprovuar komisioni, të mos ua jepni paratë, se ata kanë para boll. Kështu keni funksionuar ju, kështu funksiononi.

Unë e kam pasur me sistem të ATK-së, i ke punëtorët në lista të ATK-së, do t'i marrësh 290 euro për kokë të punëtorit. Por, si rezultat i asaj mbështetje me qindra biznese janë shpëtuar që të mos falimentojnë. E sot, ti krekosesh me performansën e tyre vitin e kaluar, por s'ke bërë asgjë për ta për këtë vit.

Për këtë arsye, tash rritja ekonomike po e parashikon ta ketë 2,8%, nuk po e parashikon më që ta ketë 11 apo 12%. Sa po e parashikon që ta ketë? Për vitin 2022 jam duke folur. Aha, po 12 nominale. Dil tregoj qytetarëve...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Ia japim edhe një replikë Albana Bytyqit fillimisht, meqenëse ishte me fjalën e ministrit, drejtpërdrejt.

**ALBANA BYTYQI:** Ministër, ne e dimë shumë mirë që buxhetin e ti ke përgjysmuar ndopak nëpër secilën komunë, ne e dimë shumë mirë. Kjo është diskutuar edhe në komisionin... Jo, jo, po më vjen shumë keq, por kjo është diskutuar edhe në Komisionin për Buxhet. Kështu që, të jesh në dijeni.

Edhe për vende të reja të punës. Nuk e di a po i llogarit këto shkarkime e ngarkime që i ke bërë apo cilat vende. A mund të na tregosh saktë se ku ke punësuar? Tamam po duam ta dimë se ku i ke bërë ato punësime. Nuk është interesant vetëm ato shkarkimet që i keni bërë dhe i keni punësuar familjarët tuaj.

**KRYETARI:** Ia japim fjalën deputetit Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Unë e mora fjalën veç për të plotësuar disa çështje. Ky projektligj që ka ardhur është gjithçka, por rishikim nuk është. Ky nuk është rishikim i buxhetit.

Ligji i buxhetit është pak më ndryshe prej ligjeve të tjera. Pra, e ka një procedurë të veten. Secili ligj e ka një procedurë të veten të konsultimeve, të memorandumit e të tjera e të tjera, derisa të vijë në Kuvend nëpër komisione përkatëse, por Ligji i buxhetit është i veçantë.

Ligji për menaxhimin e financave publike, dhe unë këtu kërkoj vëmendjen edhe të kryetarit të Kuvendit edhe të Zyrës Ligjore të Kuvendit, sepse besoj që duhet në fund të sigurohem që projektligjet i servohen këtij Kuvendi, të jenë në përputhje me kornizën ligjore që e kemi, me Kushtetutën dhe me ligjet që janë fuqi.

Sepse, ky Projektligj për rishikimin e buxhetit nuk është në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Nëse ky ligj miratohet kështu siç është, cilido prej deputetëve që e çon në Gjykatë Kushtetuese, ky bie poshtë.

Neni 25 i Ligjit për menaxhimin e financave publike, thotë: “Ministri i Financave mund të përgatisë propozim-ndryshim të Buxhetit të Kosovës nëse ai ose ajo ka mjaft arsye për të besuar”. Dhe, janë arsyet në vijim, ku thuhet: “Nëse të ardhurat ose shpenzimet për vitin fiskal do të jenë materialisht më të ulëta apo më të larta se ato që parashihen në buxhet ose në Ligjin për ndarjet buxhetore fillestare”.

Ndër të tjera, po ashtu thuhet: “Një rast i vetëm i të ardhurave të jashtëzakonshme nuk është arsyetim i mjaftueshëm, në mënyrë që ministri të thirret në këtë dispozitë”.

Ministri thotë, na u janë rritur të hyrat, performansë më e mirë, rritja e çmimeve, sido që quajmë. Por, të hyrat janë rritur veç për...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Zoti Hoti e ka pasur fjalën e tij të plotë. Ju lutem, regjia! Nuk ka qenë replikë kjo.

AVDULLAH HOTI: Pra, parashikimi i juaj i rritjes së të hyrave është 65 milionë. Kjo është vetëm 2,6% e buxhetit total, por nuk është materiale. Nuk është sinjifikante në buxhetin total, dhe nuk e dimë se si do të mbyllet viti. Çmimet po rriten, po bie fuqia blerëse, nuk e dimë se çfarë ndodh deri në fund me kërkesën agregate dhe nuk e dimë se si do ta mbyllim vitin 2022 sa u përket të hyrave.

Pika 25.2, pavarësisht nga paragrafi 1 që e lexova, thotë: “Ministri përgatit amendamentet e propozuara, ku tregon mënyrën se si parashihet tejkalimi i deficitit”. Ju në fakt e keni rritur deficitin, në 3.9 e keni çuar tash prej asaj që ka qenë më herët, duke qenë se i keni rritur shpenzimet në 150 milionë euro/

Pika 25.3, edhe më e rëndësishme është, besoj, thotë: “Gjatë përgatitjes së propozim-ndryshimeve dhe plotësimeve, ministri ia dorëzon propozim-ndryshimet dhe plotësimet, Qeverisë së bashku me cash-in e azhurnuar”. Nuk ka cash të azhurnuar, nuk ka kornizë afatmesme të shpenzimeve të rishikuar mbi të cilën përgatitet ky rishikim i buxhetit.

Në 23.5, thotë: “Propozim-ndryshimi dhe plotësimet e buxhetit që dorëzohen në Kuvend, duhet të përfshijnë një tabelë që përmban përmbledhje të ndryshimeve të nxitura nga politikat për kornizën fiskale etj., etj., e cila mungon”. Mungon edhe pika B, mungon edhe pika C, të gjitha me radhë. Asnjë pikë, asnjë pikë e këtij neni nuk plotësohet për të përmbushur aspektin ligjor që të shkojë përpara ky rishikim i buxhetit. Njësoj është edhe me nenin 22 a dhe 22 b, të deficitit.

Unë ia kam prezantuar gjerësisht ministrit, kur e kemi diskutuar këtë çështje në Komisionin për Buxhet, dhe kisha një përshtypje sikur po reflekton pak përpara se të vijmë në seancë, ta tërheqë këtë ligj, t’i përmbushë kushtet ligjore, sepse ju keni të drejtë plotësisht si Qeveri, si ministër i Financave, të bëni rishikimin e buxhetit kurdo, por duhet ta bëni, dhe pavarësisht që unë mendoj që komplet është i gabuar, por këtë të drejtë ta bëni, po duhet ta bëni në përputhje me ligjin.

Nuk është diskrecion i juaji që të talleni me 120 deputetë në Kuvend me dy letra për rishikim të buxhetit; pa cash, pa vlerësime, pa asnjë gjë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia japim tash fjalën ministrit.

**MINISTRI HEKURAN MURATI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Rritje që iu referua zonja Bajrami, ajo është projeksion nga FMN-ja. Pra, FMN-ja ka pasur projeksion të tillë dhe e ka reviduar në 2,8%. Normalisht ka modelin e vet, sikurse çdo institucion tjetër financiar ndërkombëtar dhe në bazë të atyre modeleve, edhe ato vijnë me projeksione të tilla.

Më duhet t’jua rikujtoj që edhe vitin e kaluar projeksioni i FMN-së ka qenë dukshëm më konservativ sesa yni, e edhe rezultati ka qenë dukshëm më konservativ sesa ajo që ka ndodhur në realitet. Pra, edhe këtë vit presim që të ndodh e njëjta gjë. Pra, normalisht, FMN, duke marrë parasysh edhe ngjarjet në nivel global, mund ta trajtojë në nivel global dhe të sheh rreziqe të tjera ndaj të cilave mund të ekspozohen shtetet tjera, por Kosova mund të jetë ndoshta edhe më izoluar dhe ka reziliencë dhe qëndrueshmëri më të madhe për sa u përket bizneseve dhe qytetarëve të vet për sa i përket performansës ekonomike.

Prandaj, kemi dallimi sa i përket kësaj, dhe ajo që ju iu referuat, nuk është projeksion i Qeverisë apo i Ministrisë së Financave, të Punës dhe Transfereve.

Sa i përket çështjes së Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, normalisht aty thuhet që, ministri e vlerëson kur pritet të ketë të hyra më shumë apo edhe shpenzime më shumë.

Tash, nëse ju bëni kërkesë që ndihmohen qytetarët, por të mos ketë shpenzimeve, me të vërtetë s'kemi çfarë të diskutojmë, sepse nga diku të vijnë paratë. Diku duhet të ketë shpenzim, që të ndihmohet dikush, se pa bërë shpenzim s'mund ta ndihmosh askënd. Me fjalë të mira, s'mjaftojnë.

Sa i përket cash-it, sapo ju thashë, ka pasur edhe një amendament. Pra, mund ta shihni. Mund ta shikoni vitin 2023 dhe 2024 këtu, asnjë vlerë për sa i përket shpenzimeve nuk ka ndryshuar. Domethënë, të vetmet vlera që janë ndryshuar te shpenzimet, janë për vitin aktual. Pra, nuk ka ndryshim për shkak se përditësimi i cash-it është pritur të bëhet në periudhën e rregullt që parashihet edhe me ligj. Pra, ligji e parasheh që në fund të muajit prill, Qeveria miraton kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe ia dorëzon Kuvendit. Tani e keni cash-in, është në Kuvend.

Kështu që, të gjitha këto pretendime nuk qëndrojnë. Përpara e keni një projektligj. Ka pasur projektligje edhe më të shkurtra në këtë Kuvend. Ligji për heqjen e homologimit ka qenë një faqe, por e kryen punën.

Ka pasur këtu zëra, që nuk bën e antikushetues, e do të shkojmë në arbitrazh, por ja që e kreu punën. Edhe një faqe ligj e kryen punën shpeshherë. Prandaj, një faqe dy, me rëndësi është përmbajtja. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia japim fjalën për një replikë, zotit Hoti.

**AVDULLAH HOTI:** Ministri nuk po bëhet i sinqertë, që të mos e përdori një fjalor tjetër këtu. Kur po flas që nuk e ka sjellë cash-in e rishikuar, ky e di për çka po flas unë. Cash-in e rishikuar mbi të cilin ti e mbështet këtë rishikim të buxhetit, jo për cash-in e rregullt që e sjell ti, e e miraton deri në fund të prillit, e që është për buxhetin e vitit 2023, të kisha lutur! Po flet me njerëz që i njohin më mirë, ose së paku sa ti këto procedura.

Prandaj, të mos mashtrosh as deputetët, e as qytetarët. Të kesh kujdes! Unë t'i citova në nga një pikat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe le të thotë dikush këtu në Kuvend, që ato pika, ato nene të Ligjit për menaxhimin e financave publike janë plotësuar kur ky rishikim i buxhetit, edhe pse është një faqe, s'ka lidhë që është një faqe, ka ardhur në Kuvend. Dhe, unë tërhiqem dhe kërkoj falje.



Por, ato pika që i lexova qëndrojnë një nga një, dhe unë kërkoj edhe vëmendjen e kryetarit të Kuvendit dhe Zyrës Ligjore që të kenë kujdes që në Kuvend të vijnë ligje që ne i dimë, ose besojmë që janë përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet që janë fuqi.

Ka plot raste ndonjëherë që kalojnë ligje që ne nuk jemi të vetëdijshëm që nuk janë plotësisht në përputhje, dhe për këtë arsye është Gjykata Kushtetuese, por kjo është duke u bërë me vetëdije të plotë. Kjo është duke u bërë me vetëdije të plotë. E kemi diskutuar në komision, po e them edhe këtu hapur, qartë, le të vije opinioni prej Zyrës Ligjore të Kuvendit, që ky rishikim i buxhetit, ky Ligj për rishikimin e buxhetit është në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike, dhe unë tërhiqem dhe kërkoj falje publike.

Përndryshe, kjo punë që po bën Kuvend sot, ky shqyrtim i këtij rishikimi është joligjor. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia japim fjalën edhe diskutuesit të fundit, pastaj një fjalë përmbyllëse nëse e dëshiron ministri sërish. Isak Shabani e ka fjalën.

**ISAK SHABANI:** I nderuari kryetar,

Të nderuar ministra,

Të ndërtuar kolegë,

Vendimi për t'i ndarë nga 100 për të punësuarit dhe studentet është diskriminues, sepse me këtë vendim nuk po përfitojnë kategoritë që kanë më së shumti nevojë, ata që janë të papunë.

Ata kanë më së shumti vështirësi ta përballojnë këtë situatë tejet të vështirë nga ngritja e çmimeve, e në anën tjetër nuk kanë asnjë të ardhur. Pse Qeveria nuk ua ka ndarë edhe të papunëve këto mjete?

I nderuar ministër,

Edhe pse punëtorët kosovarë dhe me rritjen enorme të çmimeve kanë shumë nevojë edhe për këto 100, më duhet të them fuqishëm se kjo nuk është zgjidhja.

Punëtorët, në vend të ndihmës njëmuajore, kanë nevojë për rritje pagash për të reflektuar në inflacion, të paktën siç e parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive konform rritjes së produktit vendor.

Meqë po thoni që kemi rritje ekonomike prej 10%, atëherë pse nuk kemi respektuar Ligjin për pagat që për rritjen e pagave të kemi rritje të pagave për 10%, sipas rritjes së produktit vendor. Ekonomia e Kosovës ka nevojë për realizimin e projekteve kapitale.

Qytetarët dhe bizneset kanë nevojë të hyjnë në funksion mjete që janë paraparë për investime kapitale, ku përfitojnë qytetarët, e që për fatin e keq të këtij vendi kanë mbetur të bllokuara nga mosfunksionimi i OSHP-së.

Qytetarët kanë nevojë që t'u lejohet tërheqja e një pjese të fondit të kontributit pensional prej 30 për qind, për ta tejkaluar këtë situatë të vështirë në të cilën ndodhën e për të cilën Qeveria nuk ka kurrfarë projekti për ta tejkaluar. Me mijëra fermerë të cilët janë në prag të falimentimit nga rritja e çmimeve të imputeve, kanë nevojë që t'u rritet subvencionimi drejtpërdrejt në bujqësi dhe në blegtori.

Zoti ministër,

Kosova po zbrazet nga profesionistët më të mirë në të cilët ka investuar shteti i Kosovës, siç është personeli shëndetësor. 100 euro vetëm për një muaj, nuk është zgjidhja. Paga e dinjitetshme dhe krijimi i kushteve për punë në shëndetësi është zgjidhja për ta dhe për qytetarët që presin të marrin shërbime nga ta.

Kështu që, siç jeni duke vepruar, jeni duke e humbur shpresën të qytetarët për një jetë më të mirë në Kosovë. Veprimet mashtruese dhe deklaratimet e pavërteta, siç është deklarimi për rritjen e punësimit, janë të rrezikshme. Me mashtrim e me deklarime të pavërteta nuk arrihet asgjë.

Shtimi i punësimit. Shtim të punësimit nuk ka dhe gjendja në punësim e tregon faktin që shtim të numrit të të punësuarve nuk ka. E kjo vërtetohet. Nëse të papunët ikin nga Kosova dhe Qeveria e merr si shifër të zvogëluar të numrit të të papunëve, kjo është e rrezikshme, sepse është manipulim me shifra.

Nuk shtohet numri i të punësuarve, kur Qeveria nuk e ndërmer asnjë masë për rritjen e aktiviteteve ekonomike në situata normale, e lëre më në situata të vështira të krizës nga inflacioni i lartë.

Si rezultat i mungesës së politikave zhvillimore, investimet e Qeverisë kanë rënie. Aktivitetet ekonomike kanë rënie. Puna në sektorin e ndërtimit ka rënie. Sektori i tregtisë ka rënie, sektor ky që ka më së shumti të punësuar ka rënie. Sektori i bujqësisë ka rënie dhe kjo si rezultat i rritjes së çmimeve të imputeve.

Vetëm në katër muajin e fundit janë mbyllur 639 biznese si rezultat i politikave të pafavorshme ekonomike dhe në mungesë të masave përkrahëse të bizneseve të rrethana të pandemisë dhe të rritjes së çmimeve.

Pa investime dhe pa masa ekonomike që rrisin aktivitetet ekonomike, ka papunësi dhe varfri, dhe kjo ka ndodhur gjatë kësaj periudhe të qeverisjes. Ndarja nga 100 euro, po e përsëris edhe një

herë, nuk është zgjidhje për qytetarët. 100 euro, ato janë pako ekonomike, nuk është përmirësim i mirëqenies së qytetarëve.

Ne jemi kundër logjikës së tillë të qeverisjes mashtruese dhe pa alternativë. Prandaj, ne si grup parlamentar nuk do të përkrahim plotësimin dhe ndryshimin e buxhetit kështu siç e keni sjellë ju. Faleminderit!

KRYETARI: Nëse e dëshiron ministri fjalën? Jo! Administrata na tregon se ku qëndrojmë në këto momente me kuorumin famoz të Kuvendit të Kosovës.

Vetëm 54 deputetë janë të pranishëm. E ndërpresim këtu këtë seancë. Për vazhdimin e saj, ju lajmërojmë një ditë tjetër.

\* \* \*

*E hënë, më 6 qershor 2022*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 maj 2022*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Po e vazhdojmë seancën, e cila është thirrur më herët, por e cila i trajton dy pjesë të pikave të seancave të mëparshme, të cilat kanë mbetur të papërfunduara.

Po hyjmë fillimisht në pikat e papërfunduara të seancave të mbajtura më 5, 11 dhe 13 maj.

Fillimisht, të nderuar, deputetë e kemi:

***5. Votimi në parim i Projektligjit nr.08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore***

Administrata, më tregoni se sa deputetë i kemi të pranishëm, ju lutem.

E ka kërkuar fjalën kryetari i Grupit të PDK-së. Urdhëro!

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Ne si grup parlamentar mendojmë që nuk është mirë të hyjmë në votim sa i përket pikës së parë, pra çështjes së pagës minimale. Kjo çështje është mirë të zhvendoset për një seancë tjetër, pasi t'i nënshtrohet edhe një debati, së bashku me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ne sot shohim edhe acarimin e kësaj gjendje sa i përket çështjes së veteranëve të organizatave të dala nga lufta.

Ne nuk jemi këtu për ta tensionuar situatën, ne jemi për të zgjidhur probleme. Prandaj, është në interesin tonë të përgjithshëm që kjo kategori tepër e rëndësishme, shumë e ndjeshme të trajtohet ashtu siç duhet, pra siç e meritojnë dhe të mos jetë përplasje politike jona në Kuvend të Republikës së Kosovës, mirëpo të shtyhet, të mos hyjë në votim fare, sepse edhe në kohën kur kemi pasur debat e kemi refuzuar një çështje të tillë dhe pastaj, pasi të kemi një diskutim dhe të arrijmë një dakordim me Ministrinë e Financave sa i përket edhe involvimit të çështjes së veteranëve, atëherë mund të hyjmë në votim.

Prandaj, e jona është që të kërkojmë që të shtyhet, të mos hyhet në votim sa i përket kësaj pike dhe të vazhdojmë me pikat e tjera. Faleminderit!

KRYETARI: A e ke vetëm kërkesë në këtë formë, apo do t'i japësh formën e mocionit?

ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Ne jemi për një kompromis brenda dhe sot nuk jam këtu për ta nxjerr në pozitë të keqe askënd, as pozitën, as të tjerët. Prandaj, të kemi një dakordim që të mos hyjmë në votim fare sot, qoftë me mocion procedural, qoftë ta tejkalojmë si pikë e rendit të ditës, sepse nuk është hera e parë që kemi tejkalar pika të tilla që s'i kemi përfshirë fare në votim dhe të kemi një kompromis në mënyrë që ta trajtojmë edhe një herë me Ministrinë e Financave dhe të gjejmë një zgjidhje për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

KRYETARI: Mirë, pra, e dëgjuat kërkesën e PDK-së. Ua japim fjalën grupeve parlamentare që të shohim se çka po mendojnë për këtë kërkesë.

Deri tash e kanë kërkuar fjalën kryetari i Grupit të LDK-së, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Çështja e veteranëve të luftës është çështje delikate, si duket Qeveria nuk është e gatshme ta trajtojë në esencë çështjen e kompensimit për veteranët e luftës dhe qasja që ka qenë e deritanishme është e pamjaftueshme dhe në momente të caktuara e vërteta është që ka dhënë rezultate negative në mirëqenien e veteranëve të luftës. Pse? Sepse ata janë detyruar që për të marrë një kompensim, të lënë vendet e punës, sepse ky kompensim më shumë është konsideruar si kompensim mëshire dhe si diçka për njerëzit që kanë mbetur pa shpresë, pa punë dhe pa të ardhme.

Realisht zgjidhja që është dashur të bëhej do të duhej të jetë një zgjidhje më gjithëpërfshirëse, e cila ofron një mënyrë më të mirë të kompensimit dhe që mundëson një jetë më të dinjitetshme.

Unë njoh personalisht plot veteranë të luftës, besoj se secili prej neve këtu njih plot veteranët e luftës, të cilët e kanë lëshuar vendin e punës për ta marrë kompensimin dhe dëmi është bërë i shumëfishtë, ose kanë dalë në tregun e zi të punës. E para sepse persona që janë të aftë të punojnë, djem dhe vajza të reja, tash mund t'i kenë 35, 40, 45 vjet, ka edhe më të vjetër sigurisht, kanë dalë nga tregu i punës dhe nëse kthehen në tregun e punës me një pagë mesatare 350 euro, ata e humbin beneficinin, ndërkohë që zgjidhja që është dashur të bëhej në këto raste do të ishte më gjithëpërfshirëse dhe t'u mundësohej të merrej kompensimi, ndoshta do të mund të thuhet që veteranët e luftës që nuk punojnë e marrin kompensim me një shumë të caktuar, por ata që punojnë nëse marrin pagë deri 500 euro, mund ta marrin mbi 500 euro, sepse mbi 500 euro ata i paguajnë vetë tatimet, taksat, kontributet që japin, e paguajnë atë pension që e merr.

Pra, duke i pasivizuar, efektin ekonomik dhe social e kemi bërë negativ dhe i kemi nxjerrë prej tregut të punës potencialisht me mijëra vetë. Pra, tregu i punës ka nevojë për fuqinë e tyre

punuese, po edhe ata kanë nevojë për mundësi për ta përmirësuar jetën dhe kualitetin e jetës së tyre dhe të familjes së tyre. Kualiteti i jetës së tyre dhe i familjes së tyre me një pagë minimale nuk përmirësohet, thjesht pasivizohen pa mundësi pune dhe pa asnjë kontribut për shoqërinë, duke pritur deri në fundin e jetës së tyre për një mëshirë nga shteti për një pagë minimale.

Pra, këtu ne duhet biseduar në esencë problemin dhe problemi në esencë është që ne po pasivizojmë një pjesë shumë vitale të shoqërisë, fatkeqësisht, ne duhet parë se si t'i bëjmë aktivë për tregun e punës këta njerëz dhe qysh t'u mundësohet që duke qenë aktivë në tregun e punës, ta përmirësojnë kualitetin e jetës së vet dhe jo me një kompensim minimal të pagës minimale në Kosovë t'i bëjmë pasivë, sepse ata në momentin që fillojnë të punojnë, çfarëdo qoftë ajo, e humbin beneficionin. Nëse e merr një pagë minimale çfarëdo, nëse ka një të hyrë tjetër kudo, e humb beneficionin e veteranit të luftës. Këto janë probleme që duhen diskutuar në esencë. Por, tash çështja është se ne jemi në procedurë dhe kur je në procedurë, ose e merr, ose e lë atë që të ka propozuar propozuesi.

Në këtë rast dy janë mundësitë: ose e tërheq Qeveria dhe shkojmë në bisedime substanciale për këtë projektligj, e unë mendoj që duhen bisedime substanciale, të shohim çka po ofrojmë ne për këtë kategori të shoqërisë dhe qysh i bëjmë aktivë në tregun e punës. Sepse, sot e çdo ditë e më shumë tregjet e punës janë shumë të pasigurta dhe po kanë probleme edhe me punëtorë. Prandaj, potencialisht 30 - 40 mijë vetë, sa e marrin këtë beneficion, duhet të kthehen në pjesë aktive të shoqërisë e jo të mbeten pjesë pasive e shoqërisë.

Me këtë ligj, 30 mijë veta, 35 mijë më duket janë, s'jam shumë i sigurt, janë pjesë pasive e shoqërisë, sepse e marrin atë pagën minimale 170, ose 190 euro dhe e presin muajin tjetër kur të dalin prapë, sepse nuk mund të punojnë. Në momentin që punojnë, e humbin atë beneficion. Dhe, ne nuk duhet të mendojmë kaq ngushtë. Duhet të mendojmë që veteranëve të luftës dhe cilësdo kategori sociale në Kosovë t'u krijojmë mundësi për rritje të mirëqenies dhe për të qenë aktivë në shoqëri. 35 mijë vetë, ish-luftëtarë, djem e vajza, burra dhe gra tash, janë nxjerrë prej tregut të punës dhe kualiteti i jetës së tyre është përkëqësuar dhe me propozimin që është bërë po e lëmë aq njëherë, se këqyrim më vonë e trajtojmë këtë çështje. Kjo pastaj nxit pakënaqësi sociale dhe nxit veprime që ne sot po i shohim në Kuvend.

Prandaj, unë propozoj, po mendoj në fakt, që Qeveria duhet ta tërheqë këtë projektligj dhe ta diskutojë në mënyrë të detajuar me grupet e interesit, ose me mocion procedural e tërheq, e kthen në Qeveri, ose e rrëzojmë krejt me votë. Rrugë të tjera s'ka. Të kapërcehet rendi i ditës nuk është zgjidhje. S'po u bëka sot, prapë do të vijë sot një javë! Nuk është zgjidhje ajo, sepse duhet diskutuar përmbajtja. Përmbajtja është gabim. Ka qenë në një fazë e mirëseardhur, para shtatë, tetë, a dhjetë vjetëve, por nuk është më sot. Ai ligj nuk i plotëson nevojat e shoqërisë të kësaj kategorie, sepse ka pasivizuar mbi 30 mijë vetë, e kjo është gabim. Shoqëria kosovare nuk e ka

luksin mbi 30 mijë veta t'i pasivizojë, djem, vajza, burra e gra të fuqishme, njerëz që kanë dhënë kontribut për këtë vend, t'i nxjerrësh tash në skemë sociale e në mëshirë, se po ua japim 170 a 220 euro, është e papranueshme.

Nëse ata vërtet kanë nevojë për këto 220 euro, t'ua japim 220 euro, por edhe t'i shtimë në punë, në mënyrë që me kontributin e vet, me punën që e bëjnë, me taksa e tatime që i paguajnë, e paguajnë këtë pensionin e vet. Ndërsa kështu, edhe janë pasivë, edhe marrin pagë minimale, e cila nuk ia mundëson të jetojnë, edhe kemi mbi 30 mijë vetë që janë jashtë tregut. Pra, ka nevojë për diskutim thelbësor kjo çështje, ka nevojë për diskutim me palë të interesit, me shoqatat e luftës, me ekspertë të ndryshëm, të shihet si të zgjidhet kjo çështje dhe jo kështu në mënyrë arbitrare "lëre këtë kategori jashtë, se këqyrim më vonë, bëjmë diçka...". Është gabim kjo qasje, prandaj mendoj se duhet tërhequr, ose të rrëzohet me votim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, deputeti Armend Muja e ka fjalën.

**ARMEND MUJA:** I nderuar kryetar i Kuvendit,

Përmes ligjit ne kemi dashur të rritet paga minimale. Asnjëherë nuk është thënë këtu që të gjitha propozimet që i ka edhe opozita janë të paarsyeshme. Nuk ka pasur lidhje midis pagës minimale dhe pagesave të veteranëve që një kohë të gjatë. Ajo lidhje është shkëputur në vitin 2016. Është mirë të kuptohet kjo.

Ky propozim, paga minimale është instrument i tregut të punës dhe ky prioritet u dedikohet 120 mijë vajzave dhe djemve që punojnë dhe e kanë rrogën midis 130 dhe 170 euro. Ne po themi fillimisht, na lejoni që të adresohen kushtet e jetesës së kësaj shtrese shoqërore, që paguhen shumë më pak sesa veteranët. Asnjëherë ne s'po themi që veteranët paguhen mjaftueshëm, po fillimisht ta rrisim pagën minimale dhe pastaj ta bëjmë një debat paralel për nevojat e veteranëve dhe shtresave të tjera shoqërore.

Tjetra, i nderuar kryetar, ky është ligj në lexim të parë. Në kuadër të leximeve, midis dy leximeve, mund të bëhet amendamenti. Mirëpo, në këtë fazë ne mendojmë që kjo duhet të procedohet, duhet të shkojë tutje. Pastaj të fillohet një debat paralel, sa i përket adekuatshmërisë së pagesave për veteranët dhe e fundit është, po ashtu edhe nga opozita kërkojmë që të reflektojnë, sepse kemi pasur edhe një marrëveshje ndërkombëtare që i dedikohet reformës së skemave sociale, e cila është refuzuar dhe pjesërisht ka qenë e menduar në mënyrë të përgjithshme holistike që t'i trajtojë nevojat dhe të gjitha skemat sociale.

Përgjithësisht, unë mendoj që paga minimale është instrument i tregut të punës. Skemat sociale janë skema sociale. Ka skema sociale, si pensionet, që kanë qenë 75 - 90 euro. Ka shumë skema sociale që janë të vogla dhe për këtë na duhet një debat i veçantë shoqëror. Ne e kuptojmë

plotësisht që pagesa 170 euro mund të mos jetë e mjaftueshme dhe ne duhet të përkushtohemi të punojmë për kategorinë, që mendoj se është më meritore në shoqëri. Mirëpo, është e rëndësishme që këto të ndahen. Dhjetë vjet, i nderuar kryetar, nuk është trajtuar ky problem, pikërisht për shkak të këtyre defekteve, “jo, mos e bëj ti këtu, jo masandej, jo protesta...”. Mirëpo, ne duhet në mënyrë metodike t’i trajtojmë. Rritet paga minimale për 120 mijë veta, e adresojmë problemin e 40 mijë vetave dhe pastaj edhe shtresat të tjera një nga një. Por, nuk mund të themi që 120 mijë persona nuk kanë të drejtë t’u rritet paga minimale, sepse disa nuk trajtohen.

**KRYETARI:** Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ia japim fjalën kryetarit të këtij subjekti, deputetit Haradinaj.

**RAMUSH HARADINAJ:** Së pari është turp i madh që njerëz të zgjedhur të popullit, si ky zoti Muja, e disa të tjerë, kanë mbërritur në këtë shkallë të mashtrimit çfarë po e dëgjojmë sot në Parlament. Pra, është turp i madh, si t’i silllet vetes, si t’i silllet këtij populli, si t’i silllet këtij Parlamenti të diskutohet a është në rregull të ndahen veteranët kur e rrisim pagën minimale, apo s’është?

Është turp për ty, Glauk Konjufca, djali i Sherif Konjufcës. Është turp për Gani Krasniqin, Fatmir Humollin, Enver Dugollin, e krejt këta të tjerët. Duhet t’ju vijë marre çka jeni duke bërë! A jeni njerëz, a çka jeni? Nuk do të mund të shkoni kësaj rruge, s’do të mund ta kaloni këtë ligj, se po doni të bëni lojë. Hajde, deri ku po shkojmë! Hiqeni këtë ligj, ai Murati le ta heqë! Ai që e ka sjellë, le ta heqë! Hiqeni këtë ligj, mos luani me këto sende! Mos luani me këto sende!

Marre duhet t’ju vijë pse e keni sjellë punën këtu. Për 35 a 40 euro të veteranëve e gjetët t’i ndani ata e t’i kryeni punët e tjera! Po, duhet mundësuar të punojnë pa e humbur të drejtën e pagës së veteranit, po. Por, jo të luhet me ta, jo të poshtërohen, jo t’i obligoni të vijnë sot para derës suaj. A kështu doni të vazhdoni, a?

Ndaluni, sa nuk është bërë më keq, sa nuk keni shkuar më thellë. Ndaluni! Më mirë është të ndaleni sot, sesa nesër, ndaluni!

**KRYETARI:** Zoti Haradinaj, ky është Kuvend. Edhe vetë ke qenë kryeministër. Edhe ju me siguri e kuptoni që Parlamenti i ka rregullat e veta.

*(Reagime në sallë)*

Ju lutem! Ju lutem, ruajeni qetësinë, nëse ka mundësi! Seanca duhet...

*(Reagime në sallë)*



Qetësi, ju lutem! Këtu jemi...

*(Ndërprerje e incizimit)*

Ju lutem, zini vendet tuaja, sepse këtu flasim me argumente. Asgjë nuk shkon me zor. Janë rregulla të Kuvendit të cilat na i ka imponuar vullneti i lirë i qytetarëve të cilët na kanë sjellë në këto pozita. Nuk i kemi zgjedhur vetë. Secili populli e ka vendosur aty me vullnet të lirë. Prandaj duhet t'i respektojmë Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

Pas kësaj, z. Hoti nuk kisha hyrë në debat më të thellë, sepse po dua t'i marrë vetëm grupet parlamentare, apo po insiston gjithsesi. Jo, grupet përfunduan faktikisht.

Mirë, urdhëro, po vetëm të kemi kujdes që të mos hapim debat, se e kemi shteruar debatin. Unë vetëm për procedurë e pata. Urdhëro, një përjashtim.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit kryetar për fjalën.

Unë veç për sqarim për të gjithë deputetët, për ata që ndoshta nuk janë të familjarizuar, por janë disa që vërtet të familjarizuar dhe e dinë si janë bërë këto punë tash e dhjetë vjet, pesëmbëdhjetë vjet, kur skema të ndryshme sociale, pensionale i kemi lidhur me pagën minimale. Me arsyen e thjeshtë, sepse janë përvoja ndërkombëtare. Kur e paguan një ndihmë sociale, një pension, një mbështetje që ia jep një qytetari e lidh me pagën minimale, sepse paga minimale është një praktikë ndërkombëtare që e kemi edhe ne. Edhe në Ligjin për pagën minimale e ka një formulë se si llogaritet. Tjetër është historia që nuk është rritur qe sa vjet, ta lëmë anash atë.

Por, kur vendoset paga minimale, është formula që merr parasysh standardin e jetës dhe kjo ka qenë logjika që edhe vetë pensioni i veteranëve të luftës, edhe skema të ndryshme janë lidhur me pagë minimale. Vendimi që të shkëputet paga minimale nga përfitimet që i marrin veteranët e luftës dhe disa prej skemave të tjera është puro politik. Unë kërkoj që kjo të mos shkojë përpara, të kthehet prapa, ta bëjmë dialogun si duhet edhe me veteranët dhe të tjerët dhe të ecim përpara.

Është dëm i madh nëse këto ndryshime kaq të mëdha që prekin kaq shumë individ shkojnë pa ndonjë dialog substancial dhe shterues për këto çështje.

KRYETARI: Zoti Tahiri, a dëshironi t'ia jepni formën e mocionit, apo të procedojmë me pozicionim të forcave politike, ashtu siç janë grupet parlamentare të pozicionuara në Kuvendin e Kosovës.

ABELARD TAHIRI: Atëherë, duke pasur parasysh që s'patëm asnjë deklaram të ministrit të Financave që të ketë një vullnet dhe ta tërheqë, pa pasur nevojë që të propozohet një mocion, atëherë ne e propozojmë një mocion procedural që kjo pikë dhe Agjencia Kosovare e Verifikimit

të Pronës, dy pika pra të largohen nga shqyrtimi në këtë seancë dhe pastaj t'i vendosim në një seancë të radhës. Pra, po e vendosim. Kërkesa jonë është që pika e parë që ka të bëjë me përcaktimin e pagës minimale dhe e dyta me Agjencinë Kosovare të Verifikimit të Pronës të largohen nga rendi i ditës dhe t'i trajtojmë pasi që të arrijmë në konsensus.

**KRYETARI:** Po flasim pra për pikën e pestë të pjesës së parë të seancës së papërfunduar si dhe pikën e pestë të seancës së dytë të papërfunduar. U përkasin dy seancave të ndryshme.

E dëgjuat propozimin. Po jeni deklaruar tash grupet. Në rregull. Po, po, për sqarim të pikës shtesë. Urdhëro, Mimoza Kusari-Lila.

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Kryetar, faleminderit për fjalën!

Ne biseduam me shefat e grupeve parlamentare. Sa i përket pikës pesë për Agjencionin për Verifikimin e Pronës, ne e trajtuam si çështje e cila nuk paraqet ndonjë problem të shtyrjes. Megjithatë të prezantohen të dyja bashkë për votim, nuk e konsiderojmë se është mundësia. Teknikisht duhet pikat një nga një të votohen, po herën e parë Kryetari e kërkoi deklarinimin për pikën e parë sipas përfundimit të z. Tahiri. Ne u deklarua për pikën e parë. Konsiderojmë që pas votimit për pikën e parë, të trajtohen pastaj çështjet e tjera. Jo të bëhen dy pikat në një mocion procedural të trajtohen dy pika të rendit të ditës.

**KRYETARI:** A i ndajmë kështu apo jo? Urdhëro z. Tahiri për ta riformuluar ndoshta mocionin.

**ABELARD TAHIRI:** Ne s'e kemi fare problem. I paraqesim edhe dy mocione. Pra, le të jetë çështja e Ligjit për përcaktimin e pagës minimale mocion i veçantë.

**KRYETARI:** Fillimisht ajo.

**ABELARD TAHIRI:** Pastaj kalojmë te pika e dytë. Nuk është një praktikë që s'e kemi pasur në të kaluarën, ku i kemi përfshirë dy pika në një mocion. Ka qenë pikërisht edhe mocioni ku i kemi futur dy komisionet hetimore në rend të ditës, prandaj kjo nuk është një praktikë e panjohur për ne, mirëpo meqenëse po insistoni, atëherë po kërkujmë që në radhë të parë të largohet nga rendi i ditës çështja e pagës minimale që ndërlidhet me pensionet e veteranëve të luftës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Ia japim fjalën edhe kryetarit të Grupit. Urdhëro, Adnan. Ia japim fjalën kryetarit të Grupit të AAK-së, Besnik Tahirit.

**BESNIK TAHIRI:** Pasi çështja e Agjencisë për Verifikim dhe Krahasim të Pronave nuk ka qenë çështje diskutabile, ne kemi diskutuar, ne kemi marrë vesh në Kryesi, kemi folur për këtë temë dhe jemi marrë vesh. Mos i ngatërroni gjërat, ne kemi kërkuar për njëzet minuta aty në foltore kemi kërkuar të bëjmë një mocion procedural dhe ta heqim Ligjin për pagën minimale. Kjo ishte

kërkesa. Këto janë dy kërkesa. Prandaj, kërkohet reflektim dhe vendoseni këtë në votim të parën.

**KRYETARI:** Mirë kështu po mendoj që pasi edhe kryetari i Grupit të PDK-së u pajtua që të riformulohet mocioni, atëherë shkojmë me këtë mocion që të hiqet pika e pestë sipas radhës. Pra është e para që po e trajtojmë në këtë seancë të papërfunduar, të cilën e hapëm, e që është votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që e përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale. Pra mocioni i PDK-së po kërkon që të hiqet kjo prej rendit të ditës.

81 deputetë i kemi të pranishëm. Përgatiteni për votim, do të votojmë me ngritje të dorës. Shumë shpejt do t'i kemi edhe ato.

Kush është për mocionin e ngritur nga PDK-ja? Kush është kundër? Kush abstenon?

Ky mocion nuk i kishte numrat e vet, i kishte vetëm 32 vota për, kështu që Rregullorja e Kuvendit më detyron të vazhdoj me këtë pikë të rendit të ditës dhe ta hedh atë në votim, përndryshe e shkel Rregulloren, kështu që do të vazhdojmë.

Mocioni pra nuk thashë ka rënë, thashë nuk i ka pasur numrat. Nuk ka kuorum. Duhet të vazhdohet me pikën dhe të hidhet ajo në votim.

Jo edhe për mocionet.

Urdhëro! Regjia, kryetari i Grupit të LDK-së e ka kërkuar fjalën, po pret që flasë.

**ARBEN GASHI:** I nderuar kryetar,

Kuvendi ka një mocion procedural, i cili është delikat dhe i ndjeshëm. Kuvendi nuk mund t'i vazhdojë punimet më tutje për pa u marrë një vendim për këtë çështje, qoftë ai vendim që kalon mocioni ose qoftë vendim që e rrëzon mocionin.

Pra, Kuvendi është i paaftë që të marrë vendim, dhe si rezultat të paaftësisë që të marrë vendim, nuk mund t'i vazhdojë punime. Prandaj, Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes duhet ta ndajë mendjen se çfarë po do. Ju mund të thoni se ka precedent, kur edhe pse nuk ka kaluar mocioni, sepse s'ka pasur vota, kemi vazhduara, është e vërtetë, por kemi pasur kompromis që të vazhdojmë.

Sot, ne kërkohet që Kuvendi të marrë vendim. Prandaj, është e pamundur që të vazhdojë seanca, sepse Kuvendi duhet të marrë vendim. Të marrë vendim, a kalon apo nuk kalon mocioni procedural i propozuar, në këtë rast, nga deputeti Tahiri.

Prandaj, nuk mund të vazhdoni më tutje seancën pa marrë vendim Kuvendi për këtë mocion procedural, sepse është çështje e cila po na ndanë. Faleminderit!

KRYETARI: Po, pra! Siç e thatë, unë vazhdova sipas praktikave që i kemi pasur më herët. Në momentin kur Kuvendi nuk ka mundësi për vendimmarrje, kjo nuk e ka bllokon seancën, kur është çështja te mocioni. Bile-bile kemi pasur raste dhe kur s'kemi pasur kuorum edhe pikat i kemi kaluar.

Kështu që, domethënë në bazë të asaj praktike, mirëpo nëse mendoni që të shtroni çështje ligjore në përputhje me Rregulloren e Kuvendit ia japim fjalën edhe kryetarit të Komisionit për Legjislacion për çdo rast.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Ne e kemi një rend të ditës të propozuar nga Kryesia e Kuvendit për këtë seancë. Ka rend të ditës të pikave të renditura nga seancat e mëparshme, pika të papërfunduara. Sot, kishim një mocion për ta ndryshuar këtë rend dite të përcaktuar ose të propozuar nga Kryesia për këtë seancë.

Meqenëse mocioni nuk kaloi, ne kthehemi te rendi i ditës të miratuar nga Kryesia dhe vazhdojmë në përputhje me rendin e ditës. Nuk ka kuptim tjetër. Ndryshimi i rendit të ditës do të nënkuptonte miratim të mocionit të procedural. Në të kundërtën kthehemi në rendin e ditës të miratuar nga Kryesia, për të cilën është thirrur ky Kuvend, kjo seancë. S'ka kurrfarë kuptimi tjetër, sepse rendi i ditës ndryshohet vetëm me mocion procedural.

KRYETARI: Urdhëro, por në formë të replikës, zoti Gashi, dy minuta.

ARBEN GASHI: Në formë të replikës edhe po e përfundoj se pastaj me siguri kanë edhe deputetë e tjerë. Zotëria që foli këtu, s'e njeh Rregulloren hiç. Kjo s'ka mundur të ndodhë hiç. Këto shtatë seanca të pambyllura nuk është dashur të ndodhnin hiç, por kanë ndodhur, sepse ka pasur mirëkuptim, se në momentin që nuk kalon një pikë e rendit të ditës, ndalesh aty.

Jemi përpjekur që të kemi mirëkuptim me shumicën parlamentare që të mos e bllokojmë Kuvendin, tash ky, mirëkuptimin e Parlamentit do që ta bëjë normë, e nuk është normë.

Mirëkuptimi nuk është normë, është mirëkuptim. Ato seanca janë thirrur para tre muajsh ndoshta. I ke, sa seanca që ke provuar t'i mbash, nuk ke mundur për shkak të mungesës së kuorumit etj., etj. Pra, kjo çka po thotë është totalisht e pabazë. Që të shkojmë më tutje Kuvendi, duhet ta marrë një vendim, qoftë ta rrëzojë ose ta aprovojë mocionin. Faleminderit!

KRYETARI: Një kundër-replikë, nëse po e kërkoni. 60 sekonda, e fundit.

ADNAN RRUSTEMI: Se kush çka di e sa di, është çështje tjetër. E para, nuk kemi normë që e rregullon këtë gjë. Këtë po përpiqemi që ta rregullojmë me draft-Rregulloren e re.

Në seancat e mëparshme, mbase në seancën e kaluar, këtu ka pasur një propozim nga zoti Tahiri për një pikë të pikëve të papërfunduara, të zhvendoset në pjesën tjetër, dhe vetë zoti Gashi e kundërshtoi që kjo është e pamundur, sepse këto janë seanca të ndara dhe janë të përcaktuara paraprakisht. Dhe, nuk kaloi pa mocion, vetëm me mocion mund të zhvendoset.

Ne e kemi një rend dite, e kemi një listë... Po, jo rrëzoje mocionin, ndryshoje rendin e ditës me mocion, jo rrëzoje mocionin. Ndryshoje rendin e ditës me mocion. Barra i bie atij që po propozon mocion.

KRYETARI: Ia japim fjalën për këtë procedurë edhe nënkryetarit Kujtim Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Vërtet kjo çështje është e rregulluar dhe ka normë. Në raste të mocioneve, si në të gjitha rastet e tjera, kemi të bëjmë me procedurë votimi, dhe kur në procesin e votimit nuk ka kuorum, atëherë procesi i votimit shpallet i pavlefshëm, domethënë s'është konsumuar. Nuk është çështje e mbyllur.

Rendi i ditës duhet të ndryshohet me votë për, në shumicë, me 2/3 e deputetëve që votojnë, ose duhet të rrëzohet mocioni. Pra, unë propozoj që ta përsëritim procedurën e votimit meqë nuk kishte kuorum. Në këtë kuptim, nuk është çështje e ezauruar, nuk është çështje e mbyllur, nuk mund të vazhdojmë më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: E hedhim edhe një herë në votim nëse ka pajtueshmëri, siç po shihet nga të gjitha grupet. Më tregoni se sa deputetë janë në sallë. I kemi 87 deputetë prezentë. Mocionin e PDK-së e keni dëgjuar.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Ky mocion është votuar prej 30 deputetëve të cilët e kanë dhënë votën për, një ka votuar kundër, 51 abstenime. Pra, i bie që nuk ka kaluar ky mocion. Kështu që, vazhdojmë me pikën:

***5. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore***

Atë e trajtojmë kur të vijë pjesa e seancës. Sa deputet i kemi, ju lutem më tregoni?! Janë të pranishëm 83 deputetë.

Kush është pro këtij projektligji në shqyrtimin e parë? Kush është kundër? Kush abstenon për këtë projektligj?

Vetëm 51 deputetë kanë votuar për këtë projektligj. Kuvendi nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje. Kalojmë që është,

***6. Votimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022***

Na ka mbetur vetëm pjesa e votimit, diskutimet janë shterur edhe për këtë pikë. Për të gjitha pikat të cilat po i trajtojmë në këto dy seanca të papërfunduara janë shterur të gjitha debatet.

Ju lutem më tregoni nëse ende kemi kuorum, sepse një pjesë e deputetëve e lëshuan sallën. Të shohim se a kemi pjesëmarrje të nevojshme. 67. I thërrasim në ndërkohë edhe deputetët e tjerë që të bashkohen. Po bën t'i mëshojmë ziles ndopak. Sa deputetë janë tash? 71 deputetë janë bërë tash. 70 deputetë.

E hedhim në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022. Kemi kuorum.

Kush është për? Kush është kundër? Kush abstenon?

Vetëm 58 deputetë të Kuvendit po marrin pjesë në votim, kështu që nuk ka kuorum për vendimmarrje. E ndërpresim këtë seancë meqenëse nuk po shoh kushte që seanca të zhvillohet, e ju thërras në një ditë tjetër për seancën kur ta caktoj, për t'i vazhduar këto pikat të cilat na mbetën. Faleminderit!

\* \* \*

*E martë, më 14 qershor 2022*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 5 maj 2022*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër Kurti,

Ministër Murati,

Po fillojmë me këtë pjesë të seancave, të cilat na kanë mbetur në gjysmë, të papërfunduara.

Në ndërkohë e shfrytëzoj rastin që edhe në emër tuajin ta përshëndesim delegacionin që na ka ardhur nga Kroacia, prej Komisionit të Çështjeve Evropiane, e përshëndesim kryetarin Hajduković...

*(Duartrokitje)*

...dhe deputeten Përlaskaj. Faleminderit që jeni këtu!

*(Duartrokitje)*

Tash kalojmë te pikat, të cilat i kemi në radhë:

***5. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore***

Ju kujtohet që dy herë kemi diskutuar për këtë çështje dhe të gjitha debatet kanë përfunduar. Fjalën për këtë çështje e ka kërkuar megjithatë kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, Besnik Tahiri, ia japim fjalën.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë nga Parlamenti Evropian,

Ne në seancën e kaluar kemi pasur një diskutim goxha të gjatë te foltorja juaj dhe keni kërkuar që ligji në fjalë, pra Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcakton pagën minimale të kthehet në Qeveri. Të kthehet në Qeveri për shkak se ky ligj është një ligj, i cili fillimisht për qëllimin që po ndodh nuk ka kurrfarë impakti. Në shumicën e sektorit privat, në fakt, paga minimale ka arritur te 250 euro, pra nuk ka ndonjë impakt. Po të ishte paga minimale e përcaktuar në propozimin tonë që e kemi pasur prej 370 euro neto, atëherë ka pasur arsye për diskutim.

Në kuadër të këtij ligji është po ashtu një nen, një përcaktim, i cili e largon një kategori të nderuar të vendit nga lidhja me pagën minimale.

Prandaj, kërkesa jonë është shumë e thjeshtë, ka pasur një diskutim edhe nga ministri i Financave, edhe nga grupet parlamentare që të diskutohet edhe reforma sociale.

Unë mendoj do të ishte shumë e mençur, profesionale edhe llogaridhënëse që ky ligj të tërhiqet prej ministrit të Financave, prej zotit Murati, të ulemi të diskutojmë ndërlidhjet, të ulemi të diskutojmë edhe për votimin që ne e kemi bërë skema sociale dhe të ecim tutje.

Kjo kërkesë është legjitime, është kërkesë, e cila është minimale në raport me krejt çështjet që i kemi ngritur, debatet që i kemi pasur. Pra, nuk ka të bëjë me një pozicion as opozitar, e as nuk ka të bëjë me një pozicion politik, ka të bëjë me një koncept të aspektit të pagës minimale dhe reformës sociale.

Pra, po e largojmë propozimin, në qoftë se pajtoheni edhe ju, ta largojmë nga tema, të vazhdojmë me tema të tjera, të ulemi të diskutojmë dhe pastaj të ecim tutje. Në qoftë se e bëjmë ndarazi, e miratojmë këtë ligj, bëjmë një gabim shumë të madh, dhe e them me përgjegjësi të plotë që impakti i këtij ligji realisht për pagën minimale nuk ka asnjë efekt të vetëm.

Prandaj, pres mirëkuptim nga ju, do të thotë si procedojmë në qoftë se ka mundësi dhe në qoftë se kam pajtim edhe nga ju, kryetar, edhe nga kryetarja e grupit parlamentar, me të cilët kam diskutuar për këtë temë edhe më herët ta vendosim si mocion procedural, të diskutojmë, të ulemi, t'i dëgjojmë argumentet tuaja dhe pastaj të sjellim një ligj që me të vërtetë i ka hije dhe nuk i diskriminon kategoritë siç janë të përcaktuara në këtë ligj. Faleminderit!

**KRYETARI:** Megjithatë diskutimet kanë përfunduar dhe ne nuk do t'i kthehemi edhe një herë kësaj çështjeje. Qeveria ka dhënë propozimin e vet. Vetëm grupeve parlamentare, AAK-ja foli.

Tash hyjmë në procesin e votimit.

I kemi 94 deputetë të pranishëm.

Kush është për këtë projektligj, në shqyrtim të parë? Kush është kundër? Kush abstenon?

Për këtë projektligj votuan 74 deputetë, 68 kanë votuar për projektligjin, 6 abstenime, asnjë votë nuk ka qenë kundër këtij projektligji.



Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore.

E ngarkojmë Komisionin Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Tash e kemi po ashtu një votim shumë të rëndësishëm, është:

***6. Votimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022***

Edhe për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar, të nderuar deputetë. Kuorumin e kemi.

Po ju lus, deputetë të nderuar, që me ngritje të dorës të deklaroheni për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

Kush është për këtë projektligj? Kush është kundër? Kush abstenon?

Konstatohet që 62 deputetë e kanë dhënë votën për këtë projektligj.

Të gjitha votat kanë qenë për, nuk ka pasur asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.  
Konstatohet që Kuvendi e miratoi.

Kanë përfunduar diskutimet, zoti Muja. Vetëm të konstatohet një herë votimin.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.

Në ndërkohë ma ka kërkuar fjalën për çështje procedurale kryetari i Komisionit për Buxhet, deputeti Armend Muja. Urdhëroni, zoti Muja!

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Pas miratimit në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndarjet buxhetore, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje kërkoj nga Kuvendi që të marrë këtë vendim:

Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndarjet buxhetore për buxhetin të bëhet me procedurë të përsheptuar dhe të parashihen këto afate procedurale:

Amendamentet në projektligj të ofrohen nga deputetët deri më datën 15 qershor. Komisioni Funkcional për Buxhet e trajton deri më datën 17 qershor, komisionet e përhershme i ofrojnë amendamentet dhe raportet deri më 20 qershor.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e miraton raportin përfundimtar deri më 21 qershor. Në ndërkohë shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 të bëhet në seancën e datës 23 qershor 2022, në orën 10:00.

Thjesht, mocion procedural.

*(Ndërhyrje)*

KRYETARI: Jo, jo ajo nuk mund të ndodhë ashtu, në rregull është, në mënyrë legale është i parashtruar ky mocion, kështu që duhet të votojnë. Megjithatë duhet t'i marrë 2/3-tat e deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.

Kuorumin e nevojshëm e kemi. I dëgjua afatet procedurale përmes një mocioni, i cili propozohet prej Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes.

I dëgjua të gjitha afatet kohore, se në çfarë dinamikash të shqyrtohet ky projektligj dhe pastaj përmes votës suaj ju mund ta votoni, apo ta hidhni poshtë këtë mocion.

Më njoftojnë që 80 deputetë janë të pranishëm në sallë. E hedhim në votim këtë mocion.

Kush është për mocionin? Kush është kundër? Kush abstenon?

62 deputetë kanë votuar për, 17 deputetë kanë votuar kundër mocionit, kështu që konstatoj që ky mocion kalon. Prandaj, projektligji... 2/3-tat.

Është dashur 53 deputetë të votojnë. 62 deputetë kanë votuar. Kalon ky mocion. Kështu që projektligji shqyrtohet përmes procedurave të përsheptuara, ashtu siç e mori vendimin ky Kuvend.

Kalojmë te:

## **7. Emërimi i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës**

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Ekonomi e ka shqyrtuar listën e kandidatëve për kryetar, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e këtij propozimi.

E ftoj në emër të Qeverisë kryeministrin Kurti që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozimin e Qeverisë.

**KRYEMINISTRI ALBIN KURTI:** Faleminderit, kryetar Konjufca!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të dashur qytetarë,

Autoriteti i Konkurrencës është institucion publik shumë i rëndësishëm për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në vend. Një institucion që në vetvete ka për qëllim ta mbrojë konkurrencën si një e mirë publike e që i shërben të mirës së përgjithshme.

Andaj, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij autoriteti ne si Qeveri kemi bërë përpjekje që Kuvendit t'i propozojmë kandidatë të përgatitur profesionalisht me integritet moral për Komisionin e Mbrojtjes së Konkurrencës.

Disa funksione të larta shtetërore kërkojnë dije e vendosmëri, por gjithsesi edhe më shumë gra të përfshira në pozita vendimmarrëse. Pra, është e mundshme që një detyrë kaq të rëndësishme institucionale, si asnjëherë tjetër të jetë e plotësuar me gra, me zonja meritore e profesioniste, siç edhe do të propozohen tani në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Më lejoni që t'ua bëj një përshkrim fare të shkurtër për secilën e secilin prej tyre.

1. Për kryetare propozohet zonja Neime Binaku-Isufi. Ajo është ekonomiste e diplomuar në drejtim Banka e financa. Neimja ka një përvojë të gjatë profesionale. Ajo për tetë vjet ka punuar dhe punon si eksperte në njësinë qendrore harmonizuese për menaxhim financiar dhe kontroll, pastaj për katër vjet ka punuar si zyrtare për barazim në Thesarin e Kosovës.

2. Për zëvendëskryetare propozohet zonja Kaltrina Sela. Ajo është juriste me profesion, njohëse në menaxhimin e rrezikut dhe sistemit të kontrollit të brendshëm në institucionet publike, e po ashtu edhe në fushën e prokurimit publik, në fushën e legjislacionit të prokurimit publik. Për rreth shtatë vjetësh ajo ka udhëhequr divizionin e prokurimit në institucionin e Avokatit të Popullit.

3. Zonja Violeta Jakaj-Spaçi propozohet për anëtare të këtij komisioni. Violeta është juriste me profesion, 21 vjet përvojë ligjore dhe pajtueshmërie në sektorë bankarë, financiarë e të tjerë. Ajo ka master ligjor pranë Universitetit Karl Francens të Gracit në Austri, në fushën E drejta në Evropën Juglindore dhe integrimi evropian.

4. Zotëri Besim Stublla propozohet për anëtar të komisionit. Ai ka diplomuar në fushën e ekonomisë dhe të menaxhimit në Universitetin Amerikan në Kosovë. Ka mbi dhjetë vjet përvojë gjithëpërfshirëse në menaxhim, kontabilitet dhe hartimin e planit të buxhetit. Po ashtu ka përvojë në përpilimin e listave të pagave, llogari të pagueshme-arkëtueshme, kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e parasë së gatshme.

5. Dhe, së pesti, po ashtu për anëtare propozohet edhe zonja Nafije Osdautaj, ekonomiste e diplomuar në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë. Ka një përvojë të gjatë në fushën e buxhetit dhe të financave dhe ka punuar si zyrtare e lartë e buxhetit në Ministrinë e Shëndetësisë për katërmbëdhjetë vjet.

Të nderuar deputetë,

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës e kërkoj nga ju votën tuaj për emërim të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës me përbërjen, të cilën posa e shpalosa para jush. Faleminderit!

**KRYETARI:** E dëgjuat propozimin e kryeministrit, në emër të Qeverisë. Tash, radha është e komisionit. E kemi zëvendëskryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Ekonomi. Këtë e bën deputetja Jeta Statovci.

**JETA STATOVCI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbështetje të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226 ka nxjerrë Vendimin nr. 07/67 më 9. 3. 2022, të ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr. 05/69 më 13. 4. 2022, me të cilën i propozon kandidatët për kryetarë dhe anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Kryetari i Kuvendit me shkresën e datës 14. 3. 2022 dhe me shkresën DKP/ZNIPDO758, e cila është përgatitur më 5. 4. 2022, ka ngarkuar Komisionin për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti që ta shqyrtojë listën e kandidatëve të propozuar nga qeveria lidhur me emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Komisioni në pajtim me nenin 25, paragrafin 4 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe nenin 12 të Ligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit 03/L-229 shqyrtoi listën e kandidatëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të propozuar nga Qeveria dhe konstatoi se kandidatët e propozuar formalisht i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Andaj, komisioni më 26. 4. 2022 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### R e k o m a n d i m

1. Të miratohet propozimi i Qeverisë për emërimin e kandidatëve në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës me mandat pesëvjeçar, si në vijim:

1. Neime Binaku-Isufi, kryetare,
2. Kaltrina Sela, zëvendëskryetare,
3. Violeta Jakaj-Spaçi, anëtare,
4. Besim Stublla, anëtar,
5. Nafije Osdautaj, anëtare.

Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Bunjaku-Rexhepi, me siguri e keni kërkuar fjalën që në emër të grupit ta paraqisni qëndrimin tuaj. Ia japim fjalën deputetes në emër të Lidhjes Demokratike.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

Të respektuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më tepër se një vit i është dashur Qeverisë Kurti që të vijnë emrat e propozuar për Autoritetin e Konkurrencës dhe herën e parë në Komisionin për Ekonomi kur kanë ardhur emrat si të propozuar për Autoritetin e Konkurrencës, kanë ardhur dy emra që kanë pasur probleme me ligjin. Pastaj, komisioni është detyruar t'i kthejë prapa këta emra dhe Qeveria t'i sjellë emrat me propozime të tjera, domethënë emra që nuk kanë probleme me ligjin.

Qytetarët e Republikës sonë janë dëmtuar më tepër se një vit në mungesë të Autoritetit të Konkurrencës dhe tani nuk është arsyetim vetëm pse janë gra dhe patjetër duhet. Ne kemi vërejtje në procedurë dhe në emra të propozuar dhe si Lidhje Demokratike e Kosovës, si Grup Parlamentar, nuk do të marrim pjesë në votim.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, a e keni kërkuar fjalën, zoti Tahiri, kryetar i grupit.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Arsyeja pse jam në foltore për ta kundërshtuar këtë komision lidhet fillimisht me një të vërtetë të madhe të kësaj Qeverie, të Qeverisë Kurti, se është qeveria që do të jetë në histori qeveria më e ngadalshme dhe më e dobët në marrjen e vendimeve për gjithçka.

Të nderuar deputetë,

Besoni apo jo, Autoriteti i Konkurrencës është jofunksional prej 9 qershorit të vitit të kaluar. Dhe, ky kryeministër dhe ky kabinet nuk ka mundur t'i sjellë pesë emra për ta bërë një komision, ta zgjedhë një trupë që është ekstremisht e rëndësishme për ekonominë e vendit.

Pra shikoni, një vit e pesë ditë i është dashur Qeverisë së Kosovës t'i sjellë pesë emra, me pesë CV-a për ta filluar funksionalizimin e Autoritetit të Konkurrencës. Çka do të thotë kjo? Kjo i nxjerr në sipërfaqe dy të vërteta të mëdha.

E para, duke e ditur se mosfunksionalizimi i Autoritetit të Konkurrencës krijon pabarazi në treg, krijon shprehje të fiksimit të çmimeve të lidhjes së shkurtër të kompanive për t'i fiksuar çmimet, që është logjikë recidiviste dhe që është logjikë socialiste, pyetja shtrohet: A ka ndodhur kjo punë me qëllim, që të arrihet që një pjesë e madhe e sektorit ta bëjë këtë fiksion, apo e ka bërë për shkak se këta nuk janë të zotët t'i sjellin pesë CV dhe pesë emra.

E dyta, dua të lidhem me një detyrë tjetër të këtij autoriteti. Autoriteti i Konkurrencës po ashtu do të kishte një rol jashtëzakonisht profesional në vendimin tepër diskriminues për ngritjen e çmimit të energjisë dhe nuk do të kishim ardhur sot e ta sillnim Kosovën në kolaps me një vendim të Gjykatës dhe me tarifa që janë diskriminuese, në qoftë se ky autoritet do të ishte funksional.

Kjo është qeveria që e keni votuar 50%, pesë emra, pesë CV, një komision ta bëjë i duhen një vit e pesë ditë.

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar kryetarja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit kryetar, për fjalën, edhe pse në këtë rast unë mendoj që argumentimet, moralizimet dhe marrjen e shembujve nga deputetët e opozitës në raport me emrat dhe gjetjen e arsyeve, pse do të duhej të ishin votuar këta më herët, do të duhej ta kompensonin me votim të drejtpërdrejtë, e para.

E dyta, këta emra janë në Kuvendin e Republikës së Kosovës që dy muaj. Dy muaj rrafsh janë emrat që kanë ardhur, është data në dokumentacionin që u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit.

Po, mund të marrim përgjegjësi ne si deputetë të Kuvendit në mosaftësinë tonë që të procedojmë, gjegjësisht të miratojmë një bord të rëndësishëm.

E treta, të lidhet Autoriteti i Konkurrencës me situatën energjetike dhe problemin e tarifave është tërësisht manipulim. Absolutisht, në rrethanat aktuale në mënyrën se si e shtjelloi parafolësi nuk mund t'i vihet në barrë këtij autoriteti. Shtu këtu faktin se në ndërkohë dy muaj më parë ne kemi miratuar Ligjin për Autoritetin e Konkurrencës, i cili në ndërkohë gjithashtu ka shkurtuar edhe procedurat, dhe ka ofruar mundësinë për rritje të funksionalitetit dhe performansës së këtij autoriteti.

Dhe krejt në fund, gjithashtu më duhet, edhe pse pajtohem që vonesa është e evidente, emrat që i kemi përpara nuk ofrojnë hapësirë që ne të vëmë në dyshime kredibilitetin, performansën, apo të ardhmen e këtij autoriteti. Gjithsesi, e përgëzoj Qeverinë, se është hera e parë që në Kuvend do të votohet një autoritet, përkundër që u tha se s'është e rëndësishme, për ne është shumë e rëndësishme që në përbërje nga pesë anëtarë, katër prej tyre janë gra profesioniste dhe një burrë profesionist.

Prandaj, unë i ftoj të gjithë deputetët, pa dallim, pozitë dhe opozitë, që të miratojmë Autoritetin e Konkurrencës sot dhe ta funksionalizojmë këtë institucion tepër të rëndësishëm për ekonominë e vendit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Fjalën tash e ka kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit, kryetar!

Veç sa për sqarim procedural, sepse këtu u tha se Kuvendi i ka fajet që dy muaj që nuk ka mundur ta kalojë këtë vendim. Po më duket se qëllimisht po përdoren standarde të dyfishta dhe po minimizohen çështjet, duke tentuar të manipulohen në interes dhe në funksion të qeverisë dhe të partisë në pushtet. Kur po keni interes t'i kaloni vendimet si Ligji për pagën minimale, po merreni kollaj vesh me Listën serbe dhe me grupet e tjera politike dhe po i kaloni. Ndërsa tash kur duhet të kalohet, ose kur ishte dashur për dy muaj të kalohet një vendim për një bord, e paska fajin në tërësi Kuvendi, nuk e paska vetëm grupi parlamentar që e përkrah Qeverinë. Prandaj, le ta përdorim një standard, standardi i dështimit në agjenda legjislative dhe përgjegjësia për dështimet është e Qeverisë dhe e koalicionit qeverisës. Mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit me opozitën prapë mbetet përgjegjësi e Qeverisë dhe e partive të pushtetit.

Pra, t'i kemi të qarta për problemet të cilat po shfaqen në këtë Kuvend dhe në vend dhe të merren përgjegjësitë ashtu siç janë. Sepse kur po keni interes të miratoni ligje të cilat shkaktojnë probleme në Kosovë, po merreni lehtë vesh me Listën serbe, ndërsa për çështje të tjera filloni dhe vajtoni si Kuvendi jo se jo, po ju si pushtet po dështoni të realizoni agjendën legislative. Faleminderit.

**KRYETARI:** E hedhim në votim tash. Jeta Statovci e ka kërkuar fjalën tash në cilësinë e deputetes.

**JETA STATOVCI:** Faleminderit i nderuar kryetar!

Besoj se ka pajtueshmëri në raport me rëndësinë e këtij autoriteti e sidomos kur tash cikli normal i ekonomisë pra has në sfidat e veta, mirëpo u thanë disa pasaktësi në raport me procesin si tërësi në kuadër të Komisionit për Ekonomi. Pra, është e pavërtetë që Komisioni për Ekonomi i ka kthyer mbrapa emrat. Gjithashtu është e pavërtetë fakti që Qeveria i ka tërhequr mbrapa emrat.

Pra, çështja ka qenë se rrethanat ekonomike kanë ndryshuar dhe është dashur që të bëhet një riadaptim i vendimit dhe i gëzohemi faktit që është plotësuar pra lista me emra shumë kredibilë, me CV të cilat janë mjaft të pasura dhe mund t'i ndihmojnë fushës dhe gjithashtu siç u cek edhe më herët pra në një përbërje prej katër grave në këtë autoritet kaq të rëndësishëm. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Replikën e ka kërkuar deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi, në relacion me atë që e tha znj. Statovci.

**VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI:** Faleminderit, kryetar!

Për respektin ndaj koleges nuk po them që janë të pavërteta, po veç po kërkoj dëshmi, se do ta siguroj procesverbalin dhe do ta bëj publike, se në Komisionin për Ekonomi është e vërtetë që janë kthyer mbrapa dy emra, sepse kanë pasur probleme me ligjin, mandej janë përmirësuar emrat dhe kanë ardhur prapë në Komisionin për Ekonomi.

Kjo ka qenë shkelje procedurale, se nuk kemi pasur të drejtë si komision t'i kthejmë emrat mbrapa. Po s'është mirë para qytetarëve dhe opinionit thjesht të mashtrohet me këto fjalë boshe që nuk janë kthyer mbrapshtë. Ne jemi aty njëmbëdhjetë anëtarë të Komisionit për Ekonomi dhe të gjithë kemi qenë prezent. Sido që të jetë, unë me shumë përgjegjësi po e them, do ta kërkoj procesverbalin dhe do ta bëj publike cilët emra janë kthyer mbrapsht dhe me cilët emra është përmirësuar lista për Autoritetin e Konkurrencës.

Nuk ka arsytim realisht kjo, sepse një vit i është dashur për të siguruar një autoritet të konkurrencës dhe ju e dini se gjatë një viti me krizën ekonomike sa janë dëmtuar qytetarët.



Prandaj, ne kemi arsye plotësisht për të mos marrë pjesë në votim të Bordit të Autoritetit të Konkurrencës dhe përgjegjësia është e Qeverisë dhe e juaja si mazhorancë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tash e hedhim në votim propozimin e Qeverisë. Emrat i dëgjuat. Janë pesë persona, prej kryetares, zëvendëskryetares dhe tre anëtarëve.

Ju lutem tash që me ngritje të dorës të votojmë për Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Kush është për këtë Komision të propozuar? Kush është kundër? Kush abstenon?

64 deputetë kanë votuar. 63 vota për, asnjë kundër, vetëm një abstenim.

Me këtë rezultat, konstatoj që Kuvendi e mori këtë:

#### Vendim

Për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, si në vijim:

Neime Binaku-Isufi, kryetare,  
Kaltrina Sela, zëvendëskryetare,  
Violeta Jakaj-Spaçi, anëtare,  
Besim Stublla, anëtar, si dhe  
Nafije Osdautaj, anëtare.

Mandati i anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është pesëvjeçar. Ua urojmë këtë marrje të përgjegjësisë së re dhe u dëshirojmë suksese.

### **8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar**

Të nderuar deputetë,

Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të komisionit as hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të RTK-së nga komuniteti shqiptar. E ftoj me këtë rast kryetaren e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje që ta propozojnë kryetarin, i cili u takon këtë radhë në këtë Komision ad hoc, si dhe propozimin e katër anëtarëve të komisionit.

**MIMOZA KUSARI-LILA:** Faleminderit, kryetar!

Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje propozojmë deputetët, si vijon:

Deputeti Fitim Haziri për kryesues të Komisionit ad hoc, pastaj deputetët Valon Ramadani, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Besim Muzaqi dhe deputeti Nijazi Isaku.

KRYETARI: Grupin Parlamentar të PDK-së nuk e kemi këtu. LDK-ja, a do që të bëjë propozimet e saj për këtë komision as hoc.

ARBEN GASHI: Grupi Parlamentar i LDK-së e propozon deputetin Agim Veliu.

KRYETARI: Deputetin Agim Veliu. Lista serbe nuk është në Kuvend. Grupi i AAK-së e ka radhën. Deputeti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Albana Bytyqi.

KRYETARI: Albana Bytyqi propozohet në këtë Komision ad hoc. Ia japim fjalën Grupit Multietnik. Fida Jilta e ka fjalën.

FIDAN JILTA: Grupi Multietnik, Erxhan Galushi.

KRYETARI: Erxhan Galushi propozohet.

Tash po ju lus deputetë që të përgatitemi të votojmë sepse me ngritje të dorës do ta votojmë këtë komision, formimin e Komisionit ad hoc, me ata emra që i dëgjuat dhe prej subjekteve parlamentare, edhe për kryetarin, edhe për zëvendëskryetaren. Ju kërkoj që me ngritje të dorës të pozicionoheni për formimin e komisionit as hoc. Kush është për këtë Komision ad hoc? Kush është kundër? Kush abstenon?

Ndërkohë edhe PDK-ja kur t'i vijë momenti mund ta propozojë përfaqësuesin e vet. 67 deputetë kanë votuar për këtë Komision ad hoc. Të gjitha votat kanë qenë për, asnjë votë kundër, asnjë abstenim. Kështu që konstatoj që Kuvendi e formoi Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të RTK-së nga komuniteti shqiptar.

Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të RTK-së nga komuniteti shqiptar që të veprojë në përputhje me Ligjin për RTK-në dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Këtu është edhe momenti kur ne i mbyllim punimet e kësaj seance plenare. Faleminderit!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*